



Shkodër / 2021

**PERLAT E TË VËRTETAVE EKZISTENCIALE
PREJ FOLESË SË ZEMRËS**

Osman Nuri TOPBASH

PËRKTHYES

Ilir Hoxha

REDAKTOR

Alban Kali

FAQOSJA

Bledar Xama

BOTIMI I

Prill 2020, Shkodër

PROGRESI BOTIME

Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti

Shkodër, Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182

PERLAT E TË VËRTETAVE
EKZISTENCIALE
PREJ FOLESË SË ZEMRËS

OSMAN NURI TOPBASH



Aliu ﷺ, thotë:

“Qetësojini shpirtrat tuaj me fjalë dhe vepra të urta, sepse siç lodhet dhe dobësohet trupi, ashtu lodhet edhe shpirti.”

“Njerëzve tërhiquni vërejtjen me fjalë të urta që i bëjnë të mendojnë, me qëllim që t’u qetësohen zemrat.”

PARAFJALË

Falënderimet dhe lavdet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili na krijoi nga hiçi ne robërit e Tij të dobët dhe na dhuroi mirësi të panumërta!

Përshëndetjet dhe salavatet e pafundme qofshin për udhëzuesin tonë më të madh të rrugës së drejtë në këtë botë, Muhammed Mustafain ﷺ familjen e tij të pastër dhe sahabët e tij të nderuar!

Kur shohim tablonë e përgjithshme të ditëve tona, vërejmë se me anë të ideologjive materialiste, kapitaliste dhe liberale, mendjeve njerëzore po i imponohet përherë e më shumë një botëkuptim pa ahiret. Frymëzimet larg botës së shpirtit, që injektohen më së shumti me anë të mediave të shkruara, vizive dhe elektronike, po e çojnë njerëzimin drejt problemeve dhe fatqësive shpirtërore.

Dhe, me të vërtetë që, edhe në shoqëritë me standardet më të larta të jetesës, uria dhe problemet shpirtërore në nivele maksimale. Kjo, sepse qëllimi i jetës, urtësia e ekzistencës sonë, vdekja dhe përtej saj nuk analizohen asnjëherë nën dritën hyjnore. Përkundrazi, jeta e shthurur dhe plotësisht indiferente ndaj të vërtetave ekzistenciale, reklamohet si liria dhe lumturia e vërtetë.

Për fat të keq, në cilën anë të fryjnë erërat e kulturës mbizotëruese, në atë anë shkojnë edhe mendjet, edhe zemrat. Për rrjedhojë, detyra që na ngarkon besimi dhe ndërgjegjja jonë, është të kapim përdore njerëzimin që e ka humbur veten në vorbullën e kohës, duke ikur njësoj si trungjet që merren para nga përmytjet, t'i shpëtojmë ata prej kësaj vorbulle dhe t'i njohim me delikatesën dhe bukurinë e personalitetit Islam, urtësinë, qytetërimin dhe lumturinë e vërtetë.

Ndërsa shpirti që do të rigjallërojë popujt, nuk është ai i pedantëve egoist të kërrusur mbi librat e filozofisë, por shpirti i besimtarëve të urtë, që i kanë thelluar zemrat me urtësitë hyjnore të ekspozuara në Kuran, në gjithësi dhe në qenien njerëzore dhe që janë diell mëshire e paqeje për njerëzimin. Dhe, pikërisht se jemi të privuar nga ky shpirt, sot, adresa e lumturisë, kërkohet në tregun e mjerimit. Njeriu po shndërrohet në një robot që ka marrë formë prej filozofive sakate të kohës sonë...

Mirëpo, njeriu është një qenie, që ndryshe nga krijesat e tjera, është i pajisur me cilësi të larta dhe aftësinë e mendimit. Prandaj, ai duhet të meditojë më shpesh... Përse ka ardhur në këtë botë, në pronën e kujt jeton dhe prej ku, e ku po shkon?..

Ai duhet të mendojë në lidhje me veten e tij... Duhet të mendojë se si ndërkohë që nuk ekzistonte fare, është krijuar prej pike uji mikroskopike në formën më të bukur dhe më të përsosur. Duhet të mendojë se përse jeton dhe çfarë do të bëhet me të pasi të vdesë. Ai duhet të lexojë bukuritë hyjnore, manifestet e madhështisë dhe urtësitë e panumërta hyjnore në librin

e gjithësisë, sepse gjithësia është si një muze ku janë të ekspozuara të gjitha të fshehtat dhe urtësitë e veprave madhështore të artit hyjnor. Por, për ata që mund të shohin, e mund të dëgjojnë...

Shejh Sadi Shirazi thotë:

"Në shikimin e njerëzve të mençur, çdo gjethë peme është një poezi e mrekullueshme që dëfton Allahun. Ndërkohë që për të shkuajdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethë."

Ja pra, njeriu duhet t'u vërë veshin këtyre poezive me zë e pazë dhe duhet t'i lexojë me syrin e urtësisë për të marrë mësim të gjitha mesazhet hyjnore në gjithësi. Dhe më të rëndësishmin, i cili përmban deklaratat hyjnore që na lajmërojnë në lidhje me qëllimin kryesor të ekzistencës sonë, pra Kuranin Fisnik, duhet ta lexojë me sytë e zemrës. E, sa më shumë të lexojë, duhet të kuptojë se Allahu i Madhëruar nuk e ka krijuar kot gjithësinë. Përkundrazi, Ai e ka krijuar me mistere dhe urtësi të panumërta. Për rrjedhojë, edhe ne kemi detyrat tona të rëndësishme në këtë botë sprovash.

Ndërsa në ditët tona, kur nevojat dhe domosdoshmëritë materiale në çdo fushë -për fat të keq- janë vënë në plan të parë, në të shumtën e rasteve, çështjet më të rëndësishme njerëzore largohen nga rendi i ditës. Për rrjedhojë, të vërtetat ekzistenciale, si jeta, vdekja, varri, bota tjetër, llogaria, Xheneti dhe Xhehenemi, të cilat duhet të njihen mirë dhe të bëhet përgatitje për to, nuk trajtohen aq dhe ashtu siç duhet, gjë e cila i tensionon dhe i shqetëson thellësisht shpirtrat.

Nisur nga kjo, ne dëshirojam që në këtë vepër t'u përcjellim lexuesve tanë në formën e mesazheve të shkurtra disa urtësi dhe të vërteta të domosdoshme për njeriun e sotëm, të cilat burojnë prej udhëzuesit tonë drejt lumturisë së përjetshme, Kuranit Fisnik, prej sunnetit të Profetit ﷺ dhe botës shpirtërore të robërve të devotshëm të Krijuesit. Me anë të këtyre perlave rreth të vërtetave ekzistenciale, çdonjëra prej të cilave është si përmbledhje e një artikulli, dëshirojmë të qetësojmë shpirtat tanë dhe t'i thellojmë zemrat tona në atmosferën e meditimit.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të gjithëve ta shohim jetën dhe gjithësinë me syrin e urtësisë për të marrë mësim dhe që pas një jete të zbukuar me vepra të mira, të dalim para Tij me besim të shëndoshë dhe zemër të pastër!

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH

Mars 2015

Yskydar



Njohja e Profetit ﷺ me zemër


Trëndafili është simboli i Profetit ﷺ. Prandaj dhe gjëja më e rëndësishme që duhet të mësojë njeriu në shkollën e kësaj jete të përkohshme, është:

Njohja e atij mbreti të Trëndafilave,

Të përfitojë prej aromës së atij Trëndafili të bekuar dhe prej ndjesive të tij shpirtërore.

Të bëhet një pikë vese në petalet e tij...

Kur besimtari të fillojë të ndjejë thellë ndjesitë, emocionet dhe drithërimat shpirtërore përballë atij Trëndafili të trëndafilave dhe të fillojë të përfitojë prej bukurive të zemrës së tij, atëherë ai është në rrugën drejt shkrirjes me të dhe shijimit të ëmbëlsisë së dashurisë ndaj tij.



Pa njohur Atë është e pamundur

Të njohësh dhe të kuptosh të Dërguarin e Allahut ﷺ është shkalla më e lartë e devotshmërisë ndaj Allahut. Pa e kuptuar dhe pa e njohur atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore, as besim i ynë nuk është i plotë, as Kuranin nuk mund ta kuptojmë siç duhet dhe as devotshmëria jonë nuk është e përsosur...




Sa i ngjasojmë Atij?

Bota shpirtërore e të Dërguarit të Allahut ﷺ është si një bahçe Xheneti, ku gjenden lulet më të bukura, më të rralla dhe trëndafilat me aromë më të këndshme. Por, sa po përfitojmë ne prej flladeve shpirtërore, që vijjnë prej asaj bahçeje të Xhenetit?

Sa i ngjan jeta jonë familjare dhe marrëdhëniet tona tregtare e shoqërore me ato të tijat?

Zemra e tij rrihte fort për të mjerët, të pashpresët, jetimët dhe ata që prisnin udhëzim. Po ne, sa të ndjeshëm jemi ndaj tyre?

Sa e përfaqësojmë ne si umet i atij njeriu me moral të lartë, çiltërsinë, pastërtinë e shpirtit dhe zemrës, mirësjelljen, delikatesën dhe estetikën e islamit?



Me kë jemi?

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

“Njeriu është bashkë me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96)

Duhet të mendojmë pak; sa pranë është zemra jonë me Allahun? Sa pranë është me Profetin ﷺ dhe të dashurit e tij?

Përkundër kësaj, sa pranë është ajo me dëshirat e egos? Sa anon ajo nga armiqtë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, nga joshja e gjynaheve dhe kurtheve djallëzore?..



Ta njohim, ta shohim dhe ta dëgjojmë atë

Nëse e njohim atë, nesër në ditën e mahsherit, edhe ai do të na njohë. Nëse jemi aq të pjekur për ta parë atë, edhe ai do të na shohë. Nëse e dëgjojmë dhe i vëmë veshin, edhe ai do t'i dëgjojë përgjërimet tona. Shkurtimisht, t'i bindemi atij, në mënyrë që të fitojmë ndërmjetësimin e tij në ditën e gjykimit, siç urdhërohet edhe në ajetin Kuranor: **"...Që edhe Profeti të jetë dëshmitar për ju!"** (Bekare, 143)



Parimi

Përgëzuesi im, shpëtuesi im, zotëria im, Profeti im;

Parimin që nuk të përshtatet ty, i vë shqelmin edhe nëse është vetë jeta!..

Nexhip Fazëll Kësakyrek



Borxhi i besnikërisë

Le ta shohim njëherë borxhin tonë të besnikërisë ndaj të **Dërguarit të Allahut** ﷺ:

Sa kemi sakrifikuar për dëshirat tona në këtë botë, për hir të realizimit të një dëshire të tij?

Sa jemi interesuar për problem shpirtërore dhe materiale të umetit islam?

Çfarë kemi bërë ne për të parandaluar erozionin që ka përfshirë popullin, fenë dhe vlerat tona morale?..



Çfarë veprash kemi?


Fudajl bin Ijad ﷺ i kërkonte llogari vetes në këtë mënyrë:

“Ti dëshiron të jesh bashkë me profetët dhe besnikët në Xhenetin Firdeus, por çfarë veprash ke bërë për këtë? Cilat prej dëshirave epushore i ke mbizotëruar? Cilin zemërim ke mposhtur? Tek cili prej të afërmeve që nuk të vjen ke shkuar? Cilin prej gabimeve të vëllait tënd ke falur? Nga cilët prej të afërmeve të tu je larguar dhe cilëve prej të largëtëve u je afruar për hir të Allahut?..”

(Ihja, v. II, fq. 402)




Fijet e litarit...

Abdullah bin Dejlami , në lidhje me rëndësinë e ndjekjes së sunnetit me bindje dhe dorëzim të plotë, është shprehur:

“Fillimi i humbjes (dobësimit) së fesë, do të jetë me braktisjen e sunnetit. Siç zgjidhet litari fije fije dhe në fund këputet, ashtu edhe feja humbet me braktisjen një nga një të sunneteve.” (Darimi, Mukaddime, 16)

Nisur nga kjo, dalja e sunneteve një nga një prej jetës sonë, -Allahu na ruajttë- e vështirëson shpëtimin tonë të përjetshëm në botën tjetër.



Entuziazmi i besimit të sahabëve në gjurmët e Profetit ﷺ

Kur në qendrën e miqësisë, në zemrat e tyre zuri vend Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), një shoqëri gjysmë e egër, filloi të nxirrte personalitete monumentale që arritën majat e humanizmit, mëshirës dhe virtyteve të larta. Vëllazëria fetare ishte si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Luksi, shpërdorimi, grykësia dhe koprracia, ishte një stil jete që shoqëria e sahabëve nuk e njihnin, sepse ata nuk e harruan kurrë përkohshmërinë e tyre dhe jetuan me idenë se, “nesër, bujtina e egos do të jetë varri”.



Mrekullia e vërtetë

Një nga njohësit më të mirë të metodologjisë së të Drejtës Islame, Imam Karafi thotë:

“Edhe sikur i Dërguari i Zotit ﷺ, të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, do të mjaftonin sahabët e edukuar nga ai si argumenti më i madh i profecisë së tij.”



Nevoja e njerëzimit; Fryma e tij mëshironjëse

Ai shpërndau gjithmonë dashuri dhe mëshirë për umetin e vet dhe u bë bashkëvuajtës me nevojtarët. Qëndroi pranë të varfërve dhe të dobëtëve. Në këtë mënyrë, ai arriti të edukojë një shoqëri që ishte gati të sakrifikoje gjithçka për të.

Ashtu siç e shpëtoi atë shoqëri të harbuar në periudhën e injorancës, po ashtu edhe sot, ai është i vetmi që mund të zgjidhë problemet e njerëzimit dhe të na çojë drejt paqes.



Dashuria për Allahun dhe Profetin ﷺ

Në zemrat e sahabëve nuk ekzistonte dashuri më e madhe se dashuria për Allahun dhe Profetin ﷺ. As dashuria për pasurinë dhe as dashuria për famë dhe pozitë... sepse të gjitha këto do të mbesin në dynja, kurse dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, do të jenë pasuri e çmuar në botën e amshuar.

Lum ata besimtarë, për të cilët dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, është më e rëndësishme se çdo lloj dashurie tjetër dhe nuk i mashtrojnë lulet joshëse të kopshteve të egra.



Ehli Bejti

Ehli Bejt janë personalitete të zgjedhura që kanë dëshmuar nga afër bukuritë profetike, pra, bukurinë e fytyrës së Profetit, përsosmërinë e gjuhës së tij, delikatesën (elegancën, hijeshinë, bukuritë) e veprimeve të Tij dhe elokuencën e kumtesave të tij. Ata ishin më të dashurit e të Dërguarit të Allahut sepse ishin mpleksur me gjendjet e tij, ishin pajisur me moralin e tij dhe edukuar nën kujdesin e tij.



Ebu Bekri رضي الله عنه

Ai kapërceu vetveten duke jetuar një jetë plot me zjarr dashurie hyjnore. Vetëm tek i Dërguari i Allahut gjeti jetë. Ai përjetonte emocione të forta shpirtërore sa herë që takohej me të ose bisedonin së bashku. Kur ishte në praninë e Profetit, në vend që dashuria ndaj tij t'i qetësohej, ndodhte krejt e kundërta: zjarri i dashurisë për Profetin i shtohej edhe më shumë.



Omeri رضي الله عنه

Para se të hynte në fenë islame, Omeri ishte shembulli tipik i njerëzve të paditur që ishin të boshatisur nga mëshira dhe që nuk njihnin asnjë të drejtë të askujt, përveç forcës dhe të drejtës së tyre. Ndërsa kur ai u nderua me hyrjen në fenë Islame, u bë një njeri i kujdesshëm, altruist, i urtë dhe monument drejtësie. Omeri i para-islamit, me natyrë të egër e të ashpër, u shkri e humbi fare. Omeri u transformua në një njeri, sytë e të cilit ishin vazhdimisht të përlotur, zemra e të cilit ishte e mbushur me mëshirë dhe dhembshuri, i cili ruhej edhe nga bezdisja që mund t'i jepte një milingone, i cili mendonte vazhdimisht lumturi-në e umetit mysliman dhe i cili ishte i pajisur me vetëdije të lartë përgjegjësie.



Osmani رضي عنه

I ditur, i sjellshëm, bujar, zemërbutë, i urtë, i turpshëm, njeri i zemrës, modest dhe i dashur, e siç shprehjet edhe vetë Profeti ﷺ, “sahabi me karakterin më të ngjashëm me Profetin.”

Një ditë, teksa ishte agjërueshëm dhe po lexonte Kuran në shtëpi, Osmani u martirizua, duke u vrrarë nga kryengritësit.

Gjaku i këtij dëshmori që i kish kaluar të tetëdhjetat, pikoi mbi ajetin Kuranor që po lexonte: “...Allahu të mjafton përballë tyre. Ai dëgjon dhe sheh çdo gjë.” (Bekare, 137)



Aliu رضي عنه الله

Aliu (r.a.), lindi brenda në Qabe dhe ndërroi jetë i martirizuar gjatë namazit të sabahut në xhaminë e Kufes. Ai ishte shembull i urtësisë dhe virtytit. Një prej këshillave të tij të shumta është:

“Bota së bashku me fenë do të kenë qetësi dhe paqe vetëm atëherë kur të sigurohet vazhdimësia e këtyre katër gjërave:


1. Të pasurit që nuk janë dorështrënguar me pasurinë e tyre.
2. Të diturit të cilët veprojnë me diturinë e tyre.
3. Injorantët të cilët nuk krenohen me paditurinë e tyre.
4. Të varfrit që nuk e shesin ahiretin për interesat e dynjasë.”



Frekuentimi i njerëzve të dijes

Sahabët nuk dëshironin asnjëherë që të kalonte kohë të gjatë pa e parë Profetin ﷺ dhe pa dëgjuar prej këshillave të tij të bekuara. Madje, lidhur me këtë i porosisnin shpesh edhe fëmijët e tyre.

Vallë, po ne sa marrim shembull prej kësaj qasje të sahabëve? Sa përpiqemi ne të përfitojmë nga bisedat dhe ligjërimet e dijetarëve, të cilët janë trashëguesit e profetëve?..



Profeti i faljes

Ai ishte Profet i faljes. Ai arriti të falte edhe Hindin, e cila vrau dhe i kafshoi mëlçinë xhaxhait të tij të dashur Hamzait ﷺ. Ai fali edhe gruan e cila donte ta helmonte. Ai fali edhe atë që i bëri magji. Edhe pse ai kishte të gjithë mundësinë dhe fuqinë për t'u hakmarrë në momentin e çlirimit të Mekës, ai i fali mekasit, të cilët e torturuan atë dhe myslimanët për vite me radhë. E megjithatë, ai ringjalli shumë shpirtra të vdekur me një jetë të pafundme...



Lavdia e Muhamedit...

Nëse i japim selam dikujt gjatë namazit, ky veprim e prish namazin. Mirëpo, nëse i dërgojmë selame Profetit tonë ﷺ, duke thënë:

“السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ” : Paqja qoftë mbi ty o i Dërguar!” ky veprim e plotëson namazin.

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ مَدِّطَبِ الْقُلُوبِ

دَوَائِفِهَا
عَلَيْهَا
سُفَاتِهَا
نُورِهَا
ضِيَاءِهَا

وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ وَسَلَامٍ مَعَ الْمُؤْمِنِينَ آمِينَ

Me ndarjen tënde digjen nga malli...

Profeti ynë (a.s.), i fliste xhematit duke u mbështetur mbi një trung hurme. Më pas u pa e nevojshme të bëhej një minber, ku i Dërguari i Allahut (a.s.) filloi të mbajë hutbe mbi të. Mirëpo, pasi i Dërguari i Allahut e braktisi trungun e hurmës, i filloi të rënkonte e të qante me një zë që i përngjiste rënkimit të devesë dhe i cili dëgjohej edhe nga sahabët. Atëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.) zbriti nga minberi dhe e ledhatoi trungun, i cili më pas pushoi dhe u qetësua. Ai ishte veç një trung hurme, ndërsa ne jemi njerëz!..



Atë e njeh toka dhe qielli...

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Me përjashtim të kundërshtarëve ndër xhinët dhe njerëzit, çdo gjë që ekziston mes tokës e qiellit e di se unë jam i Dërguari i Allahut!" (Ahmed, III, 310)

Atë e njohu mali Uhud dhe trangu i hurmës, i cili rënkoj nga malli për të. Madje edhe kafshët i kërkuan ndihmë dhe i qanë hallin... Ndërsa Ebu Xhehli dhe të ngjashmit me të, nuk arritën ta njohin atë as dje, e as sot...

Përgjegjësia jonë në luftën mes së vërtetës dhe të kotës

Nuk ka asgjë për t'u çuditur me sjelljet ofenduese të Ebu Xhehlëve dhe Ebu Lehebëve të kohës ndaj Profetit të Zotit (a.s.). Dihet se hajduti dyqanin e argjendarisë synon të vjedhë dhe pema me fruta goditet me gurë. Ashtu sikurse Ebu Xhehlët e djeshëm, edhe pasardhësit e sotëm të injorancës nuk kanë lënë vend pa kërkuar në jetën dhe në karakterin e Profetit (a.s.), por nuk kanë gjetur asgjë, qoftë edhe një detaj të vogël, për të kritikuar.

Duke qenë kështu, nuk kanë gjetur zgjidhje tjetër, veçse të qetësojnë urrejtjen e tyre me anë të shpifjeve dhe intrigave. Në një mënyrë apo tjetër, lufta mes së vërtetës dhe të kotës do të zgjasë deri në Ditën e Kiametit.

Historia është si një lojë teatrale që vihet në skenë duke u përsëritur. Edhe pse aktorët ndryshojnë, skenari nuk ndryshon asnjëherë. Fundi i tiranëve kokëfortë, si Nemrudi dhe Faraonin që nuk i besuan dhe përgënjeshtuan Ibrahimin (a.s.) dhe Musain (a.s.), para mijëra vjetësh, ishte i njëjtë me fundin e Ebu Xhehlit



dhe Ebu Lehebit, të cilët e munduan dhe e fyen në të njëjtën mënyrë edhe Profetin (a.s.). Po ashtu edhe nesër, i njëjtë do të jetë edhe fundi i atyre që tregojnë armiqësi ndaj Allahut.

Por, ajo që ne duhet të pyesim është kjo:

Çfarë detyre kemi ne si umeti i Muhamedit (a.s.), përballë këtyre shpifjeve?

Ata, me sjelljet e tyre, mundohen të mbulojnë të vërtetën e Profetit (a.s.). Me anë të zhurmës që krijojnë, dëshirojnë që fjala e Kuranit të mos dëgjohet. Me ato paraqitje të ndyra, mundohen t'i largojnë shikimet nga drita e moralit më të mirë të botës.

Atëherë, ajo që na takon ne të bëjmë, është t'ia paraqesim njerëzimit të Dërguarin e Zotit (a.s.), në formën e tij më të denjë...

Islamofobia

Sot, ata që duan të ndalojnë përhapjen e Islamit në mbarë botën, kanë krijuar një valë të shëmtuar urrejtjeje ndaj tij dhe myslimanëve, nën emrin «Islamofobi». Ata përpiqen ta etiketojnë Islamin me terrorizëm. Shpallin Islamin si diçka të frikshme e që duhet pasur frikë. Por e vërteta është se terrori bazohet në zemërim, ndërsa parimet Islame të edukatës, moralit, ndërgjegjes, dashurisë dhe frikës ndaj Allahut, të vërtetës dhe drejtësisë, janë parime të larta që për ata nuk kanë kurrfarë vlere. Terrorizmi nuk njeh lot, mëshirë dhe ndërgjegje. Përkundër kësaj, Islami është ndërtuar veçanërisht mbi bazën e dhembshurisë dhe mëshirës. Allahu Fuqiptotë në Kuranin Famëlartë na mëson për emrat e Tij “Rahman” dhe “Rahim”, pra për mëshirën që ka përfshirë çdo krijesë. Po ashtu, edhe Profeti ynë (a.s.) është dërguar si “mëshirë për botët”.

Kur hedhim vështrimin në histori kuptojmë se, personi që ka luftuar më shumë me terrorin është i Dërguari i Allahut r. Periudha 23 vjeçare profetike është një periudhë lufte kundër terrorit. Terrorit ndaj të dobëtëve në shoqëri, ndaj robërve, skllëvërve, kafshëve e bimësisë... Ai respektoi të drejtat e çdo qenieje njerëzore, pa marrë parasysh nëse është besimtar apo i pafe. Si rrjedhojë solli



paqe në shkretëtirat që qenë kthyer në liqene gjaku. Ai hodhi themelet e një qytetërimi të pashembullt të virtyteve që historia e njerëzimit nuk kishte parë asnjëherë.

Ajo që duhet të bëjmë sot, është praktikimi i moralit të lartë të Resulullahut (a.s.), që është dërguar si mëshirë për botët, dhe përcjellja e mesazhit të tij me aq sa kemi mundësi. Nëse e realizojmë këtë detyrë me dinjitet, sado të mundohen ta njollosin Islamin, Allahu i Plotfuqishëm ka për t'i prishur planet e tyre...



Prova e dashurisë

Nuk është e mjaftueshme të themi, “unë e dua Profetin (a.s.)”, sepse tek ai që pretendon se e do atë, duhet të shfaqen edhe cilësitë e tij. Nëse e duam Profetin (a.s.), sa të mëshirshëm, sa të butë dhe sa të moralshëm jemi?

Po ashtu, nuk është e mjaftueshme të themi, “unë e dua Kuranin”! Nëse me të vërtetë e duam Kuranin, sa angazhohemi me të? Sa përfitojmë prej moralit të Kuranit? Sa veprimë me gjykimet e Kuranit?..



Si bleta...

Resulallahu ﷺ, ka thënë:

“Besimtari i ngjan bletës. Ha atë që është e pastër, nxjerr në pah më të pastrën, qëndron në vende të pastra dhe vendin ku qëndron, as e dëmton dhe as e prish.” (Ahmed bin Hanbel, II, 199)

Ashtu si bleta që shëtit mbi një mijë lule për të mbledhur nektarin dhe për të prodhuar më pas mjaltin, edhe ne si besimtarë duhet të marrim mësim nga jeta e Profetit (a.s.), dhe robërve të dashur të Allahut, për t’i pasqyruar ato në çdo moment të jetës sonë. Në këtë mënyrë i ofrojmë gjithë njerëzimit mirësjelljen dhe ëmbëlsinë e Islamit.



Letër udhëzimi prej Allahut

Kurani Fisnik është një letër udhëzimi e dërguar prej Allahut për të gjithë njerëzimin. Me anë të kësaj letre, Allahu i Madhëruar i fton robërit e Tij në Xhenet. Dhe, për t'iu përgjigjur kësaj ftese, njeriu duhet ta lexojë Kuranin me sytë e zemrës, duhet të thellohet në përmbajtjen e tij, duhet të bëjë një jetë të gjallë Kuranore dhe të shkojë tek Allahu me zemër të pastër.

Sot, puna kryesore që do t'i sigurojë të gjithë umetin Islam një shkundje të fortë dhe kthim në identitetin e vet, është kthimi tek Libri i Allahut, Kurani Fisnik.



Respekti ndaj Kuranit Fisnik


Kurani nuk është vepër e një të vdekshmi. Por është një udhëzues i rrugës së drejtë të cilin Krijuesi i gjithësisë na e ka falur me qëllim që të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër. Prandaj, për të përfituar në mënyrën e duhur prej Kuranit, duhet që kapakun e tij ta hapim me ndjenja të larta respekti dhe ta lexojmë me vetëdijen që Allahu i Madhëruar u ka mësuar njerëzve. Pra, ta lexojmë Kuranin sikur është duke u zbritur në ato momente.



Si duhet lexuar Kurani?

Ajetet e Kuranit ndriçojnë errësirat historike dhe shpjegojnë të pashpjegueshmet. Kurani është një vend i mrekullive ku mund të jetohet pranvera e lumturisë dhe e paqes së kësaj bote dhe botës tjetër.

Nuk duhet të harrojmë, se nuk mjafton vetëm të dëgjosh zërin e Kuranit dhe t'i hedhësh një sy hartës së të vërtetave. Por është i domosdoshëm zbatimi me përpikëri i urdhrave të shenjtë që tregojnë rrugët e shpëtimit të jetës tjetër, pasi besimtari është ai që hyn në një luftë shpirtërore të fortë me atmosferën e Kuranit përkundrejt mësymjeve armiqësore.



Lexo për të jetuar!

Fudajl bin Ijad ﷺ ka thënë:

*“Kurani është zbritur që të punohet sipas tij,
kurse njerëzit kanë bërë zakon vetëm leximin e
tij!”*



Aq sa na mban zemra

Urtësitë dhe misteret e Kuranit janë të thella si një oqean dhe gjithkush mund të përfitojë prej tij sipas thellësisë së shpirtit të vet. Nëse thellësia e shpirtit të dikujt është sa gishtëza e rrobaqepësit, aq do të përfitojë edhe ai nga oqeani i paanë e pafund.

Edhe pse të gjithë lexojnë Kur'an para së njëjtës rahle, gjithsecili përfiton prej Kur'anit sipas nivelit shpirtëror që zotëron. Kuptimet e Kuranit, i shpalosen robit aq sa ai është i afërt me Allahun.



Embëlsi e pafund

Kur merr abdes, besimtari e pastron gojën, duke e përgatitur atë për leximin e Kur'anit Fisnik dhe përmendjen e Allahut të Madhëruar. Në të njëjtën mënyrë, me anë të pendimit, kërkimit të faljes dhe lotëve, ai duhet ta lajë atë edhe nga gënjeshttrat, përgojimi, shpifja dhe vese të tjera të këqija, duke e nënshtruar zemrën ndaj një pastrimi shpirtëror. Kjo, sepse në të vërtetë, Kur'ani Fisnik lexohet me zemër. Prej një leximi që nuk bëhet me zemër të pastër, nuk mund të merret një frymëzim shpirtëror në kuptimin e plotë të fjalës.

Osmani ﷺ ka thënë:

“Nëse zemrat do të ishin të pastra nga prej papastërtive (sëmundjeve) shpirtërore, ato nuk do të ngopeshin kurrë me kënaqësinë e Kuranit.”



Shpjegimi i njeriut

Kurani Fisnik është shpjegimi i njeriut. Kurse shpjegimi i Kuranit Fisnik është gjithësia. Shkurt, ata janë të lidhur me njëri-tjetrin. Njeriu, Kurani dhe gjithësia, janë tre botë që e shpjegojnë njëra-tjetrën në mënyrën më të bukur. Ata që thellohen në Kuran, arrijnë të lexojnë veten dhe mirësitë e Allahut Teala. Fillojnë të shfletojnë fletët e gjithësisë dhe urtësitë bëhen të qarta. Ndërsa në zemrën e tyre hapet një dritare e horizonteve të përtëjme.



Çelësi i meditimit

Ashtu si një filiz rrapi, i cili merr zhvillim marramendës në një tokë pjellore edhe zemra dhe mendja e njeriut e ushqyer nga bota e pasur e Kuranit fitojnë aftësi të mëdha perceptuese dhe ndijuese. Pa frymëzimin dhe udhëzimin e pashterueshëm të Kuranit, bota jonë e mendimeve dhe e ndjenjave do të ishte shumë e varfër.



Dy ulluqe

“Mendja dhe zemra”, të cilat janë qendra e mendimit dhe ndjenjës në trupin e njeriut, janë si një basen. Siç shprehet edhe i ndjeri Nexhip Fazëll, “ulluqet që mbushin këtë basen janë dy, prej njërit rrjedh dritë, prej tjetrit ndyrësi...”. Pra, nëse prej këtyre tubave kalojnë gjithmonë dëshira egoiste, lakmi dhe indiferentizëm, bota jonë e brendshme do të kthehet në një plehërishte. Por, nëse prej këtyre tubave kalojnë burime të frymëzimit shpirtëror, zemrat shndërrohen në një oqean urtësie...



Identiteti shpirtëror

Mevlana Xhelaledin Rumi ka thënë:

“O vëlla! Ti duhet të gjallërohesh me meditim. Trupi yt i përbërë prej mishi dhe kocke, është i njëjtë edhe tek kafshët. Nëse meditimi yt është trëndafil, atëherë ti je në kopshtin e trëndafilave. Pra, je në xhenetin e kësaj bote. Por, nëse meditimi yt është gjemb, ti s’je veçse një trung për t’u djegur.”

Ashtu si gjurma e gishtit që luan rolin e një identiteti material, ashtu edhe bota e meditimit të njeriu, formon identitetin e tij shpirtëror.



Çfarë po kërkojmë?

Prirjet dhe animet e njeriut, janë pasqyra e tij. Njeriu mendon dhe thur ëndrra për atë që kërkon. Prandaj, kujdes! Çfarë po kërkojmë? Cili është drejtimi i kërkimeve tona, dynjaja apo ahireti? A është kursi i ëndrrave tona në vijën e egos, apo në vijën e shpirtit?.. Të mos harrojmë se, kërkimi i lumturisë në tregun e mjerimit, është budallallëku më i madh!..

Xhelaledin Rumi ka thënë::

“Nëse gomari bëhet klient dhe dëshiron të blejë diçka, padyshim se do të marrë bostanin e papjekur.”

“Njeriu vlerësohet në bazë të asaj që kërkon.”



Nëse nuk do të ishte urtësia...

Kumtesa e parë:

إِقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!” (Alak, 1)

Çdo gjë në gjithësi, që prej grimcës, e deri tek trupi më i madh, lexohet me urtësi. Ndërsa lexuesi është zemra, sepse në gjithësi asgjë nuk është krijuar kot. Misteret që nuk perceptohen dot me mendje, zbulohen me urtësi. Nëse nuk do të ishte urtësia; misteret do të mbeteshin të mbuluara, e shpirtrat do të ngustoheshin të trazuar.

Ndërsa adresën e urtësisë, Rumi na e tregon kështu:

“Zërat dhe fjalët e bekuara që dalin prej zemrave të të devotshmëve, janë ringjallëse si suri i Israfilit.”



Prej artit tek Artisti, Prej veprës tek Autori...

Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore të heshtura e pafjalë. Këto poezi hyjnore, thellohen në varësi të ndjenjave në zemra.

Çdo grimcë në këtë gjithësi, i flet njeriut me zemër të gjallë. Të gjitha qeniet flasin vazhdimisht me gjuhë e tyre. Në gjithësi s'ka asnjë grimcë që s'e njeh Krijuesin e vet. I gjithë krijimi bart vulën e fuqisë së Krijuesit të Madhëruar, i Cili i krijoi nga asgjëja. Detyra e njeriut është të thellohet në meditimin e manifestimit të fuqisë dhe madhështisë hyjnore dhe të shohë këto vula hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim.



Arrija e kënaqësisë së artit hyjnor

Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë të gjerë zemre, veprat e artit hyjnor në gjithësi, nuk i shohin në mënyrë sipërfaqësore, por sikur shohin një oqean të thellë. Dhe, duke vërejtur oqeanet e fshehtë në një pikë, ata përparojnë në atmosferën shpirtërore. Diellin që lind, si manifestim i fuqisë hyjnore dhe tablotë shumëngjyrëshe që pikturojnë rrezet e diellit në perëndim, ata i vështrojnë me habi e admirim. Dhe, duke shfletuar fletët e gjithësisë, ata magjepsen pas njëmijenjë mistereve dhe urtësive.

Fjalët nuk mjaftojnë dhe gjuha është e pafuqishme të shprehë gjendjen e një shpirti që dëgjon dhe të një zemre që sheh. Ja pra, ata që e shohin gjithësinë me këto ndjenja shpirtërore, arrijnë të shijojnë Artin Hyjnor në mrekullitë e panumërta që Zoti ynë shfaq në natyrë.



Shikim urtësie mbi librin e gjithësisë

Për arsye se njerëzit e devotshëm të Allahut e shohin çdo krijesë me syrin e urtësisë, tek ata nuk gjendet “shikimi” i rëndomtë ndaj mrekullive të gjithësisë, ashtu siç gjendet tek njerëzit e tjerë indiferentë.

Ata shohin gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë dhe dizajnin e mrekullueshëm në krahëve e fluturave. Po ashtu, ata u vënë veshin “hu-hu”-ve që lëshojnë kumritë, vërejnë detajet e mrekullueshme në krijimin e njeriut dhe mahniten pas mrekullive hyjnore siç janë shikimi i syrit dhe perceptimi i trurit. Ata thellohen në meditimin e këtyre veprave hyjnore njësoj siç shohin me ëndje horizontin e pafund.



Dhikri më emocional

Njeriu që arrin të shohë me sytë e zemrës, e kupton se gjithësia përbëhet plotësisht prej manifestimeve të fuqisë dhe madhësisë hyjnore dhe në çdo gjë vëren dorën e mistershme të artit hyjnor. Çdo gjë në gjithësi, e njih atë me një bukuri hyjnore. Madje, edhe melodia vajtuese që rrjedh prej zemrave sa një bulëz të bylbylave është një dhikr emocionues është për zemrat e ndjeshme...



Kur thellohesh në meditim...

Bishr-i Hafi ka thënë:

“Nëse njerëzit do të meditoinin ashtu siç duhet mbi madhësitinë e Allahut, nuk do t’i rebeloheshin Atij.” (Ibn Kethir, I, 448)

Ndërsa njerëzit e zemrës kanë thënë:

“Allahu është aq i dukshëm, saqë nga intensiteti i dukjes mbetet i padukshëm!”



Shikim i veçantë

Sa bukur shprehet një i urtë:

“Për të mençurit, kjo botë është meditim mbi shfaqjet madhështore të fuqisë hyjnore, ndërsa për mendjeshkurtrit, është ushqim dhe kënaqje e epsheve.”

Ndërsa Shejh Sadi thotë:

“Për shpirtrat e ndriçuar, edhe gjethja e një peme mjafton për të njohur dhe falënderuar Allahun. Ndërsa për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethe.”



Mos u bëj i shkujdesur!..

“Frymët e profetëve ndikonin edhe mbi gurin. Fjalëve të tyre u përuleshin edhe malet. Mirëpo, mendjelehtët nuk i prek qoftë edhe një prej perlave të urtësive që shpërndanin ata!”

“Mendjelehti dëgjon vdekjen e të gjithëve, por vdekje e vet as që e çon nëpër mend...”

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Mos u bëj prej të shkujdesurve!”

(A'raf, 205)



Të mos verbohen zemrat!..

Ka shumë njerëz që shohin me sytë e ballit, por u janë ngurtësuar zemrat për shkak të indiferencës; për shkak se jetojnë si të mefshtë dhe injorantë ata janë verbuar edhe ndaj urtësive dhe të vërtetave hyjnore. Lidhur me këta, në Kuran urdhërohet:

“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (Haxh, 46)




Një indiferencë e tmerrshme!

Ismail Hakki Bursevi ﷺ thotë:

“Sa i madhëruar është Allahu, i Cili e bën të dëgjojë një copë delli si veshi, e bën të shohë një copë dhjami si kokërdhoku i syrit dhe e bën të flasë një copë mishi si gjuha; që i ka pajisur bimët me fruta e fara, kafshët me mish e me dhjam, tokën me pemë e lumenj dhe qiellin me yje dhe dritën e tyre; që e ka caktuar natën për të pushuar njerëzit dhe që dhuron aq sa dëshiron prej mirësive të panumërta të ditës!...


Megjithëse ti, nuk arrin të bëhesh rob i Tij i merituar, Ai të ulerëson dhe të furnizon materialisht dhe shpirtërisht, sikur nuk ka rob tjetër përveç teje. Ndërsa ti, je aq indiferent ndaj adhurimit të Atij, sikur të kishe ndonjë Zot tjetër. (Sa injorancë e madhe dhe mosnjohje e vetes është kjo!)” (shih.

Ruhu'l-Bejan Kur'an Meâli ve Tefsiri, I, 94-95)



Shih artin e vërtetë!..

Sa e çuditshme është se kur njeriu sheh ndonjë kështjellë të stolisur në mënyrën më pompoze, mbetet i mahnitur prej saj. Atij nuk i hiqet nga mendja dhe rri gjithë kohën duke folur rreth bukurisë së saj. Kurse përballë kësaj gjithësie madhështore, që është një mrekulli e artit hyjnor, të cilën e sheh dhe e vështron vazhdimisht, ai nuk mendon sa duhet rreth imtësive të saja dhe nuk flet për të. Ai e anashkalon atë si të ishte diçka krejt normale. Njësoj si shkëmbinjtë që nuk kanë asnjë përfitim nga shirat e pranverës që bien mbi to... Kurse ajo kështjellë e përkohshme që e ka lënë të mahnitur, është vetëm një grimcë e vogël e kësaj bote që është një nga trupat më të vegjël të kësaj gjithësie madhështore...




Ç'është mistika Islame?

Mistika Islame shpërben për të njohur Allahun në aspektin shpirtëror. Ajo është një disiplinë e pastrimit të shpirtit dhe një mënyrë për të arritur devotshmërinë duke braktisur çdo gjë që të largon prej Allahut. Ajo është një shkollë e përsosmërisë së vazhdueshme shpirtërore.




Xhihadi i madh

Mistika Islame është një përleshje pa paqe kundër egos/nefsit, sepse egoja është një forcë e mistershme që mund të nënshtrohet vetëm me xhihadin e madh. Ajo është një cilësi që bën të rrjedhë në damarët tanë me një frymëzim shpirtëror parimet dhe kriteret për t' u bërë robër të Allahut. E thënë ndryshe, ajo është edukim dhe pastrim shpirtëror, duke e vënë egon nën urdhrat e shpirtit.



Udhëtim prej besimit në mirësi

Mistika Islame, do të thotë të pish deri në ngopje prej burimit të dorëzimit ndaj Allahut dhe bartja e “besimit” drejt një horizonti më të lartë, siç është “mirësia”. Ajo është arti i miqësisë me Allahun, duke qenë i kënaqur me caktimin e tij në çdo kohë dhe vend. Ajo është aftësia për të qenë gjithmonë një rob i mirë, ndërkohë që ruan ekuilibrin përballë kushteve dhe surprizave të ndryshme të jetës dhe i harron ankesat dhe qarjet.



Harmoni shpirt-trup

Mistika Islame është pjesa e brendshme e fesë, thelbi dhe thellësia shpirtërore e saj. Nga ky aspekt, ajo është si laktoza brenda qumështit. Nëse hiqet ajo, nuk mbete tjetër veçse një tufë rregullash të thata.

Edhe fjala duhet, edhe kuptimi; edhe shpirti është i nevojshëm, edhe forma... E rëndësishme është të mos fokusohesh vetëm tek njëra dhe të braktisësh tjetrën. Pra, urdhrat hyjnorë t'i zbatosh brenda një ekuilibri shpirt-trup...



لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُوْلُهُ
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُوْلُهُ

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allah dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun....”
(Ahzab, 21)

Thellësia shpirtërore

Mistikë Islame, do të thotë ta ndjesh Kuranin dhe Sunnetin me thellësi shpirtërore dhe t'i jetosh ato me pasion. Ajo është përpjekja për ta njohur më nga afër dhe me dashuri të Dërguarin e Allahut (a.s.), për të përfituar prej personalitetit të tij shembullor dhe për të jetuar në përputhje me shpirtin e fesë.



Jehona shpirtërore e Mevlanës

“Për sa kohë të kem shpirt, unë jam robi i Kuranit; pluhuri i rrugës së Muhamedit (a.s.)... Nëse dikush përcjell fjalë të tjetra nga fjalët e mia përveç kësaj, unë jam i mërzitur edhe prej tij, edhe prej asaj fjale...”



Ç'është devotshmëria?

Devotshmëria është largim i njeriut prej mohimit, idhujtarisë, hipokrizisë, prej çdolloj rruge të keqe e të devijuar dhe prej jetës së pakuptimtë e shtazore, duke iu dorëzuar Allahut, duke e organizuar jetën sipas urdhrave dhe ndalesave të tij dhe duke hyrë në një disiplinë të fortë morale.



Të ruhesh prej gjembave të gjynahut

Një ditë, Omeri (r.a), e pyet Ubej bin Ka'bin (r.a), se "ç'është devotshmëria?" Ubej (r.a) i tha:

"O Omer! A ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?"

Omeri (r.a) u përgjigj:

"Po, kam ecur." Atëherë Ubej (r.a), e pyet përsëri:

"Po mirë, çfarë bëre?" Omeri (r.a) u përgjigj kështu:

"Përvesha rrobën time dhe bëra shumë kujdes për t'u ruajtur nga gjembat." Atëherë Ubej (r.a) thotë:

"Ja pra, kjo është devotshmëria!"



Devotshmëria: Dera e takimit me Zotin

Devotshmëria është takimi i robit me Krijuesin e tij, thellë në zemër, duke përjetuar pasqyrimin e cilësive hyjnore si mëshira, dhembshuria, falja e dituria. Pra, kërkimi i kënaqësisë së Allahut të Madhëruar në çdo veprim e çdo frymë.

Devotshmëria është mësuesi më i mirë dhe udhërrëfyesi më i sigurt. Devotshmëria duket qartë në të drejtë dhe në shtrembër, në të mirë dhe në të keqe. Me devotshmërinë merret rruga e miqësisë për tek Allahu. Si pasojë e kësaj devotshmërie dhe miqësie, Allahu i bëhet robit të Tij, syri me të cilin shikon, veshi me të cilin dëgjon dhe zemra me të cilën kupton.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

"...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë." (Huxhurat, 13)

Ndjeshmëria ndaj devotshmërisë

Ndonjëherë, një mirësi e vogël që duket e thjeshtë dhe e parëndësishme, mund të tërheqë aq shumë mëshirën e Allahut, saqë bëhet shkak i mirësive dhe favoreve të mëdha. Për këtë arsye, nuk duhet të anashkalohen as mirësitë e vogla që duken të parëndësishme.

Përkundër kësaj, ndonjëherë, një gjynah i vogël që mund të duket i thjeshtë dhe i parëndësishëm, mund të shkaktojë zemërimin e Allahut, duke e kthyer ahiretin e njeriut në një vend dënimi të përjetshëm. Për këtë arsye, **Bilal bin Sa'd** رضي الله عنه ka thënë:

"Mos shih vogëlsinë e gjynahut, por kundër kujt e bën atë gjynah!"



Kush është shembulli ynë?

Enes bin Malik رضي الله عنه ka thënë:

“Vërtet ju i bëni disa punë, të cilat në sytë tuaj janë më të vogla se fija e flokut, kurse ne në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.) i konsideronim prej gabimeve (gjynaheve) më të mëdha.” (Buhari, Rikak, 32)


Besimtari duhet të ruhet rreptësishtë prej gabimit të krahasimit të vetes me nivelin e përgjithshëm të shoqërisë në çështjet shpirtërore. Përkundër kësaj, nuk duhet të harrojë kurrë se shembulli i tij janë Profeti (a.s.) dhe sahabët e tij fisnikë.



Ushqimi i Shpirtit

“Mos e ushqe shumë trupin me yndyrë dhe mjaltë. Sepse ai që ushqen tepër trupin bëhet pre e pasioneve dhe dëshirave epshore, duke humbur kështu dinjitetin dhe nderin.”

“Shpirtit jepi ushqim shpirtëror. Ushqeje atë me mendime të pjekura, intuitë të hollë dhe ushqime shpirtërore, me qëllim që të forcohet për udhëtimin e tij.”



Lufta e brendshme

Rumiu, luftën e brendshme të njeriut e shpreh me këto fjalë:

“O udhëtar drejt Zotit! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, dije se as Musai e as faraoni nuk kanë vdekur, por jetojnë të fshehur brenda teje, brenda qenies tënde, duke vazhduar luftën e tyre në fushëbetejën e shpirtit tënd.”

Të gjitha veprimet dhe sjelljet e njeriut janë pasqyra e botës së tij të brendshme. Ashtu siç nuk mund të bëhet një vijë e drejtë prej një vizoreje të shtrembër, ashtu edhe nuk mund të priten sjellje të virtytshme prej dikujt që nuk e ka të kthjellët botën e zemrës.



Nevoja për edukimin e egos

Lidhur me egon njerëzore **Ibn Kajjim el-Xheuziu** shprehet:

“Subhanallah! Egoja ka mendjemadhësinë e Iblisit, smirën e Kabilit, harbimin e popullit Ad, rebelimin e popullit Themud, paturpshmërinë e Nemrudit, pretendimin e Faraonit për hyjnizim, poshtërsinë e Hamanit, padrejtësinë dhe djallëzinë e Karunit, lakminë e Bel’ amit, dredhërinë e As’habi Sebtit, inatin e Uelid bin Mugires dhe injorancën e Ebu Xhehilit. (...) Mirëpo, edukimi dhe disiplina shpirtërore, e shpëtojnë njeriun nga të gjitha këto cilësi të këqija.” (el-Fevaid,

Bejrut 1986, fq. 98)



Dy anët e peshores

Aspektet shpirtërore dhe trupore të njeriut, i ngjajnë dy anëve të peshores. Kur njëra prej tyre rëndohet, tjetra lehtësohet. Nëse zemrat nuk largohen nga kënaqësitë e përkohshme, nuk i arrijnë dot kënaqësitë e përjetshme. Njësoj si fëmija që nuk shkëputet nga qumështi dhe për rrjedhojë nuk mundet t'i shijojë ushqimet e tjera më të mira.

A black and white photograph showing the silhouette of a person kneeling in prayer against a dark sky with a crescent moon. The person's hands are raised in a gesture of supplication. The image is framed by a decorative, repeating geometric border.

Devotshmëri me vetëdijen e mirësisë

Vetëdija e mirësi arrihet kur besimtari e ndjen veten vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore dhe në atë mënyrë i kryen të gjitha adhurimet dhe veprat e tij. Përfitimi i kënaqësisë prej adhurimeve, të ndihesh i palodhur dhe i pa mërzitur prej tyre, mund të arrihet vetëm në sajë të ndjenjës së mirësisë. Ai që nuk ka ndjenjë mirësie në zemër, lodhet edhe nga falja e namazit. Nëse është i pasur, atij i vjen rëndë të japë zekat dhe sadaka, sepse, për shkak se ndodhet larg ndjenjës së vëzhgimit hyjnor, nuk ka arritur të shijojë as ëmbëlsinë e besimit.




Për të shpëtuar prej indiferencës

Për të bërë të mundur qëndrimin larg indiferencës, duhet ta përmendim vazhdimisht Allahun dhe nuk duhet ta harrojmë Atë, sepse gjyhet bëhen atëherë kur je i shkujdesur ndaj Allahut. Lidhur me këtë, në Kuran urdhërohet:

“Ti përmende Zotin tënd në vete, me respekt e me druajtje, jo me shprehje të larta, në mëngjes e në mbrëmje dhe mos u bëj prej atyre që nuk kanë kujdes.” (Hashr, 19)

Dhe, me të vërtetë që, askush nuk mund t’i vërë shkopinj nën rrota vëllait të vet duke bërë bismillah. Atij që i rreh zemra duke thënë “Allah”, nuk mund të ngulë gjemba në zemrat e të tjerëve, nuk u hyn të tjerëve në hak dhe nuk zhytet në gjynahe me vetëdije.



Të gurëzosh shejtanin

Gurëzimi i shejtanit është një nga ritet e haxhit. Mirëpo, Allahu i madhëruar kërkon prej nesh që me anë të “eudhu billahit”, ta gurëzojmë atë në çdo çast të jetës sonë.

Nëse ne nuk e gurëzojmë shejtanin me adhurimet, moralin dhe mirësitë tona, ai fillon të na gurëzoj neve me ndjenja dhe vese të këqija.



Me kë jemi?

Allahu i Madhëruar është me ne kudo që të jemi. E rëndësishme është; me kë jemi ne!?

Ata që e harrojnë e Allahun, i Cili thotë se është më afër nesh se damari i qafës sonë dhe e humbin Atë prej botë së tyre të zemrës, janë udhëtarët më të hutuar të kësaj jete!..

Një zemër që nuk e harron Allahun kur gëzon mirëqenie dhe rehati materiale e shpirtërore, do ta gjejë afër Allahun edhe kur të ndodhet në vështirësi.



“...Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!...” (Teube, 40)

Të jesh bashkë me Allahun

Besimtari, shpirti i të cilit në këtë botë është i lidhur me Allahun, nuk e shkon jetën kot në vrazhdësinë e egos, nuk priset në amoralitet dhe poshtërsi, nuk vrapon pas aventurave të panevojshme, nuk zhytet në besëtytni e gjëra të kota dhe nuk i kalon kufijtë dhe nuk mashtrohet nga dashuri të kota; nuk diskuton me injorantët kur ata e ngacmojnë dhe nuk e njollos kalendarin jetës së tij me thashetheme, por jeton duke u përpjekur të bëhet mik i Allahut të Madhëruar.

Për ata që janë pavetëdijshëm ndaj Allahut dhe përplasen nga erërat e fatit në shirësen e jetës, nuk qan as bota që lënë pas, nuk qesh as bota tjetër që i pret dhe u del përballë...



Ëmbëlsia e dhikrit

Për robërit që shijojnë ëmbëlsinë e dashurisë hyjnore, duke arritur të vërtetën e dhikrit, të gjitha gjërat e kësaj bote e humbasin vlerën e tyre. Për rrjedhojë, Ibrahim bin Et'hemi, i cili i la mënjanë mirësitë e kësaj bote dhe u zhyt në detin e dashurisë hyjnore, thotë:

“Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë.”

Në jetën e kësaj bote, kohët e kaluara larg dhikrit, pra, frymëmarrjet e konsumuara në harresë ndaj Allahut, janë fletë prej kalendarit të jetës që kanë shkuar dëm.

حَسْبِيَ اللَّهُ

“...Më mjafton Allahu, s’ka zot tjetër përveç Tij...” (Teube, 129)

Ka Allah nuk ka qeder!

Vdekja më e tmerrshme është mosnjohja e Zotit dhe humbja e pëlqimit të Tij!..

Sa bukur shprehet **Ataullah Iskenderi**:

“O Allah! Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfarë gjeti ai që të humbi Ty?”

Ndërsa Hasan el-Basri, shprehet:

“Nëse Allahu është me ty, nga kush frikësohesh? E nëse Allahu nuk është me ty, atëherë tek kush i mban shpresat dhe tek kush do të strehohesh?”



بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Qetësia

Ashtu si peshku që nuk jeton dot pa ujë, ashtu edhe një besimtar nuk mund të gjejë qetësi pa përmendur Allahun, sepse:

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmend-jen e Allahut!” (Ra’d, 28)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

“Shembulli i atij që e përmend Allahun dhe atij që nuk e përmend, është si i gjalli me të vdekurin.”

(Buhari, Deavat, 66)



Drita e dhikrit

Drita e dhikrit, është në varësi të gjendjes së atij që bën dhikër. Për një dhikër të pranuar, më parë duhen braktisur haramet dhe të dyshimtat dhe duhen nxjerrë nga zemra të gjitha ambiciet egoiste. Po ashtu, dhikri nuk duhet të mbetet vetëm në gjuhë. Zemra duhet të thellohet në meditimin e dhikrit.



Pastrimi me anë të lotëve

*“Pendohu me një zemër të mbushur me zjarrin
e pendesës dhe me sy të lagur! Sepse lulet çelin në
vende me diell dhe lagështi!”*

*“Papastërtitë e brendshme nuk lahen me ujë, por
vetëm me lot!”*



Lutje që meriton pranim

Fillimi i lutjes duke pranuar mangësinë dhe pafuqinë ka ndikim të madh në fitimin e mëshirës hyjnore. Me të vërtetë, duatë e robërve të devotshëm të Zotit që derdhin lot pa reshtur për faljen e gjynaheve janë meritore për t'u pranuar, e jo duatë e mendjemëdhenjve që e mendojnë veten të pagabueshëm.



Nga se varet pranimi i duasë?

Një herë, Ibrahim bin Et'hemin e pyetën:

“Pse nuk na pranohen duatë?”

Ai u përgjigj:

“- Allahun e njihni, por urdhrat e Tij nuk i zbatoni!

-Profetin e njihni, por sunnetin e tij nuk e veproni!

- Kuranin e lexoni, por me të nuk punoni!

- Hani nga të mirat që u ka falur Allahu, por nuk falënderoni!

- Xhenetin e dini, por nuk mundoheni ta fitoni!

- Xhehenemin e dini, por nuk shqetësoheni!

- Thoni se ka vdekje, por nuk përgatiteni!

E si të pranohet duaja e dikujt që është kaq i shkujdesur!?”



A më do Allahu?

- Kë do dhe kë nuk do Allahu? Vallë, a jam unë prej atyre që i do Allahu, apo -Allahu na ruajttë- që nuk i do?

- A ka vend dhuna dhe padrejtësia në jetën time? A thyej zemra? A u ngul gjemba zemrave, qoftë me fjalët, e qoftë me sjelljet e mia?

- A ka përkushtim dhe devotshmëri në adhuret e mia?

- A ka gënjeshtër, thashetheme dhe përgojime në gjuhën time? A del ndonjë fjalë e gabuar nga goja ime?..

Ja pra, këto janë pyetjet me të cilat duhet t'i kërkojmë gjithmonë llogari vetes.



T'i kemi qëllimet e pastra

“Kush i njofton njerëzit për një të mirë që ka bërë, me qëllim që të bëhet i famshëm, Allahu ia nxjerr në shesh të fshehtat. Kush u tregon të tjerëve të mirën që ka bërë, me qëllim që të fitojë admirimin e njerëzve, Allahu do t'i nxjerrë në shesh hipokrizinë.”

(Buhari, Rikak 36, Ahkam 9; Muslim, Zuhd 47-48)

The image features a central piece of Arabic calligraphy in a bold, black, cursive style. The word 'As-Salam' (Peace) is written in large, expressive letters. Above and below the main text are smaller, more delicate calligraphic elements, including what appears to be a signature or a smaller version of the word. The entire calligraphic composition is set within a rectangular frame with a decorative, repeating floral border. The background of the frame is light and textured.

Uniteti i të jashtmes dhe të brendshmes

Mevlana thotë:

*“Ki kujdes! Mos bëj kurban hijen e dhisë!
Mishi dhe kocka e kafshës që bëhet kurban, është
hija (e kurbanit); ndërsa qëllimi i kurbanit, është
dorëzimi dhe devotshmëria ndaj Allahut.”*



Ajo që të çon në zjarr!

Ndërkohë që Allahu i Madhëruar u thotë “të mjerë” edhe atyre që e falin namazin në mënyrë të shkujdesur, duhet menduar mirë se si do t’u vejë halli atyre që nuk falen fare...

Siç tregohet edhe në Kuran, banorët e Xhenetit do t’i pyesin prej së largu banorët e Xhehenemit:

“Çfarë ju ka sjellë në Sekar? Ata do të përgjigjen: «Nuk ishim nga ata që falnin namaz...»” (Muddeththir, 42-43)



Kibla e zemrës


Nëse zemra është me Allahun, punët e kësaj bote nuk të dëmtojnë. Mirëpo, adhurimi që bëhet me një zemër të shkujdesur nga kjo botë, ka shumë të meta!.. Nisur nga kjo, ashtu siç është Qabeja kibla e trupit në namaz, ashtu duhet të jetë edhe Allahu kibla e zemrës. Tregohet se:

Mexhnuni i cili endej nëpër shkretëtirë i dashuruar pas Lejlës, padashur kalon përpara një njeriu që po falte namaz. Kur e përfundoi namazin dhe dha selam, njeriu u grrit dhe e qorton me ashpërsi:

“A nuk e di ti që nuk kalohet para dikujt që po fal namaz?!”

Ndërsa Mexhnuni ia priti me këto fjalë:

“Unë nuk të pashë fare ty, për shkak të dashurisë ndaj Lejlës! Po ti si më pe mua ndërkohë që ndodheshe në namaz para të dashurit tënd, Allahut?!”



Namazi, kriter personaliteti

Ebu'l Alije, një nga imamët më të mëdhenj të Tabiinëve, tregon:

“Kur shkonim tek filani për të mësuar hadith, uleshim pranë tij dhe shihnim mënyrën si falej, me mendimin se, nëse falej në rregull edhe punët e tjera duhet t'i bënte në rregull, por nëse falej gabim, edhe punët e tjera i bënte gabim dhe kështu largoheshim prej tij.” (Darimi, Mukaddime, 38/429)



Namazi i pranuar

Një namaz i pranuar, siç urdhërohet edhe në Kuran, duhet ta pengojë njeriun nga të këqijat. Nëse dëshirojmë të kuptojmë se a na janë pranuar pesë namazet farz dhe ato namaze nafile (vullnetare), që i falim si shtesë, mjafton të shohim sa larg prej gjynaheve jemi në jetën tonë të përditshme.



Që të mos pësojmë firo në veprat tona

Abdullah bin Umer (r.a.), ka thënë:

“Nëse nuk shmangeni nga haramet dhe gjërat e dyshimta, Allahu nuk do t’jua pranojë adhurimet, edhe nëse dobësoheni e kërruseni si hark duke falur namaz, edhe nëse treteni e bëheni si gozhdë duke agjëruar!”

Ndërsa Aliu (r.a.), ka thënë:

“Jepini më tepër rëndësi pranimit dhe ruajtjes së veprave të mira se sa veprimit të tyre!”



Vlera e adhurimit

Nëse dikush na sjell dhurata shumë të çmuara, por na i jep ato me fytyrë të vrenjtur dhe pa dëshirë, ne nuk do të kemi shumë dëshirë t'i pranojmë ato. Mirëpo, edhe gjëja më e vogël që mund të na jepet nga shpirti, me sinqeritet dhe mirësjellje, ne do ta pranohim atë me shumë dëshirë dhe do të ndjenin dashuri për atë që na e jep.

E njëjta gjë vlen edhe për adhurimet dhe devotshmërinë që robi i ofron Allahut. Sa më shumë pasion dhe dëshirë të përmbajnë adhurimet dhe veprat që bëjmë për hir të Allahut, aq më shumë vlerë do të kenë ato tek Ai, sepse Allahu nuk ka nevojë për adhurimet tona. Ne jemi ata që kemi nevojë për Atë.



Edukata në vepra

Të urtët kanë thënë:

“Adhurimi e çon njeriun në Xhenet. Ndërsa edukata dhe respekti gjatë adhurimit, e çojnë atë tek Allahu dhe e bëjnë mik me Të.”

Enes bin Malik رضي الله عنه ka thënë:


“Edukata në vepra, është tregues i pranimit të tyre.”



Të jetosh me entuziazmin e adhurimit

Bishr-i Hafi e llogariste veten në këtë mënyrë:

“E si mund të fle unë, kur Resulullahu (a.s.), kryente adhurime natën derisa i ënjteshin këmbët edhe pse i ishin falur gabimet e të shkuarës dhe të ardhmes!? Unë nuk e di a më është falur qoftë edhe një gjynah i imi!..”



Gjendja e besimtarit

Një besimtar i sinqertë që ecën në rrugë të Allahut, nuk del kurrë i dëmtuar, sepse edhe nëse ai dëmtohet në aspektin e kësaj bote, ai është i fituar në aspektin e botës tjetër. Në një hadith fisnik thuhet:

“E çuditshme është çështja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është mirësi për të dhe kjo është e tillë vetëm për të. Nëse besimtarit i ndodh një gëzim, ai falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi. E nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), dhe po ashtu, edhe kjo i sjell dobi.” (Muslim, Zuhd, 64)



Të mbruhesh në kthetirat e vuajtjes

Sëmundjet, fatkeqësitë dhe dëshpërimet, e kthejnë robin nga Zoti i vet dhe përherë e bëjnë të thotë: “Aman o Zot!”.

Forca e shpirtit, rritet në përputhje me vështirësitë që kapërcen. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ka sprovuar me shumë vuajtje edhe profetët, sepse në këtë mënyrë, zemra do të jetë më afër Allahut dhe energjitë negative nuk do të ndikojnë tek ajo.

Nëse bletët nuk do të bënin mjaltë, kush do t’u jepte vlerë atyre? Pra, edhe njeriu duhet të kalojë me sukses njëmijenjë sprovë në rrugë të Allahut dhe ta adhurojë Atë me pasion, që të ketë vlerë.



Urtësia e vuajtjeve

Njerëzit që nuk vuajnë, nuk përjetojnë vështirësi dhe i gjejnë një zgjidhje çdoherë, kanë ego të fryrë, e cila bëhet si një kalë i egër. Madje, ata shkojnë aq larg sa të pretendojnë edhe se janë hyjni. Shembujt më të qartë të këtyre janë Faraoni dhe Nemrudi.

Nisur nga kjo, robërit e devotshëm të Zotit, i kanë konsideruar si mirësi vuajtje dhe vështirësitë që u kanë rënë, sepse ato i kanë afruar edhe më shumë tek Allahu.

Kështu edhe gurët në brigje bëhen të fortë si granit duke u rrahur vazhdimisht nga dallgët për vite me radhë.



Kush do trëndafilin, nuk pyet për gjemba

Es'ad Erbili ka thënë:

“Nuk mund të kesh frikë prej gjembave në rrugën e kopshtit të dashurisë! Unë mbledh me qindra gonxhe mbi gjemba!”

“Në kopshtin e devotshmërisë ndjej kënaqësi prej vuajtjes. Nëse prej gjembave bëj jastëkun, në ëndërr shoh trëndafilin!”

A piece of Arabic calligraphy in a decorative, ornate frame. The text is written in a bold, black, cursive style. It reads 'Bismillah' (Bismillahir-Rahmanir-Rahim) and includes the year '1431' at the bottom left. The calligraphy is set against a light background within a square frame, which is itself surrounded by a larger, intricate decorative border.

Mirësia e fshehtë brenda fatkeqësisë

Jo çdo fatkeqësi ngjan për shkak se meritohet. Ndonjëherë një individ mund të pësojë një fatkeqësi, në mënyrë që ai të vërë mbi kokë aureolën e nëpërkëmbjes, në mënyrë që të fitojë nivele shpirtërore nëpërmjet durimit dhe në fund fare, të shpërblehet në jetën tjetër për durimin e treguar me vendimin e Zotit. Në qoftë se fatkeqësitë do të binin vetëm mbi personat që i meritojnë ato, të gjithë njerëzit do të bëheshin të mirë me pahir dhe profetët nuk duhet të kishin përjetuar asnjë lloj fatkeqësie. E vërteta është se profetët kanë qenë personat që kanë vuajtur më shumë se të tjerët fatkeqësitë më të mëdha në këtë jetë. Për më tepër, ata kanë vuajtur, megjithatë kanë gëzuar cilësinë e pafajësisë. Megjithatë, ata kanë arritur shpërblimin e mrekullueshëm të durimit të tyre.



Në çdo gjë ka një mirësi

Nuk duhet të harrojmë se ashtu si çdo mirësi, edhe vështirësitë janë pjesë të sprovave. Nëse Allahu nuk na e ka bërë të mundur një gjë, këtë duhet ta shohim me syrin e zemrës dhe duke menduar se: “Edhe në atë ka një mirësi”, e të falënderojmë për çdo gjë. E në fakt, Allahu është Ai që di çdo të fshehtë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini!” (Bekare, 216)




Sprovë edhe në pasuri, edhe në varfëri...

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: «Zoti im më ka nderuar». Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: «Zoti im më ka poshtëruar.»” (Fexhr, 15-16)

Në peshoren hyjnore në ahiret, do të bëhet e qartë se çfarë ka qenë më e mirë për njeriun, mirësitë e pakta apo të shumta. Kjo, sepse mirësia e paktë, ka më pak përgjegjësi, ndërsa mirësitë e shumta kanë më tepër. Në fakt, për njeriun i cili nuk mund t’i kuptojë siç duhet urtësitë dhe të fshehtat e caktimit hyjnor, është më mirë që t’i dorëzohet caktimit të Allahut.



Bëhu ilaç mirësie!

“Durimi i trëndafilit ndaj gjembit, i fali atij aromën e mirë.”

“Bëhu melhem mirësie! Mos u bëj gjemb që shpon! Nëse s’do të të vijë e keqe prej dikujt, mos u bëj fjalëkeq, mos u bëj mësues i të keqes, i tillë që mendon keq! Me tërë qenien ndodhu mes të mirëve!”



Edhe kjo do të kalojë...

“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin. Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzit nga hidhërimet! Mos u mërzit nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes.”



Receta e paqes

Me qëllim që të arrijmë qetësinë shpirtërore,
i Dërguari i Allahut ﷺ na ka këshilluar kështu:

“Shikoni ata që i kanë kushtet e jetës më të ulëta se tuajat, e jo ata që i kanë më lart se tuajat! Kjo është një sjellje më e përshtatshme për ju, me qëllim që të mos i nënçmoni mirësitë e Allahut që keni.” (Muslim, Zuhd, 9)

“...Kush shikon atë që është më lartë se vetja në çështjet e fesë dhe e ndjek atë, ndërsa në çështjet e kësaj bote sheh atë që është më poshtë se vetja dhe falënderon për mirësitë që i ka dhënë Allahu, Allahu do ta shkruajë atë njeri si falënderues dhe durimtar...”

(Tirmidhi, Kijamet, 58/2512)



Besimi duhet vërtetuar

Ashtu si pastërtia e arit përftohet përmes nxehtësisë së tij në temperatura tepër të larta edhe besnikëria në besim provohet përmes durimit, pranimit, tevekkulit dhe ruajtjes së qetësisë dhe ekuilibrit përballë fatkeqësive dhe vështirësive të ndryshme në jetë.

Nga kjo pikëpamje, besimtari i ngjason pozitës së floririt midis metaleve të tjera. Nëse bie në baltë, nuk humbet asgjë nga vlera e tij.



Ruajtja e ekuilibrit mes baticave dhe zbaticave

Të pasurit bujarë dhe falënderues dhe të varfrit dinjitozë e të duruar janë të barabartë në nderin njerëzor dhe pëlqimin hyjnor.

Falënderimi, pëlqimi dhe dorëzimi ndaj Allahut, duhet të jetë një cilësi e pandryshueshme për besimtarin, edhe nëse ndryshojnë kushtet e jetës.

Mevlana ka thënë:

“Nëse në çdo erë lëkundesh si bar, nuk vlen as sa bari edhe nëse je sa një mal.”



Besnikëria ndaj Zotit

A nuk e sheh se si fëmija struket tek prindërit kur ka frikë? Po ne? Sa jemi të dorëzuar ndaj fuqisë hyjnore?! Ja pra, nëse arrijmë ta bëjmë këtë, nuk do të na tronditë asnjë vështirësi e kësaj bote. Rebelimi ndaj caktimit të Zotit, nuk do të na sjellë veçse dështime. Është njësoj si të kërkosh rrugëdalje në rrugët pa krye.

Edhe qentë e vendosur për të bërë roje nëpër oborre vlerësohen në bazë të besnikërisë. Pra, edhe tek një kafshë kërkohet fisnikëri. Lidhur me këtë, Mevlana ka thënë:

“Besnikëria është vlerë edhe për qentë. Ndërkohë që pabesia është një njollë dhe turp edhe për qentë, si mundesh ti si njeri të tregohesh i pabesë!?”



Ç'është gjithë kjo lakmi?!

Deri më sot, asnjë zog nuk është përpjekur të bëjë më shumë fole se sa fqinji i vet. Deri më sot, asnjë dhelpër nuk është mërzhitur se ka vetëm një vrimë ku të futet. Deri më sot, asnjë ketër nuk ka ngordhur prej stresit se nuk ka grumbulluar arra për dy dimra e jo për një dhe asnjë qen nuk ka kaluar netët e tij pa gjumë se nuk ka mbledhur kocka për vitet e tij të pleqërisë. Pra, ndërkohë që të gjitha krijesat i mbështeten dhe i dorëzohen kaq shumë Allahut, po ti, ç'e ke gjithë këtë lakmi o njeri?!.

لَنْ شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ

“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia...” (Ibrahim, 7)

Falënderimi

Çdo njeri me ndërgjegje dhe logjikë, ia ka për borxh një falënderim edhe atij që i jep qoftë edhe një gotë ujë. Dhe kur i jepet rasti, ia kthen atë mirësi me të njëjtën gjë. Nisur nga kjo, mund të themi se, qëndrimi i njeriut në mënyrë të ftohtë e të vrenjtur përballë të gjitha mirësi që i ka falur Allahu i Madhëruar, nuk është aspak e logjishme.


Të mos harrojmë se, të gjithë ne po mbushim kasetën e jetës, e cila do të hapet për t’u shikuar në ditën e gjykimit. Dhe, kur të vdesim, do të varrosemi me veprat tona. Ndërsa në ditën e llogarisë hyjnore, sytë, veshët, lëkura dhe të gjitha organet tona do të fillojnë të flasin, duke shpalosur çdo gjë që kemi bërë në jetën e kësaj bote.



Sado që të falënderojmë është pak!..

Detyra më e rëndësishme për ne njerëzit, është të mundohemi të lajmë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut. Edhe krijimi prej asgjësë, është një mirësi për të cilën jemi të paaftë të falënderojmë... Po mirësia e të qenit njeri midis të gjitha krijesave, e të qenit besimtar midis gjithë njerëzve, e të qenit prej umetit të Muhamed Mustafait ﷺ në mesin (sipas transmetimeve) e 124 mijë profetëve?..

Edhe sikur të biem në sexhde, në shenjë falënderimi përballë Allahut për të gjitha këto mirësi dhe të mos e ngremë kokën gjatë gjithë jetës, përsëri është pak, përsëri është e mangët, madje një "hiç"...



Mos u jep pas furnizimit, e të harrosh Furnizuesin!

Nëse ne e harrojmë personin që na ka dërguar një dhuratë të çmuar dhe mjaftohemi vetëm me falënderimin e personit që na e sjell atë, kjo është shumë e çuditshme dhe e gabuar. Në të njëjtën mënyrë, nëse ne e harrojmë Furnizuesin e vërtetë të mirësive që kemi, duke u përqendruar vetëm tek shkaqet që i kanë sjellë ato mirësi, apo tek vet mirësia, kjo tregon një mosmirënjohje shumë të madhe. Për njeriun, nuk mund të imagjinohet turp dhe humbje më e madhe se sa të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive, pra të harrojë Allahun.



Tradhtia më e madhe


M. Sami Ramazanollu thotë:

“Fëmijën që kundërshton një baba të butë, e quajnë të çmendur. Prandaj, çfarëdo që të thuhet për atë që kundërshton urdhrat e Allahut të Madhëruar, i Cili është më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve, është vërtet pak!..”



Martesa dhe familja në Islam

Martesa, është urdhri i Allahut, suneti i Resulullahut (a.s.), pranvera e brezave, dinjiteti dhe edukata e mashkullit dhe e femrës, kalaja e namusit dhe nderit dhe veçoria dalluese e njeriut nga krijesat e tjera.



Zgjedhja e bashkëshortit/es

Fatkeqësisht në ditët tona, ndër karakteristikat që kërkohen më shumë tek vajza dhe djali që dëshiron të martohet është interesi material. Mirëpo Profeti ﷺ e ka këshilluar umetin e vet t'i japë përparësi fesë dhe moralit të bukur, duke thënë:

“Kur të vijë tek ju dikush me moralin dhe besimin e të cilit jeni të kënaqur, jepjani vajzën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, do të shfaqen trazira dhe shturje.” he, këto fjalë i ka përsëritur tre herë.¹

1. esh-Shejh Mansur Ali Nasif, et-Taxhu'l-Xhami li'l-Usul fi Ehadisi'r-Rasul, Misir, 1961, K. Nikah ue't-Talak ve'l-Iddet, II, 284.



Çerdhja e ngrohtë familjare

Çerdhja familjare e Profetit tonë (a.s.), ashtu si edhe karakteri i tij i lartë, në çdo aspekt është çerdhja më ideale dhe më shembullore.

Asnjë grua, nuk e do burrin e saj aq sa e deshën nënat tona të Dërguarin e Allahut (a.s.). Dhe, asnjë burrë nuk e do gruan e tij, në të njëjtën gradë të dashurisë që kishte i Dërguari i Allahut (a.s.), për bashkëshortet e tij. Asnjë fëmijë, nuk e do babanë e vet ashtu siç e deshi Fatimja (r.a.), babanë e saj. Dhe, asnjë baba nuk e do fëmijën e tij, ashtu siç e deshi i Dërguari i Allahut vajzën e tij Fatimen (r.a.).

Kush dëshiron qetësi dhe lumturi në familjen e vet, duhet të përpiqet vazhdimisht të marrë shembull prej familjes së nderuar të Profetit tonë (a.s.).



Gruaja e devotshme: Krijesa më e mirë në botë

Virtyti dhe nderi i gruas, e kthen shoqërinë në Xhenet. Dhe, brezat që rriten në atë Xhenet, bëhen burimi mi paqes së popullit. Nga ky aspekt, gruaja e devotshme, është si abazhuri i kristaltë i familjes dhe i shoqërisë. Në një hadith fisnik,

Profeti (a.s.), ka thënë:

“Kjo botë është një pasuri (gjithçka nga e cila përfiton perkohësisht). Dhe, pasuria më e mirë e saj është gruaja e mirë (e ndershme dhe fetare).” (Muslim,

Rada, 64; Nesai, Nikah, 15)



Stolia e llojit njerëzor: Gruaja e devotshme

Lumturia e grave, është e mundur kur ato jetojnë si zonja fisnike. Nëse gruaja shkon jashtë detyrës së saj të vërtetë, ajo e çon familjen drejt dështimit. Pjesëmarrja e gruas në çështjet e jashtme, mund të bëhet vetëm për shkaqe të detyrueshme dhe për punë që përshtaten me natyrën e saj. Por, këto shkaqe të detyrueshme duhen vlerësuar në mënyrë objektive. Pra, duhen përcaktuar në bazë të nevojave të shoqërisë dhe nuk duhen kaluar kufijtë e pranueshëm e legjitim.

E vetme, gruaja nuk është as një gonxhe trëndafili, e as një gjemb. Nëse ajo edukohet brenda një jete shpirtërore, bëhet trëndafil. Por, nëse lihet në mëshirë të fatit, mund të bëhet një gjemb shumë helmues.



Thesari i ndershmërisë

Gjëja më e shtrenjtë dhe e çmuar e një gruaje është nderi i saj. Gruaja mund ta ruajë prestigjin dhe dinjitetin e saj vetëm përmes nderit.

Urdhri për t'u mbuluar është shfaqje e pozitës dhe vlerës së lartë që Islami i ka dhënë gruas. Thesaret me vlerë dhe të çmuara mbrohen në mënyrën më të mirë.



Virtyti i mëmësisë

Nëna e devotshme është një burim mëshire që Allahu i ka dhuruar njerëzimit. Zemra e nënës është mulliri ku bluhen dhe shkrihen tekat e fëmijëve.

Një nënë e devotshme meriton falënderime, mirënjohje dhe respekt të përjetshëm.

Profeti ynë (a.s.), ka thënë se Allahu ia ka bërë dashura tre gjëra nga kjo botë dhe, njëra prej tyre është “gruaja e devotshme”. (shih.

Nesai, Ishretu'n-Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199.)



Respekti ndaj nënës është detyra jonë

Mevlana ka thënë:

“Kujdes ndaj hakut të nënës! Bëje kurorë mbi kokë, sepse sikur nënat mos të vuanin dhimbjet e lindjes, fëmijët nuk do të gjenin rrugë të vinit në këtë botë...”

Nuk ekziston krijesë tjetër e cila do të meritonte dashurinë dhe nderin e këtyre nënave të vërteta, të cilat na bartin neve një herë në barkun e tyre, më pas në kraharorët e tyre, kurse deri në vdekje në zemrat e tyre. Nënata besnike të cilat veten e bëjnë shtrojë dhe fli për familjen, meritojnë një dashuri madhore, nderi të thellë dhe falënderim e përkushtim jetësor.



Një brez fisnik

Edukimi i një brezi fisnik, është një ndjenjë e lartë njerëzore. Për këtë arsye, ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me dashuri ndaj adhurimeve. Në mënyrë të veçantë, nuk duhet të kursejmë asgjë në lidhje me edukimin e tyre sipas normave Islame. Nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të jenë të përsosur, duhet të përpiqemi të bëhemi prindër të përsosur.



Zogjte e Xhenetit

Prindërit më të mëshirshëm, janë ata që e përgatisin njëri-tjetrin dhe fëmijët e tyre në devotshmërinë ndaj Allahut.

Fëmijët lindin me një pastërti të përshtatshme për Xhenet. Mirëpo, nëse prindërit e neglizhojnë edukimin shpirtëror të tyre, ata i fluturojnë këta zogj të Xhenetit -Allahu na ruajt- në një vend të gabuar...



Natyra e farave

Fëmijët janë amanete hyjnore të cilat u janë falur prindërve të tyre. Fëmijët lindin në natyrshmërinë e pastër islame. Prandaj, zemra e tyre është si një tokë e pastër, si një xhevahir i papërpunuar. Për këtë arsye, ai ka nevojë të përpunohet. Nëse në të ardhmen, do të jenë trëndafila apo gjemba, do të japin fruta të hidhura apo të ëmbla, varet nga gjendja e farës shpirtërore që do të hidhet në zemrat e tyre.

Shoqëritë e forta, janë vepra familjeve të forta dhe nënave të virtytshme. Shembujt më të mirë të këtyre, janë gratë sahabe. Ato i mësuan fëmijët e vet të sakrifikonin me jetët dhe pasurinë e tyre dhe i mbrujtën zemrat e tyre me dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).



Të jesh një çoban i mirë

Një çoban i mirë, nuk e kullot tufën e tij në vende të shkreta, por në vendet të gjelbra, të begata dhe me ujë. Kështu, edhe prindërit e mirë, duhet ta çojnë fëmijën e vet në vende ku mund të marrë mjaftueshëm ushqim shpirtëror që në moshë të vogël.

Për shembull, gratë sahabe, i qortonin fëmijët e tyre kur ata nuk shkonin për një kohë të gjatë tek i Dërguari i Allahut (a.s.). Ato përpiqeshin shumë që fëmijët e tyre t' merrnin edukimin e duhur prej njerëzve të devotshëm.



Trashëgimia e vërtetë

Trashëgimtarët më të afërt të një besim-tari, janë fëmijët e tij. Ndërsa trashëgimia e vërtetë që duhet t'u lihet atyre, është pasuria e përjetësisë. Fëmijëve tanë nuk duhet t'u lëmë trashëgim pasuri dhe kënaqësitë e përkohshme, por një lumturi që nuk vyshket dhe nuk shterohet. Dhe ajo është Kurani Fisnik dhe Suneti profetik që na ka lënë amanet i Dërguari i Allahut (a.s.). Kujdesi që duhet treguar në përcjelljen e këtij amanet tek fëmijët tanë, konsiderohet një sadaka e pandërprerë. Ndërsa neglizhimi i kësaj detyre, do të jetë një fatkeqësi për çdo prind në botën tjetër.



Shqetësimi për të ardhmen

Prindërit më të mëshirshëm, janë ata që e përgatisin fëmijën e tyre për ardhmërinë e tyre të vërtetë, që është ahireti, duke e edukuar atë nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunnetit.

Me mendimin që fëmijët tanë të kenë një të ardhme të mirë në këtë botë, ne shpenzojmë mund dhe pasuri të shumtë që ata të studiojnë në një shkollë apo universitet cilësor. Por, sa përqind e këtyre përpjekjeve shpenzohen për ardhmërinë e përjetshme, pra për botën tjetër të fëmijëve tanë? Edukimi i fëmijëve tanë me vetëdije fetare, është detyra janë parësore... Përndryshe, nuk duhet të harrojmë se ditën e gjykimit, fëmijët tanë do të na padisin edhe pse janë më të dashurit tanë!..



Shqetësimi për brezat

Sot, përgjegjësia jonë më e madhe është ajo kundrejt fëmijëve tanë... Kjo sepse sistemi liberal, në sajë të parimit “lëriini të veprojnë, të bëjnë ç’të duan”, po formojnë personalitetin e fëmijëve tanë me propagandat negative të televizionit, adresat e pista të internetit, ngacmimet e çmendura të modave dhe teknikat mashtruese të reklamave që po përhapin helm në jetën shpirtërore dhe fryjnë egot njerëzore. Pra, duke e turbulluar botën e tyre të zemrës, ata i bëjnë të huaj ndaj fesë, kulturës, historisë, e madje edhe ndaj familjes së tyre...

Për rrjedhojë, për ta mbrojtur veten, fëmijët, familjen, të afërmit dhe shoqërinë tonë nga këto fenomene negative, jemi të detyruar të marrim masat e duhura pa qenë ende vonë.



Të shohësh të ardhmen

S'ka nevojë të jesh çudibërës për të parë të ardhmen e një populli. Për këtë, mjafton të shohësh se ku i shpenzojnë energjitë të rinjtë e atij populli. Nëse të rinjtë e tyre i shpenzojnë energjitë e tyre në punë të mira dhe të dobishme, e ardhmja e atij populli është e ndritur. Në të kundërtën, nëse ata i shpenzojnë energjitë pas dëshirave të egos, fundi i tyre do të jetë vetëm dështim.



Nevoja për njerëz të kualifikuar

Një mendimtar thotë:

“Mes popujve sundues dhe popujve të shtypur, ka vetëm një gram dallim. E ky është një grusht njerëzish të kualifikuar!”



Të diturit e vërtetë

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Thuaj: «A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!»” (Zumer, 9)

Të dish, nuk do të thotë vetëm të shohësh. Dija e pranueshme, është të kuptosh shkakun e ardhjes dhe të ikjes nga kjo botë.

Të dish, do të thotë të shpëtosh prej robërisë së egos dhe të zgjohesh në mëngjesin e së vërtetës. Të jemi të vetëdijshëm se në pronën e kujt po jetojmë.

Të dish, do të thotë të familjarizohesh me manifestimet e madhësisë dhe fuqisë hyjnore dhe të marrësh mesazhet hyjnore që gjenden në çdo gjë. Pra, të kuptosh gjuhën e natyrës së krijesave dhe të arrish të deshifrosh misterin e ekzistencës në gjithësi.



Shpirti që do të ringjallë shoqëritë

Shpirti që do të ndriçojë dhe edukojë shoqërinë, nuk është shpirti i cili thjesht është i dhënë pas librave, por shpirti i besimtarëve të mirë i cili është thelluar dhe mburrur me urtësitë Kuranore dhe i shërben me mëshirë njerëzimit.




Gomarë të mbushur me libra

Allahu i Madhëruar, gjendjen e atyre që nuk punojnë me dijen e tyre, e ngjason me atë të gomarit që bart vëllime të tëra me libra. A është i vetëdijshëm gomari për librat që bart? Kështu janë edhe njerëzit e shkolluar, të cilët e kanë mbushur memorien me dije, por që nuk kanë arritur t'i kuptojnë ato me zemër dhe nuk i zbatojnë në jetën e tyre...



E keqja më e madhe ndaj fëmijës

Të kapësh një sorkadhe dhe ta lësh atë në mes të ujërve dhe çakejve, nuk është asgjë tjetër veçse budallallëk. E njëjta gjë është edhe kur njeriu e shkollon fëmijën e tij në vende të gabuara, ku nuk ekziston edukimi shpirtëror dhe ku helmatiset vazhdimisht shpirti i tij.



Edukim dykrahësh


Edukimi i njëanshëm dhe i privuar nga aspekti shpirtëror, është i mangët. Në edukim, ekuilibri fizik dhe metafizik është kusht i domosdoshëm. Përndryshe, njeriu do të bëhet si zogu që mundohet të fluturojë me një krah dhe bie pre e një maceje të uritur.

Në marrjen e diturive, më parë duhet kryer edukimi shpirtëror që e ngre nivelin e botës së zemrës, duke u fokusuar në forcimin e devotshmërisë. Kjo, sepse ajo që e bën njeriun të pranuar tek Allahu, nuk është diploma e studimeve fetare, por devotshmëria në zemrën e tij.



Dija e padobishme

Një njeri që nuk është zhvilluar shpirtërisht -sado të jetë i informuar është i destinuar të mbesë i papjekur (në gjendje fillestare). Ai me këtë papjekuri mund të përvetësojë dituritë e dynjasë, mund të bëhet doktor për shembull, e në vend që të dhurojë shërim, bie pre e egos dhe lakmisë së tij, duke u bërë kasap që merret me trafik organesh. Nëse ai është jurist, në vend që të emetojë drejtësi, bëhet lideri i sistemit të kimit ose xhelat i padrejtë. Nëse është një kryetar shteti bëhet përfaqësuesi më i poshtër i dhunës. Nëse përvetëson dituritë fetare duke u bërë prijës feje, shpërfaqë një vizion të thatë të fesë, larg takvasë dhe shpirtit. Sepse nefsi i pakultivuar, duke qenë robi i dëshirave, i vë të gjitha dituritë në funksion të përfitimeve të ulëta...




Përdorimi i mangët i materialit...

Në jetë, çdo gjë duhet të jetë e përsosur. Veçanërisht bota e zemrës sonë!.. Është e famshme thënia: “Gjysmë do doktor të merr jetën, gjysmë hoxhë të nxjerr prej feje.” E njëjtë me këtë, çdo gjë gjysmake, sjell me vete fatkeqësi. Për pasojë, çfarëdo mangësie të ketë në besimin, adhurimet, veprat, jetën familjare dhe në çdo element që përbën ndërtesën e jetës sonë, është lajmëtar i fatkeqësive materiale dhe shpirtërore.



Profesion profetik

Profetët janë edukuesit më të
mëdhenj të njerëzimit dhe edukimi i
njerëzve është profesioni më i shenjtë.
Për të qenë edukator, duhet të zotërosh
nivelin më të lartë të ndjenjave.



Cilësitë e edukatorit ideal

M. Akif Ersoj, e përkufizon kështu një edukator ideal:

*Veten mësues për ta quajtur, besimtar duhet të jesh,
I moralshëm, kompetent, e më pas ndërgjegje duhet të kesh...*


Pra, një mësues, parasëgjithash duhet të jetë besimtar i mirë, prej zemrës së të cilit buron mëshirë. Më pas duhet të jetë i moralshëm dhe të gëzojë një karakter shembullor. Po ashtu, ai duhet të jetë kompetent, ta zhvillojë veten vazhdimisht duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka. Krahas këtyre ai duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe ta vërtetojë humanizmin e vet me virtyte të tilla, si mëshira, butësia dhe vetëmohimi.



Kushti i meritës

Ujërat e cekëta turbullohen edhe me ndotjen më të vogël. Kurse ujërat e thella nuk ndoten lehtë. Përkundrazi, ato që hidhen në to, pastrohen prej ndotjes që bartin.

Njeriu gjynahqar, i ngjan një sendi të ndotur. Nëse ai send është një shami, të mjafton një tas me ujë. Por, nëse ajo është një kominoshe punëtori e ndotur, të duhet një kazan plot me ujë. Ky ujë, është dija, kultura, sinqeriteti dhe urtësia.



S'ka justifikime

Ka mësues që largohen nga shërbimi dhe përpjekja duke justifikuar neglizhencën dhe dembelizmin e tyre me fjalët; “ç’të bëj, s’janë të aftë, kohë e keqe, nuk vjen kurrkush...”. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, u jep mësim atyre prej librit të gjithësisë plot urtësi, duke e bërë një pemë të mbijë në një mur guri dhe duke nxjerrë edhe fruta prej saj.



Metoda në kumtimin e Islamit

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!..” (Nahl, 125)

Njeriu është si fara e hedhur në një tokë të thatë, e cila nuk jep filiza përnjëherë. Por, nëse e ujisim pak atë tokë, pra, nëse e zbusni njeriun me butësi, mëshirë dhe fjalë të ëmbla, kësaj here, toka do të jetë e gatshme ta pranojë farën që keni hedhur në të dhe nuk do të vonojë të japë lulet dhe frutat e saj.



Urrejtje ndaj gjynahut, mëshirë ndaj gjynahqarit

Tek njeriu që e përsos besimin e tij, zhvillohen ndjenjat e mëshirës dhe dashurisë. Dhe kjo, bën të domosdoshme që t'i afrohemi të dobëtëve dhe nevojtarëve me mëshirën e një doktori të mirë në kurimin e pacientëve të tij.

Asnjë doktor nuk hidhërohet me pacientin e tij që është sëmurë, edhe nëse ajo sëmundje ka ardhur si pasojë e gabimit të tij, por e konsideron veten të detyruar dhe përgjegjës për shërimin e sëmundjes së tij. Miqtë e Allahut që jetonin me këto parime morale, nuk ua reflektonin gjynahqarëve urrejtjen që ata ndjenin ndaj mëkatit në vete. Ata i konsideronin gjynahqarët si zogj të plagosur dhe përpiqeshin t'i shëronin brenda sarajeve të tyre të shpirtit.



Metoda e tasavufit

Gjatë një bisede të Mevlanës, vjen një i dehur. Nxënësit e Mevlanës mundohen të nxjerrin jashtë duke e lënduar. Mirëpo, Mevlana, duke menduar se i dehuri ishte një njeri që ka ardhur vetëm për të kërkuar të vërtetën, i drejtohet atyre që po mundoheshin ta nxirrnin, duke i qortuar me këto fjalë:

“Ai ka pirë verën, por jeni dehur ju!”

Pra, edhe metoda e tasavufit, kërkon që urrejtja ndaj gjynahut, të mos reflektohet tek gjynahqari dhe në vend të zemërimit, ndaj tij duhet treguar dhembshuri. Atyre që janë të privuar nga mirësia e besimit dhe atyre që janë kapluar nga dobësitë e egos së tyre, u duhet afruar me gjuhën e mëshirës dhe jo gjuhën e ftohtë e të helmatisur të gjarprit, duke fituar në radhë të parë zemrat e tyre.



Si kopsht me lule

Bota shpirtërore e një besimtari duhet të jetë si një kopsht lulesh, tek i cili çdo zemër mund të gjejë prehje dhe qetësi. Prandaj e kemi për detyrë ta pastrojmë shpirtin dhe trupin nga ndjesitë, mendimet dhe sjelljet të rrënjosura thuajse si gjemba në zemër dhe t'i kthejnë në rolin e predikuesit të mirëfilltë.



Fjalë të buta edhe ndaj Faraonit

Kur Allahu i Madhëruar e dërgoi Musain (a.s.) dhe vëllain e tij Harunin (a.s.), tek Faraoni, i cili gjendej në kulmin e mohimit dhe dhunës, i urdhëroi:

“Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!” (Taha, 44)

Pra, edhe nëse njeriu që kemi përballë është një mohues i nivelit të Faraonit, metoda jonë e këshillimit, nuk duhet të jetë kërcënimi, por fjala e butë dhe e urtë që qetëson zemrat.



Të flasësh me mirësjellje

Mevlana ka thënë:

“Ka fjalë të mprehta si shpata, që presin dhe vrasin miqësinë. Në zemër hapin plagë të pashërueshme. Ndërsa gjelbërimin dhe lulet e dashurisë në kopshtin e zemrës, i thanë dhe i vret si stina e vjeshtës. Por ka edhe fjalë si stina e pranverës. Zbukurojnë çdo anë dhe përhapin paqe e lumturi.”



Zemra mëshiruese

Ata që do të shërojnë zemrat e sëmura dhe të lodhura, që do të qetësojnë kraharorët e vuajtur, do të udhëzojnë mendjet e përhum-bura dhe do t'u falin lumturi shpirttrave, janë personalitetet e larta shpirtërore, të urtët dhe të devotshmit, të cilët i kanë bërë zemrat e tyre vend mëshire për të gjithë njerëzimin.



Këshillimi në mirësi dhe ndalimi nga e keqja

Sot, shumë njerëz indiferentë që ndodhen nën sundimin e egos, përballë baticë-zbaticave dhe furtunave të jetës vihen para në mënyrë të pavetëdijshme si trungjet nga përmbytjet, duke e pandehur si lumturi mjerimin e tyre. Dhe, për shkak se kush rrëzohet nuk e kupton se është rrëzuar, e kush shtrembërohet nuk e kupton se është shtrembëruar, ata nuk e ndjejnë as nevojën për të bërë përpjekje në rrugën e përmirësimit.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ose do të këshilloni për mirë, do të ndaloni nga e keqja dhe do të pengoni padrejtësinë e zullumqarit, ose Allahu Teala do t’ jua bëjë zemrat të ngjashme me njëri-tjetrin (me të prishurit)...” (Ebu Davud, Melahim, 17/4336)



Përgjegjësia e paralajmërimit dhe udhëzimit

Ebu Hurejre رضي الله عنه tregon:

“Dëgjonim (që ndër sahabë thuhej):

Ditën e kiametit, dikush do të kapet për jake nga një njeri që ai nuk e njeh fare. I habitur, thotë:

«Çfarë do prej meje në këtë kohë dhe në këtë çast kaq të vështirë? Unë nuk të njoh fare!» Ai që e ka kapur për jake i thotë:

«Kur ishim në jetën e dynjasë, më pe në punë të këqija dhe nuk më qortove, nuk më ndalove nga e keqja.»” (Mundhiri, *et-Tergîb ve't-Terhib*, III, 164/3506)



Çelës i mirësisë, kyç i së keqes

Një nga shenjat e besimtarit është edhe fakti se ai është çelës i së mirës dhe kyç i së keqes. Pra, është kusht i besimit që aq punohet në rrugë të Allahut me qëllim që të zotërojë e drejta dhe e mira, po aq duhet të punohet edhe për t'i thënë ndal ndyrësive të shejtanit dhe egos, të keqes dhe të kotës.



Çlirimi i vërtetë

Qëllimi i luftës në rrugë të Allahut, nuk është vetëm lufta me shpatë. Shpata është vetëm një copë hekur që përdoret kur është nevoja për të zhdukur padrejtësitë dhe për të përhapur drejtësinë. Xihad nuk do të thotë, të lash token me gjak, ndërsa çlirimi i vërtetë, është ai i zemrave.



Nuk ka justifikim

Është shumë e lehtë për ne të përcaktojmë sasinë e zekatit dhe të shpëtojmë nga përgjegjësia e saj materiale. Mirëpo, mirësitë materiale dhe shpirtërore që Allahu i Madhëruar i ka falur njeriut, lindin një përgjegjësi aq të madhe, sa është pamundur të përcaktosh sasinë e saj, e cila do të mësohet vetëm në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, një besimtar nuk duhet t'i konsiderojë asnjëherë të mjaftueshme veprat që kryen në rrugë të Allahut.

Kështu sahabët, të cilët sakrifkuan jetën, pasurinë dhe çdo gjë tjetër në rrugë të Allahut, edhe në kushtet e vështira të asaj kohe kanë shkuar në zona të largëta si Kinë, Semerkand dhe Stamboll.


Ndërsa sot, nuk kemi as oqeane të vështirë për t'u kaluar, as male të pakapërcyeshme dhe as mure të pakalueshme. Pra, përveç vetes sonë, nuk kemi asnjë pengesë dhe asnjë justifikim tjetër që të na pengojë t'u zgjasim dorën e ndihmës vëllezërve tanë të vuajtur e nevojtarë dhe të kumtojmë të vërtetën tek ata që janë të privuar nga udhëzimi!..



Dhurimi më i bukur

Dhurimi nuk bëhet vetëm prej mundësive materiale. Ne duhet të dhurojmë prej çdo gjëje që na ka falur Zoti ynë. Por, forma më e bukur e dhurimit, është kumtimi i Islamit, duke e jetuar atë ashtu siç duhet.

Besimtari duhet të dhurojë jetë kudo që hyn dhe duhet të kontribuojë në pasurinë shpirtërore të atij vendi.



Mos lëndo zemra!..

Mevlana ka thënë:

“Nëse e dini se kush është në këtë shtëpi të shpirtit, përse e bëni këtë gjë të pahijshme përpara derës?”

“Njerëzit që nuk arsyetojnë, respektojnë mesxhidin për nga natyra njerëzore, por nuk tregohen të kujdesshëm ndaj besimtarëve duke u thyer zemrat.”

Shpirti është vendi ku hedh shikimin Allahu. Krimi më i madh i epshit është thyerja e një zemre, prandaj edhe Mevlana në një tjetër varg thotë:

Qabeja është një ndërtesë që e ka ndërtuar i biri i Azerit, Halil Ibrahim, ndërsa shpirti është vendi ku më i Larti i të Lartëve, Allahu, hedh shikimin.



E keqja dëmton të zotin

Një mysliman nuk thyen zemra, nuk rrënon shpirtra dhe nuk harron kurrë se shpirti është vend shikimi hyjnor. Përkundrazi, e bën zemrën e tij vendstrehim, ku gjejnë paqe dhe qetësi zemrat e lënduara dhe shpirtrat e lodhur.



Të mos lëndosh, e të mos lëndohesh

Të mos lëndosh është diçka relativisht e lehtë, por të mos lëndohesh nuk është në dorën tonë, sepse bëhet fjalë për diçka shpirtërore. Ne arrijmë të mos lëndohemi atëherë kur shigjetat helmuese që ngulen në zemër nga gjërat e përkohshme, të mos ndikojnë tek ne. Kjo është në përputhje me nivelin e përsosmërisë të vetvetes dhe të pastrimit së zemrës.



Dy cilësitë e zemrës së pastër

Të urtët janë të mendimit se dy nga cilësitë e zemrës së pastër janë këto:

- 1) Të mos lëndosh askënd dhe të mos lëndohesh prej askujt, duke shpresuar në fitimin e kënaqësisë së Allahut.
- 2) Kur të jesh i detyruar të zgjedhësh mes punëve të kësaj bote dhe ato të botës tjetër, të mbash anën e punëve të botës tjetër.



Njeriu i mirë

Qëllimi i fesë, është; të edukojë njerëz të sjellshëm, të kujdesshëm, shpirtbutë dhe me botë të pastër shpirtërore. Besimtarët e vërtetë, me fytyrat e tyre të buzëqeshura, janë në një gjendje selami me trëndafilat, zymbylat, bylbylat dhe të gjithë krijesat. Bota e tyre shpirtërore u është hapur si një dritare të gjitha krijesave. Besimtarët e vërtetë thellohen në urtësinë e luleve që çelin, zogjve që cicërojnë, pemëve plot fruta e bëhen delikatë si lulet dhe bujarë si pemët plot fruta.



Edukata dhe mirësjellja

Edukata është kapitali më i çmuar i një udhëtari që ndodhet në rrugë të Allahut. Njeriu nuk mund të jetë edhe fetar, edhe i paedukuar, sepse thelbi i shpirtit islam në besim, është teuhidi, ndërsa në vepra është edukata dhe mëshira.

Nuk duhet të harrojmë se shejtani i mallkuar, nuk u dëbua prej mëshirës së Allahut, për shkak të mungesës së diturisë apo punës, por për shkak të mungesës së edukatës. Pra, shejtanin e shkatërroi virtyti më i mirë, edukata.

Qëllimi i edukimit shpirtëror është që ta bëjë njeriun të vetëdijshëm se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. Në sajë të kësaj vetëdijeje, do të mundësohet që virtytet e larta të njeriut, si mirësjellja, delikatesa, edukata dhe turpi, të bëhen themel i natyrës njerëzore.



Aromë trëndafili

Edukata është si një aromë trëndafili që qetëson shpirtin tonë. Kjo aromë duhet të përhapet në çdo pjesë të zemrës sonë dhe të ndihet në çdo çast të jetës sonë.

Pasuria që sjell ari dhe argjendi ikin një ditë, por pasuria që sjell edukata mbetet përjetësisht...



Respektimi i edukatës

Më e vlefshmja prej edukatës, është kur robit i njeh dhe i ruan kufijtë e vet. Për këtë arsye, është thënë:

“Pranë dijetarit ruaj gjuhën, pranë evliave zemrën, në sofër dorën dhe në shtëpinë e huaj syrin!”



أَمَّا بِنَاهِعِهِ

Feja është edukatë

Të mëdhenjtë e tasavufit kanë thënë:
“Edhe kreu, edhe fundi i rrugës sonë është
edukata.” Ndërsa Mevlana ka thënë:

“Mendja, e pyeti zemrën time:

«–Çfarë është besimi?»

Zemra, u përkul tek veshi dhe i tha:

«–Besimi, është edukatë!”



Besimtari me zemrën sa një det

Një besimtar i përsosur, duhet të zotërojë një zemër të dashur si uji dhe të gjerë si deti. Sado të përballet me ndodhi të padëshirueshme, ai duhet të shfaqë një karakter të pjekur që shpërndan mëshirë. Ai duhet të zotërojë një zemër të pastër që reflekton delikatesë, mirësjellje dhe bukuri të tjera të Islamit.



Bëhu me natyrë trëndafili...

Mevlana ka thënë:

"E rëndësishme është të bëhesh me natyrë trëndafili. Domethënë, jo t'i shohësh gjembat në kopshtin e kësaj bote, të shpohesh nga ta e të bëhesh gjemb, por, sikur në mes të futen edhe vështirësi si dimri, t'i rrethosh gjembat me klimë pranvere e të bëhesh një trëndafil për tërë botën!"

Trëndafili që duron gjembat në kërcellin e tij, duke sikur me ngjyrën dhe aromën e tij të këndshme u drejtohen njerëzve: *"Më shihni me syrin e zemrës dhe bëhuni si unë!"*.



Gjendja e zemrave mike

Ahmed bin Ebu Verd رضي الله عنه i përmbledh me këto fjalë cilësitë e miqve të Zotit:

“Tre gjëra janë që kur forcohen dhe shtohen tek miqtë e Zotit atëherë shtohen edhe tre cilësi të tjera:

1. Kur rriten në pozitë, u shtohet përkorësia dhe modestia.

2. Sa më gjatë të jetojnë, aq më shumë i shërbejnë fesë dhe njerëzve.

3. Sa më të pasur të bëhen, aq më shumë bëhen bujar dhe bamirës.”



Më i mirë... Më i bukur... Më i përsosur...

Një besimtar i cili është edukuar me moralin e Kuranit Kerim, duhet ta lehtëtojë shpirtin me bukurinë dhe aromën e këndshme si një lule e sapoçelur. Çdo fjalë e tij duhet të përbëhet nga shprehje të arta, të cilat ushqejnë shpirtin. Në fytyrën e tij nuk duhet të mungojë kurrë buzëqeshja dhe me gjuhën e ëmbël duhet të përhapë mëshirë. Personaliteti dhe sjelljet e tij duhet të jenë në nivelin e “më të mirës, më të bukurës dhe të më të përsosurës”.

Më i mirë; çdo punë e tij duhet të jetë e dobishme dhe përreth tij duhet të përhapë gjithmonë mirësi.

Më i bukur; duhet të zotërojë një delikatesë dhe butësi që i jep paqe shpirtit dhe qetëson zemrën.

Më i përsosur; duhet të jetë i pjekur dhe i kompletuar. Çdo punë dhe vepër e një besimtari të tillë, pasqyron bukurinë, madhështinë, estetikën, paqen dhe ëmbël sinë e Islamit.



Të kuptosh shpirtin Islam

Një shoqëri, e cila e ka kuptuar ashtu siç duhet Islamin, qoftë nga forma, qoftë nga përmbajtja shpirtërore dhe ka thithur të gjitha qelizat e tij si aromën e trëndafilin, ashtu siç ka ndodhur në shumë periudha të historisë sonë të mbushur me famë e me lavdi, arrijnë të ndërtojnë me sukses një “qytetërim virtytesh”. Besimtarët që zotërojnë këto cilësi, në çdo kohë apo vend që të jetojnë, janë ata fatlumë, të cilët arrijnë lumturinë e të dyja botëve.

Me një fjalë, paqja dhe lumturia e udhëtarit të kësaj jete të rrethuar nga çdo anë me surpriza dhe enigma, varet nga mbujtja e tij me moralin dhe atmosferën shpirtërore të islamit.



Kulm qytetërimi

Çdo qytetërim, formon tipin e vet njerëzor. Dhe ai tip njerëzor, shfaq harmoni me veçoritë dhe karakterin e qytetërimit të cilit i përket.

Qytetërimi Islam, është një majë, e cila është arritur njëherë në historinë njerëzore. Shkaku i kësaj, është se e ka pajisur natyrën njerëzore me dijen dhe urtësinë hyjnore. Pra, duke eliminuar problemet e egos, i ka përzier zemrat me dijen dhe kulturën e vërtetë. Për rrjedhojë, përqaftimi dhe unifikimi i aftësive të natyrshme të umetit me frymëzimin shpirtëror, nxori në pah një qytetërim që arriti majat.



Qytetërimi në arkitekturë

Kur vështrojmë xhaminë Sulejmanije, shihet një siluetë njerëzore që duke sikur ka hapur duart drejt qiellit dhe po lutet. Ky është shpirti i reflektuar në gur... Një kryevepër e qytetërimit tonë, ku përzihen materia me shpirtëroren.

Të parët tanë, të cilët themeluan një qytetërim virtytësh, nuk ndërtonin shtëpi që pengonin diellin dhe i linin në hije shtëpitë e tjera. Ndërsa sot, ndërtesat e larta, madje edhe qiellgërvishtësit të kujtojnë gurët e varreve të qyteteve, shpirtit të të cilave u është hedhur dhé varri.



Qytetërimi në humanizëm

Siç mbart çdo drejtëz, çdo vijë dhe çdo element një pjesë dhe një shfaqje nga përsosmëria e një vepre madhështore arkitekturore, pikërisht ashtu është edhe çdo pjesë e një civilizimi. Ngaqë “njeriu” është qendra e civilizimit tonë, edhe kurora e përsosmërive të tij është “tipi i njeriut” që ka nxjerrë në pah.


Cila shoqëri është më e qytetëruar?

Në të shkuarën, kur morali Islam jetohej ashtu siç duhet, të gjithë besimtarët, të pasur e të varfë, ishin të lidhur me njëri-tjetrin. Të pasurit dhe të varfrit nuk jetonin në lagje të ndryshme, por jetonin në paqe në të njëjtën lagje, e cila ishte një vendstrehim për gratë e veja, njerëzit e vetmuar dhe jetimët. Mirësjellja ishte në kulmin e saj. Nëse në një shtëpi ndodhej ndonjë i sëmurë, në parvazin e dritares vendosej një lule e kuqe, me qëllim që kushdo që ta shihte, të kalonte prej aty pa e shqetësuar të sëmurin, ndërsa fëmijët shkonin dhe luanin në lagjet e tjera.

Vepër i cilit sistem sjelljeje edukimi ishte ky edukim shpirtëror që kishin ata? Cili pedagog, cili psikolog dhe cili antropolog social mund ta japë këtë edukim sot?..

Me fishekzjarrët që ditët e sotme hidhen nëpër dasma dhe festime, po i hyhet në hak të gjithë shoqërisë, duke mos pyetur nëse ka ndonjë foshnje, grua shtatzënë, të sëmurë apo ndonjë familje në zi që shqetësohet nga ajo zhurmë, vetëm e vetëm që të argëtohet një grup nga shoqëria.

Ja pra dallimi në humanizëm dhe mirësjellje mes dy lloj shoqërive!.. Ky është rezultati i hidhur që solli erozioni në kulturë dhe qytetërim që po përjetohet prej dy shekujsh...





Shoqëria e qetë

Nëse i hedhim një sy epokës së lumturisë, nuk përballemi me këto probleme sociologjike dhe ekonomike, sepse agjërimi farz dhe vullnetar bëhej me entuziazmin e besimit. Agjërimi e shtyn njeriun drejt një vetllogarie të ndërgjegjes, duke e bërë atë të kuptojë gjendjen e nevojtarëve dhe t'u afrohet atyre me butësi dhe mëshirë. Zekati, dhurimi dhe sadakatë, të cilat janë shprehje të dhembshurisë dhe mëshirës që tregohet për hir të Allahut, i zgjidhin vetvetiu shumë probleme sociologjike dhe ekonomike.

Me të njëjtën vetëdije, edhe të parët tanë e kanë pajisur shoqërinë me institucione dhembshurie dhe mëshire. Në sajë të xhamive, komplekseve, medreseve, teqeve, spitaleve, çezmave, mensave dhe institucione bamirësie të ngjashme, kanë zgjidhur problemet ekonomike dhe shpirtërore të shoqërisë dhe kanë siguruar paqen dhe qetësinë e strukturës shoqërore.



Të parët tanë dhe ne

Kujt i ngjamë ne dhe brezat tanë në ditët e sotme? A i ngjajnë marrëdhëniet tona farefisnore, fqinjësore dhe miqësore atyre të të parëve tanë, apo të huajve? A i ngjajnë rrugicat, qytetet, tregtia dhe pazaret atyre të të parëve tanë, apo të atyre që janë e kundërta e të parëve tanë?!



Kush jemi ne?

Populli ynë fisnik, është brezi i Mevlanave, Junusëve, Gejlanëve, Nakshibendëve, Hadajive, Fatihëve, Akshemsedinëve dhe Javuzëve. Qytetërimi ynë, ishte një qytetërim virtytësh i pashoq, që ka përhapur të vërtetën, drejtësinë dhe mëshirën në të gjithë njerëzimin. Për rrjedhojë, edhe e kemi për detyrë të jemi vazhdimësia e sotme e atij qytetërimi...



Ti je një popull i madh!

Nëse në historinë tënde ke njerëz altruist si Osman Gazi dhe brezi i tij dhe njerëz shembullorë, e të përkushtuar ndaj Zotit;

Nëse në historinë tënde ke një Fatih, që i tregoi gjithë botës një botëkuptim shembullor të drejtësisë, duke dalë në gjyq me një njeri të thjeshtë prej popullit;

Nëse ke një Kanuni Sulltan Sulejman që mendon për të drejtën e një milingone;

Nëse ke njerëz të zemrës si Mevlanat, Junusët, Hydajitë, Abdulkadir Gejlanitë, Bahaudin Nakshibenditë, që zemrën e tyre e kanë bërë vatër për të gjitha krijesat për hir të Krijuesit dhe njerëz të mirë që frymëzohen dhe ecin në gjurmët e tyre;

Nëse nënat me zemrat e mbushura me Kuran, lindin trima zemërluanë;

Nëse bota është e vogël në sytë e tu dhe nëse lumturia e Botës Tjetër dhe pëlqimi i Zotit janë bërë ideali yt;

TI JE NJË POPULL I MADH!..



Njohja e të metave personale

Musa Efendiu ﷺ thotë:

“Një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka dhuruar robit është vënia në dukje e dobësive që ka. Mirësia ndoshta më e madhe që kam fituar në këtë rrugë shpirtërore është njohja e gabimeve të mia. E kuptova plogështimin tim përpara Zotit. Në këtë mënyrë nuk kam më fuqi të shoh gabimet e tjetrit dhe të merrem me to. Faleminderit Zotit, të gjithave ua di vlerën...”



Njeriu i pjekur, i njuh kufijtë vet

Robëria ndaj Allahut fillon me perceptimin e brishtësisë përballë madhësisë së Allahut. Tek personi që është i vetëdijshëm për këtë nuk mund të shfaqet mendjemadhësia, egoja, uni dhe dëshirat e tepruara të materiale.

Ashtu si degët e pemëve, frutat e pjekura të të cilave bien poshtë dhe ushqejnë me bujari njerëzit, ashtu edhe njerëzit e ditur, të urtë, të zgjuar e të zgjedhur janë modestë e bujarë ndaj njerëzve. Kështu që njeriu duhet ta shndërrojë veten në një thesar prej të cilit përfitojnë të gjitha krijesat.



Mbretërimi i modestisë

Mevlana thotë::

“Toka u dorëzua tek qielli duke i thënë: «Unë jam një rob, ti lësho mbi mua ç’të duash»”.

“Nëse nga dielli bie zjarr mbi të, toka i dorëzohet atij . Ajo, jo vetëm që nuk mund të ikë nga ai zjarr, por e lëshon fytyrën e saj dhe e heshtur i dorëzohet atij”.

“O njeri, edhe ti je një pjesë e tokës. Jeton mbi të, prandaj mos e kundërshto urdhrin, kadanë dhe kaderin e Allahut!...”

“E ke dëgjuar ajetin “Ne u kemi krijuar nga toka”. Kjo do të thotë se Allahu dëshiron që ti të jesh dhe. Mos e kundërshto urdhrin hyjnor!...”

“Allahu thotë: “O njeri, shiko me kujdes! Brenda trupit tënd të krijuar nga dheu, mbolla një farë nga shpirti im dhe kështu të kam lartësuar. Në një kohë që ti ishe pluhuri i kësaj toke, të bëra një krijesë të lartë. Të dhashë mendjen dhe ndjenjën e dashurisë”.

“Ti bëj përpara dhe ji modest. Atëherë unë do të të bëj prijës mbi gjithë krijesat e mia.”



Ji modest si toka!..

Shejh Sadi ka thënë:

*“O vëlla, në fund do të bëhesh dhé! Prandaj
bëhu modest si toka para se të bëhesh dhé!”*

Ndërsa Mevlana ka thënë:

*“A gjelbëron një gur në stinën e pranverës?
Bëhu modest si toka, që prej teje të dalin trëndafila
dhe lule shumëngjyrëshe!..”*



Hutia e mendjemadhësisë

Mevlana ka thënë:

“Shpata pret qafën e kryelartit. Ndërsa hijen nuk është e zonja ta presë asnjë shpatë, sepse është shtrirë për tokë dhe është bërë njësh me të.”

Shejh Sadi shprehet:

“Kush pandeh se ka diçka brenda vetes si kikirik, gjithmonë lëshon lëvore si qepë.”

Ebu Bekri , ka thënë::

“Kur robi bëhet mendjemadh për shkak të një prej mirësive të kësaj bote, Allahu i Madhëruar, e urren atë njeri derisa ajo mirësi largohet prej tij.”

Haxhi Bajram Veliu ka thënë:

“Mendjemadhësia është si një gur i lidhur në mes, me të cilin as nuk notohet, e as nuk fluturohet.”



Çibani në zemër; Mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi

Mendjemadhësi është nënvleftësimi i të tjerëve dhe poshtërimi i tyre, ndërsa vetëpëlqimi është pëlqimi vetëm i vetes dhe të ndjerit superior ndaj të tjerëve. Mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi janë dy cilësi të shëmtuara që nuk ndahen nga njëra-tjetra, rezultatet e të cilave janë shfaqjet e mungesës së prehjes shpirtërore në këtë botë dhe ndëshkimi hyjnor në ahiret.

Besimi monoteist nuk pranon ortakëri. Dhe mendjemadhësia është një budallallëku i vetëatribuimit të mirësive që ka falur Allahu.



Të gjitha mirësitë janë prej Allahut

Çdo mundësi dhe kapital që kemi, i takojnë Allahut Teala. Për këtë arsye, në fjalorin e myslimanit, nuk duhet të ekzistojnë fjala “unë”. Në zemrën e tij, nuk duhet të ekzistojë ideali i egos. Nuk duhet të harrojë kurrë se është rob i Allahut. Gjithçka që ka, duhet t’ia dijë për nder Allahut. Në vend që të thotë, “e bëra unë, e fitova unë”, duhet të thotë, “Ti ma dhurove o Zot; kjo është prej mirësisë së Zotit tim!..



Gjithmonë nevojtarë ndaj Allahut

Një person i tha Jakubit عليه السلام:

“-Si ka mundësi që e ndjeve aromën e këmishës së Jusufit ndërsa po vinte nga Egjipti dhe nuk arrite të ndjesh kurthin e vëllezërve të tij dhe hedhjen në pus këtu para syve.”

Jakubi عليه السلام i tha:

“-Informacioni ynë është i varur nga Shpallja Hyjnore, prandaj nganjëherë shikojmë përmes syrit të zemrës në largësi të mëdha, nganjëherë na bllokohet shikimi për gjëra shumë pranë nesh.”

Nëse Allahu i Lartëmadhëruar ia hap perden robit, ai sheh përtej; por nëse ia mbyll, njeriu nuk sheh as gropën që ka para syve. Pra robi, çfarëdo grade shpirtërore që të ketë, është i dobët. Ai vazhdimisht është nevojtar i mirësisë së Zotit.



Mos u kreno o biri njeriut!

Sa e mahnitshme është kur shohim se nga një anë, një elefant dhjetëra tonësh mund të komandohet nga një fëmijë dhjetëvjeçar (nëse Allahu i jep aftësinë) dhe nga ana tjetër shohim se një virus i vogël, aq sa nuk mund të shihet me sy të zhveshur mposht trupa me fuqi të madhe!..

Kjo nënkupton se njeriu asnjëherë nuk duhet të mburret dhe nuk duhet t'ia atribuojë vetes forcën që ia ka falur Allahu Teala, nuk duhet të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive dhe për këtë gjithmonë duhet të jetojë me ndjenja mirënjohjeje dhe falënderim. Gjithashtu, duhet të kuptojë se nuk është as sa një thërmijë pluhuri përpara fuqisë hyjnore dhe se duhet të kërkojë vazhdimisht strehim tek Krijuesi i tij.



Për të zhvilluar shpirtëroren,
duhet të mposhtësh egon!

Ebu'l Hasan Harakani ka thënë:

“Nëse prej oxhakut kërcen ndonjë thëngjill në rrobën tënde, ti menjëherë përpiqesh për ta fikur. Atëherë, si lejon që zjarri që të djeg besimin, pra, mendjemadhësia, smira dhe syfaqësia të qëndrojnë në zemrën tënde?!”

“Ashtu siç është obligim namazi dhe agjërimi, ashtu është detyrim edhe mënjanimi i zemrës nga mendjemadhësia, zilia dhe ambicia.”

Të biesh në batakun e “mendjemadhësisë” dhe “egocentrizmit”, do të thotë ta spërkasësh shpirtin me helm. E në fakt, as doktrina e teuhidit dhe as cilësia e Zotit “Mutekebbir”, sipas së cilës Zoti është më i Madhi, nuk e tolerojnë ortakërinë me Të.



Të mund të thyesh idhujt në zemër

Një mysliman i vërtetë, i refuzon të gjithë idhujt e rremë në botën e tij të jashtme dhe pranon vetëm Allahun si Zot. Në të njëjtën mënyrë, prej botës së tij të brendshme, ai duhet të eliminojë edhe të gjitha gjendjen dhe sjelljet që bien në kundërshtim me kuptimin dhe shpirtin e monoteizmit. Ashtu siç i theu Ibrahim (a.s.), idhujt në tempull, edhe besimtari duhet ta pastrojë vendin e besimit, pra zemrën e tij prej idhujve të egos, si mburrja, mendjemadhësia, syfaqësia, vetëpëlqimi, lakmia, ambicia etj.



Aftësia e vërtetë

Nuk është dobësi dhe burracakëri të falësh, kur i ke të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë. Falja është një nga virtytet më të vyera të njeriut. Njeriu, kur është i pafuqishëm, nuk mund të hakmerret, prandaj virtyti i vërtetë është të falësh, kur i ke të gjitha mundësitë për t'u hakmarrë. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34)



Të keqen largoje me të mirë!..

“Njeriun e mund mirësia”. Nëse ai që i bën një të mirë është armik, do të të bëhet mik, nëse është mik do të të afrohet edhe më shumë dhe, nëse nuk është as mik, as armik, do të afrohet nga miqësia. Njeriu të cilit i kemi zgjidhur një hall dhe shoqëria në të cilën përhapim dashuri, janë tanët.



Durim dhe tolerancë ndaj të paditurve dhe mendjelehtëve

Pema me fruta gjuhet. Ashtu siç duhet të jetë e përgatitur për t'u gjuajtur me gurë pema me fruta, ashtu edhe besimtarët e pjekur duhet të jenë të përgatitur për vështirësitë dhe pengesat që do t'u shkaktojnë të paditurit. Të durosh e të rezistosh për hir të Allahut ndaj padrejtësive dhe vështirësive që të shkaktojnë njerëzit, është një vetëdije e lartë besimi.

Xhelaledin Rumi thotë:

"Trëndafili ka erë dhe bukuri nga që ka duruar shoqërinë me gjambat."



Metoda e mëshirës

Imam Sha'bi, atyre që e ofendonin,
u thoshte kështu:

*“Nëse ato që thua janë të vërteta,
Allahu më faltë! Nëse nuk janë të vërteta,
Allahut të faltë!”*



Fal që të falesh

Besimtarët e përsosur, bazuar në parimin: “Ai që nuk di të falë të tjerët, nuk do të falet.”, tregohen falës ndaj robërve të Zotit, në mënyrë që ata të meritojnë faljen hyjnore. Vallë, ata persona të cilët sot nuk shprehin vullnetin që të falin robërit e Zotit dhe kanë një shpirt interesaxhi, egoist dhe të pandjeshëm, me çfarë fytyre mund t’i kërkojnë falje Allahut nesër në ditën gjykimit? Sëmundja e mosfaljes së të tjerëve buron nga indiferenca njeriut, sepse zotëruesi i vërtetë i faljes, është Zoti. Besimtarët mund të falin të tjerët në varësi të dashurisë që ata ushqejnë në zemrat e tyre ndaj Allahut.

Për rrjedhojë, shndërrimi në shprehi e faljes së padrejtesive që të bëhen duke i konsideruar ato “të paqena”, duke mos ndjerë as mërzinë dhe as pikëllimin më të vogël në zemër, është vepër e perfeksionimit shpirtëror dhe trimëria më e madhe morale.



Mbulimi i gabimeve

Për hir të atributit të Tij, Settar, Allahu na ka mbuluar shumë gjynahe dhe i ka lënë ato si pika të zeza në zemrat tona. Kjo është shprehje e madhëstisë, mëshirës dhe faljes së Tij të pafundme. Në qoftë se gjynahet do të dukeshin si pika të zeza në ballë dhe jo në zemër, nuk ka dyshim se askush nuk do të kishte fytyrë të vështronte dikë tjetër.




Bëhu i dobiprures, jo dëmtues!..

Mëshira e Allahut, mbizotëron ndaj zemërimit të Tij. Pra, Ai i fal robërit e Tij gjynahqarë, të cilët e kanë merituar dënimin, në sajë të një pendimi të singertë. Po ashtu, për mirësitë më të vogla të robërve, Ai u dhuron shpërblime të shumëfishta, ashtu siç i ka hije Madhështisë së Tij. Ndërsa besimtari, duhet të sillet gjithmonë me këtë ndjenjë mëshire, duke u përpjekur të ketë një shpirt gjallërues e gjelbërues, dhe jo rrënues.

Një shembull të këtij morali, na e tregon edhe Ebu Hurejre (r.a.):

Gjatë një beteje, i kërkua të Dërguarit të Allahut, të lutej për shkatërrimin e mohuesve të fesë. Mirëpo, ai tha: *“Unë nuk jam dërguar si mallkues, por si mëshirë.”* (Muslim, Birr, 87)



Mos u ushqe urrejtje në zemër!..

Mevlana ka thënë::


“Nëse dëshiron Xhenetin në këtë botë, bëhu mik me të gjithë, e mos mbaj mëri askënd, sepse miqësia mbush zemrat me gëzim. Ai moment gëzimi është vetë Xheneti. Nëse e urren një person, ajo urrejtje të ndjek nga pas dhe gjithmonë do të jesh i trishtuar. E, ky trishtim është vetë Xhehenemi.”



Dashuri dhe urrejtje për hir të Allahut

Ai që është i privuar nga orientimi i imanit dhe nuk di se ku do të gjallojë dashuria e tij, i ngjan anijes së cilës i është thyer timoni në mesin e oqeanit dhe nuk dihet se ku do të mbytet.

Dashuria që nuk mund ta gjejë atë që e meriton, është një shpërdorim i hidhur i kësaj bote të përkohshme. Dashuritë që ngecin në grackën e interesave të pavlera e të ulëta, u ngjajnë luleve që çelin në qoshe të kalldrëmeve, të cilat herët a vonë janë të dënuara të shkelen apo të këputen. Sa i pafat është një diamant i rënë në rrugë! Sa humbje e hidhur është të jesh pasuria e padrejtë në një dorë që nuk e meriton!



Kë duhet të duam, e kë jo?

Besimi i vërtetë, kërkon dashuri ndaj atij që e meriton dhe urrejtje ndaj atij që e ka hak. Të urresh ata që nuk i do Allahu, po aq sa e do Allahun dhe ata që do Ai, është kusht i një besimi të shëndoshë. Orientimi i dashurisë tek ai që e meriton atë, është shkak i një përfitimi të madh shpirtëror. Në të kundërtën, nëse e çojmë dëm tek dikush që nuk e meriton, kjo bëhet shkak i një humbjeje të përjetshme.



Miku i vërtetë

Në këto kohë, shumica e njerëzve janë miq të interesit. Nisur nga kjo, duhet të mos mashtrohemi lehtë prej pretendimeve për miqësi të atyre njerëzve që nuk i kanë dhënë provat e miqësisë, nuk janë testuar me vështirësi dhe nuk njihen në aspektin e personalitetit dhe karakterit. Kjo është diçka shumë e rëndësishme në zgjedhjen e mikut.

Mevlana ka thënë:

“Të gjithë janë miq në kohë të mirë, por në kohë të keqe veç Allahut s’mbetet asnjë tjetër!”



Kur humbasin interesat...

A jemi me të vërtetë të sinqertë në dashuri dhe në çdolloj mirësie që bëjmë? Apo mos vallë jemi hipokritë që në çdo sjellje që duket si mirësi, kemi interesa personale?

Përgjigjen e kësaj pyetje, mund ta gjejmë ose kur të bëjmë një vetllogari serioze, ose në mënyrën më të hidhur, atëherë kur interesat tona të humbasin papritur...

Ja pra, në atë çast do të shohim se tullumbacet e dashurisë së rreme që fluturojnë përreth nesh, do të shfryhen një nga një.

Në këtë rast, a duhet të zemërohemi me ata që largohen prej nesh kur u humbin interesat, apo me veten tonë që e lidh dashurinë me fijet të kalbura të interesit?



Sinqeriteti në miqësi

Abdullah ibën Abbasi ka thënë:

“Atë që do, duaje për hir të Allahut! Atë që braktis, braktise për hir të Allahut! Dije se kështu fitohet kënaqësia e Allahut... Sot, për fat të keq njerëzit janë bërë shumë materialist. Dashuria dhe urrejtja e tyre janë vetëm për interesa të kësaj bote...”



Dy faktorë

Ekzistojnë dy faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shpirtin e njeriut:

- 1) Niveli i hallallit të kafshatës që kalon fytin e tij.
- 2) Gjendja shpirtërore e atyre me të cilët ai shoqërohet.

اللَّهُمَّ احْشِرْ رَأْسِي فِي الْحَبْرَةِ

Kujdes me kë shoqërohesh!

Imam Gazaliu, ka thënë:

“Biri im! Nëse ka diçka për të cilën duhet të bësh kujdes të jashtëzakonshëm, është çështja se me kë shoqërohesh. Dije mirë se, një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjë të mirë një mollë të prishur midis tyre. Mirëpo, kjo mollë e prishur, mund t’i prishë edhe të tjerat. Për këtë arsye, qëndro gjithmonë me njerëzit e mirë!”

Njerëzit e mirë reflektojnë paqe dhe qetësi në zemra, ndërsa gjynahqarët reflektojnë shqetësim dhe ngushtësi. Një fillad ere, që fryn mbi një kopsht të zbukuruar me lule të bukura dhe aromë të mirë, si trëndafilat dhe karafilat, kudo që shkon, shpie edhe aromën e tyre që kënaq zemrat e njerëzve. Ndërsa një erë që fryn mbi kalbësira me erë të keqe, do t’i përhapë ato aroma të këqija kudo përreth. Në këtë mënyrë, ajo ua zë frymën dhe ua ngushton kraharonin njerëzve. Për rrjedhojë, edhe miqësia me njerëzit e këqij dhe gjynahqarë, bëhet kanceri i jetës shpirtërore.



Zgjidhe mirë shokun!

Shejh Sadi Shirazi thotë:

“Një qen fitoi besueshmëri vetëm pse ruajti të devotshmit dhe meritoi të përmendej edhe në Kuran, ndërsa gratë e profetëve Nuh (a.s.) dhe Lut (a.s.) ranë në mohim dhe u bënë banore të Xhehenemit, sepse qëndronin me jobesimtarët dhe i përkrahnin ata (pra nuk u bëri dobi fakti se ishin gra të profetëve).”

Siç thotë edhe Imam Gazaliu; shoqërimi me gjynahqarët dhe indiferentët, me kalimin e kohës shndërrohet në unitet të mendjeve dhe të zemrave, gjë e cila e shpie njeriun drejt shkatërrimit.



Quajtja e zemrave

Në ditët tona, shumica e njerëzve janë në një indiferencë dhe pavetëdije të tmerrshme dhe shkojnë drejt të panjohurës së errët, si trungje që merren para nga përmytjet. Nëse ne nuk arrijmë t'i shpëtojmë njerëzit tanë nga këto rryma, të tjerët do tu japin atyre formën që dëshirojnë vet, sepse ashtu si fizika që nuk pranon zbrazëti, ashtu edhe zemrat nuk pranojnë zbrazëti. Imam Shafiiu ka thënë:

“Nëse nuk e angazhon veten me të vërtetën, do të pushtojë e kota.”


كُفْرًا بِالصَّادِقِينَ

“...bëhuni me ata që janë të singertë!” (Teube, 119)

Ai që është në Jemen,
është afër meje...

Synimi i shoqërimit me njerëzit e mirë, është uniteti i zemrave, pra, të ndihesh dhe të veprosh si ata në çdo situatë të jetës. Nëse ekziston një unitet i tillë, ka dobi edhe prej shoqërimit fizik me ta. Në të njëjtën mënyrë, edhe ndarja prej tyre nuk të dëmton aspak. Prandaj edhe të urtët kanë thënë:

“Ai që është në Jemen, është afër meje, ai që është afër meje, është në Jemen.”



Uniteti i zemrave

Ndarja e trupave, nuk sjell ndarjen e shpirtave. Madje, ndonjëherë, si pasojë e mallit të zjarrtë, zemrat afrohen edhe më tepër me njëra-tjetrën dhe bëhen një e vetme.

Mirëpo, nëse ka ndarje shpirtërore, asnjë afërsi fizike, asnjë lidhje gjaku dhe asnjë lidhje dashurie apo shoqërore, nuk shpreh afërsinë e vërtetë. Afërsia që ka dobi tek Allahu, është uniteti i zemrave me njerëzit e mirë.



Edhe privimi që të ruan nga e keqja është mirësi

Daudi ﷺ, kërkonte strehim tek Allahu me këto fjalë:

“O Zoti im! Mos më ndaj prej vendit ku përmendesh Ti! Por nëse dëshiroj të shkoj në vendin e të shkujdesurve ndaj Teje, m’i thyej këmbët pa arritur ende atje! Nëse Ti vepron kështu, për mua është një mirësi shumë e madhe.”



Biseda; Kuvendi i marrëdhënieve shpirtërore

Në krye të metodave që përdoren për të ndikuar në shpirtin e njeriut gjatë edukimit shpirtëror, renditet “biseda”. Kuvendet e bisedave, janë qendra të rehabilitimit dhe marrëdhënieve shpirtërore...

Ndërsa ai që i bën bisedën efektive, është “sinqeriteti”. Kjo, sepse kuptimi që u ngarkohet fjalëve dhe kalimi i tyre në zemrat e njerëzve, duke ndikuar në pjekjen e personaliteti dhe sjelljeve të tyre, arrihet në sajë të sinqeritetit. Gjatë qëndrimit bashkërisht në bisedat e sinqerta shpirtërore, zemra përfitojnë nga njëra-tjetra. Me kalimin e kohës, gjendjet e zemrës, kënaqësitë, urrejtjet, ndjesitë dhe mendimet fillojnë t’u ngajnë njëra-tjetrës.



Biseda dhe etika e saj

Bisedat (fetare) që zhvillohen me përkushtimin që u jepet edhe adhurimeve, janë një pasqyrim prej bisedave të Profetit (a.s.). Njësoj siç ndizet një qiri prej një qiri tjetër, ai (Profeti) është qendra kryesore e frymëzimit shpirtëror. Për këtë arsye, ata që marrin pjesë në bisedë, duhet të mbështillen me një ndjenjë të fortë edukate dhe respekti, sikur të ishin duke marrë pjesë në një prej kuvendëve të Profetit (a.s.) dhe duhet të dëgjojnë me gjithë zemër, me qëllim që në zemrat e tyre të rrjedhë frymëzimi shpirtëror...



Eliksir për zemrat

Ka njerëz që janë bërë e shkuar ndërkohë që kanë qenë ende gjallë. Por, ka edhe njerëz që, edhe pse kanë jetuar shekuj më parë, frymët e tyre që u falin jetë zemrave, janë plotë jetë edhe sot. I tillë është edhe Xhelaledin Rumi, i cili shprehet:

“Ti mblihd mendjen dhe dëgjoji me dëshirë këshillat e të urtëve! Dëgjoji dhe shpëto nga mërzia dhe frika, arrije rehatinë shpirtërore, fito siguri!”

Fjalët e të urtëve janë plot eliksir, si një lumë i pastër dhe i kthjellët. Sa ta kesh rastin në dorë, pi gjersa të ngopesh prej tij që në zemër të të çelin trëndafila e lule të tjera shpirtërore!”



Të devotshmit: Burim frymëzimi

Njeriu që arrin njohjen intuitive e shpirtërore të Allahut me kuptimin e plotë të fjalës, ndodhet nën ndikimin e shfaqjes së afërsisë dhe dashurisë së Allahut. Aq, sa të gjitha prirjet e egos, digjen një nga një siç digjet letra nën thjerrëzën në të cilën mbliidhen rrezet e diellit. Kështu, pasi që ky njeri shndërrohet në një qendër tërheqjeje dritësore hyjnore, edhe njerëzit e tjerë, në mënyrë të pavullnetshme, e duan dhe e respektojnë atë.

Kjo, sepse ata kanë skalitur në karakterin e tyre gërshetimin e diturive të dukshme e të padukshme. Shikimin e tyre konceptual e kanë shtrirë në të dy botët, duke arritur kështu në lumturinë e të shijuarit të imanit e në thellimin emocional.



Fryti i parë i besimit

Fryti i parë i një besimi të përsosur, është “mëshira” dhe, manifestimi më i qartë i saj, është “shërbimi” ndaj krijesave për hir të Allahut. Mëshira, është shenja dalluese e besimtarëve. Madje, ajo konsiderohet si kartëvizita e tyre shpirtërore.


Besimtari i mëshirshëm është bujar, modest, shërbyes dhe njëkohësisht, një mjek i zemrave që injekton në shpirtira vaksinën e jetës. Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik përmend më tepër emrat e Vet “Rrahman” dhe “Rrahim”. Për rrjedhojë, mënyra më e bukur e miqësisë dhe afërsisë me Allahun, i Cili është më Mëshiruesi i mëshiruesve, është mëshira ndaj krijesave të Tij.



Agjërimi; Trajnimi i mëshirës

Adhurimi që na trajnon dhe e ushqen më mirë mëshirën tonë, është agjërimi. Ne duhet ta edukojmë veten me uri, me qëllim që zemra jonë të mbushet me ndjenjën e mëshirës, që duart tona t'u zgjaten të dobëtëve dhe nevojtarëve, që zemra jonë të ndajë të qajë hallet e tyre dhe të zërë vend përreth tyre.

Shpirti i njeriut që agjëron çlirohet nga pushtimi i egos. Mëshira që na mëson agjërimi, është një hapësirë shumë e madhe, në të cilën janë fshehur mistere të panumërta të gjithësisë.



Vetëdija e përgjegjësisë

Gjatë kohës së zisë, dikush e pyeti Jusufin عليه السلام:

“–Ti je përgjegjësi dhe menaxheri i thesarit. Përse e lë veten të uritur dhe nuk ha sa të ngopesh?” Jusufi عليه السلام, u përgjigj:

“–Nëse ngopem, kam frikë se i harroj të uriturit dhe nuk i kuptoj hallet e tyre!”

Të kamurit duhet të dinë të vendosin veten në vendin e fukarenjve dhe të mund të mendojnë kësh-tu: “Allahu i Lartëmadhëruar mund të na krijonte në gjendjen e tyre, ndërsa ata në gjendjen tonë. Ai na i la amanet të varfrit duke na dhuruar të mira materiale. Ai ka dashur që të varfrit t’i strehojë tek të pasurit, na ka bërë përgjegjës për ta dhe ka urdhëruar që t’i shprehim Atij falënderimet tona, duke u dhuruar atyre prej të mirave që vetë Ai na i ka besuar...”



Ramazani i bekuar: Edukim i një jete shpirtërore.

Besimi Islam nuk është një rit i veçantë vetëm për muajin e Ramazanit, ose për ditë të caktuara, por një jetë e tërë në devotshmëri.

Ramazani është një shkollë devotshmërie, ndërsa bajrami është diploma e tij shpirtërore. Bajrami është një ditë e bekuar dhe manifestimi në këtë botë i ditës së takimit të lumtur, kur besimtarët do të dalin në prezencën hyjnore me suksesin e sprovës së devotshmërisë. Bajrami i vërtetë, është kënaqësia e Allahut ndaj nesh. Për këtë arsye, në mënyrë të veçantë në ato ditë gëzimi duhet të gëzojmë edhe jetimet, të vetmuarit, të varfrit dhe nevojtarët, me qëllim që të arrijmë mëshirën dhe faljen hyjnore.



Zemra të thyera

Musai ﷺ u lut:

“–O Zot! Ku të të kërkojë Ty?”

Allahu ﷻ i tha:

“–Më kërko pranë zemërthyerve!”

Mënyrat për tu takuar me Zotin, janë të shumta. Por, më e bukura prej tyre, është të shpëtosh nga hallet një zemër që është vendshikimi hyjnor.

Besimtari, është nën kujdesin e besimtarit

Kur shohim një të sëmurë, duhet të mendojmë:

“Edhe unë mund të isha në atë gjendje. Ky njeri i sëmurë ka nevojë për dashamirësi, mëshirë dhe interesim nga ata që e rrethojnë. Prandaj edhe unë duhet t’i afrohem dhe të përpiqem t’ia lehtësoj vështirësitë. T’i plotësojë nevojat dhe ta ngushëllojë zemrën e tij të hidhëruar...”

Profeti ﷺ, shpesh herë pyeste: “A keni vizituar ndonjë të sëmurë sot?”

Përsëri, kur shohim ndonjë aksident rrugor, duke menduar se; “në atë aksident mund të isha edhe unë ose edhe të afërmit e mi”, duhet të falënderojmë për mirësitë e jetës dhe shëndetit që zotërojmë.

Kur të shohim ndonjë jetim, ai duhet të bëjë të mendojmë për Profetin ﷺ dhe të kujtojmë se edhe ai erdhi si jetim në këtë botë. Në këtë mënyrë duhet të mendojmë për detyrat tona ndaj tyre dhe faktin se ata janë lënë nën kujdesin tonë...





Gërmadha që sundojnë thesare

Sadi Shirazi thotë::

“Miqtë e Allahut, bëjnë pazar në dyqanet ku nuk shkon askush.”

Pra, miqtë e Allahut gjenden gjithmonë pranë të vetmuarve dhe hallexhinjve. Ata i njohin nga pamja e jashtme nevojtarët të cilët nuk e shprehin nevojën e tyre nga turpi. Po ashtu, për shkak se tek miqtë e Allahut mëshira dhe dhembshuria janë në nivel të lartë, ata shohin shumë mundësi për të fituar shpërblime prej Allahut, të cilat njerëzit e thjeshtë nuk arrijnë t'i shohin.



“...nëse e ndihmoni Allahun,
edhe Ai do t’ju ndihmojë...” (Muhammed, 7)

Sprova e ndërgjegjes

Përgjegjësia që lind prej vëllazërisë së besimit, është shumë e rëndësishme. Megjithëse ata janë me trupa të ndryshëm, besimtarët janë të detyruar të jetojnë me të njëjtën zemër dhe ta konsiderojnë njëri-tjetrin si gjymtyrët e një trupi të vetëm.

Ashtu siç e ndjen i gjithë trupi dhimbjen e një gjymtyre, ashtu edhe ndjeshmëria ndaj vështirësive të një vëllai të fesë, është një provë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.



Të mund të thuash: “Më parë vëllai im!”

Profeti ﷺ ka thënë se besimtarët kanë përgjegjësi ndaj njeri-tjetrit; ata duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin si tullat e një muri dhe se të flesh i ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur, nuk përputhet aspak me moralin Islam.

Nderi dhe virtyti i një besimtari, është në mendimin për qetësinë dhe lumturinë e vëllait të tij të fesë para vetes. Pra, të kalojë prej egoizmit në altruizëm dhe të mund të thotë, “më parë vëllai im”...




Në çfarë niveli është altruizmi ynë?

Mevlana thotë:

“Shemsi -Allahu e mëshiroftë-, më ka mësuar një gjë dhe ajo është se: Nëse në botë ka ftohtë qoftë edhe një besimtar i vetëm, nuk ke të drejtë të ngrohesh. Dhe, unë e di që në botë ka besimtarë që kanë ftohtë, prandaj, tashmë nuk mund të ngrohem!”

Në çfarë gjendjeje janë ndjenjat tona të mëshirës ndaj padrejtësive që u bëhen sot myslimanëve në çdo vend të botës? Sa do të na hidhëronin këto padrejtësi nëse do t'i vuanin djemtë apo vajzat tona? Sa lot derdhin sytë tanë për shkak të vuajtjeve që heqin vëllezërit tanë të mjerë dhe sa dua bëjnë gjuhët tona për ta? Sa arrijmë të bëhemi shërim për plagët e tyre me mundësitë tona?



Zemra që dridhen për umetin

Ebu'l-Hasan Harakani ka thënë:

“Gjemi që i hyn në gisht një vëllai të fesë nga Turkistani deri në Sham, është ngulur në gishtin tim. Guri që i vret këmbën dikujt, ka vrarë këmbën time. Nëse në një zemër ka dëshpërim, ajo zemër është zemra ime.”



Horizonti i mëshirës së besimtari të përsosur

Sa bukur e përshkruan ndjesinë e zemrës së një besimtari të përsosur kjo këshillë e Ismail Ata:

“Në diell bëhu hije, në të ftohtë bëhu gëzof, e në uri bëhu bukë!”



Shprovat e vëllazërisë

Dijetarët Islamë kanë mendim të përbashkët se, myslimanët të cilët kanë mundësi dhe nuk i ndihmojnë vëllazërit e tyre të fesë të cilëve u bëhet padrejtësi dhe shtypen në cilindo vend të botës, do të kenë gjynah të madh.

Gjendja e mjeruar e vëllazërve tanë të fesë në vendet si Siria, Gaza, Afrika, etj., është tablo e një sprove hyjnore që duhet të na nxisë të gjithëve drejt një vetillogarie të ndërgjegjes!.. Nëse nuk kemi asnjë një mundësi për t'i ndihmuar këta vëllazër, të paktën të mos i harrojmë ata në lutjet tona.



Mëshirë ndaj krijesave për hir të Krijuesit

Zemrat e ndjeshme të besimtarëve të përsosur, të cilët thellohen në vuajtjen e të mjerëve, vlojnë si mahsher. Ky vlim zemre, i sjell ata deri në pragun e derës që hapet drejt mëshirës së Allahut. Kushedi se çfarë misteresh të jashtëzakonshme dëgjoen dhe çfarë pamjesh të urtësive të mrekullueshme shihen aty?!



Solidarizimi me hallet e umetit

I gjithë mudi, mendimi, shqetësimi, halli dhe përpjekja e besimtarëve të përsosur, është pagja dhe lumturia e të gjitha krijesave. Si rezultat i edukimit hyjnor dhe profetik, ata kanë shpëtuar prej egoizmit, pra kanë ikur nga stacioni i “unit” dhe janë bërë altruistë duke hyrë në stacionin e “bashkësisë”. Ata që janë shqetësuar me shqetësimin e të tjerëve dhe janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve, kanë arritur pjekurinë e një shpirti të butë dhe të ndjeshëm. Ata e kanë kuptuar shumë mirë se shpëtimi i tyre kalon nga përpjekja për shpëtimin e të tjerëve. Ata janë shpirtra të lartë, të cilët jetojnë me entuziazmin për të gëzuar vëllezërit e tyre të fesë.

Shejh Sadi ka thënë:

“Nëse dëshiron të shpëtosh prej halleve, bëhu ilaç për hallet e hallexhinjve!..”



Muslimani nuk mund të jetë egoist

Nëse besimtarët nuk shpëtojnë prej mendimeve egoiste, pra, nëse nuk e kapërcejnë egon e tyre dhe të mendojnë për të tjerët, nuk mund të arrijnë përsosmërinë e besimit.

Nëse nuk e ndjelmë në supet tona barrën e përgjegjësisë ndaj vëllezërve tanë të fesë, nuk duhet të harrojmë se nuk do ta kemi të lehtë as llogarinë tonë në botën tjetër.

E në fakt, edhe Allahu e refuzon tipin e njeriut që mendon vetëm për interesat e veta, është i ashpër dhe koprrac.



Mëshira vjen me përpjekjen, e vështirësia me indiferencën!

Në shërbimin e sinqertë që bëhet në rrugë të Allahut, ka begati të mëdha, sepse Allahu i Madhëruar e ndihmon në vështirësitë e tij personale atë që i shërben fesë dhe mundohet t'u zgjidhë hallet nevojtarëve. Ndërsa ata që merren vetëm me dertet e veta, i lë vetëm për vetëm me ato derte që kanë.



Mëshira: Çelësi i lumturisë së përjetshme

Njeriu që nuk njih mëshirë, ka humbur çelësin e derës së thesarit dhe lumturisë më të madhe. Nëse arrijmë ta ngremë mëshirën mbi të gjitha dashuritë, vetëm atëherë mund t'i dëgjojmë me të vërtetë rënkimet që shkëputen prej zemrave të nevojtarëve.



T'i njohësh njerëzit nga pamja e jashtme

Zemra e besimtarit duhet të jetë aq e ndjeshme dhe vigjilente, sa të arrijë ta kuptojë gjendjen e vëllait të tij që ka përballë, si një radiografi shpirtërore, dhe ta ndjejë veten përgjegjës për plotësimin e nevojave të tij. Duke na bërë të ditur se zemrat e besimtarëve duhet ta fitojnë këtë ndjesi ndaj nevojtarëve, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...Do t'i njohësh ata nga pamja e tyre!..” (Bekare, 273)

Dielli nuk pret përgjërimet e atyre që duan të përfitojnë prej ngrohtësisë dhe dritës së tij. Kështu, edhe një besimtar i mençur e bën vet atë që pritet prej tij, pa pritur t'ia thonë.




Në ç'gjendje është butësia e zemrës sonë?

Vallë, sa gjurmë prej butësisë së zemrës së Profetit (a.s.), bart bota e zemrës sonë? Sa i njohim ndjesitë e Profetit (a.s.)? sa arrijmë t'i zbukurojmë ndërgjegjet tona me ndjenjat e të Dërguari të Allahut (a.s.)? A e zotërojmë një zemër që të mund t'i njohë nga pamja e jashtme vëllezërit e fesë me zemra të thyera, të cilët prej turpiti dhe dinjitetit nuk i shprehin hallet e tyre, pavarësisht se janë duke u përpëlitur mes njëmijnjë problemesh? A janë zemrat tona në atë nivel altruizmi, saqë në vend të thonë "më parë unë", të thonë "më parë vëllai im"?..




Mëshirë që përfshin të gjitha krijesat

Besimtari i përsosur, nuk është një kandil që ndriçon vetëm shtëpinë e tij. Ai duhet të ndriçojë në qiellin e virtyteve të njerëzimit si një diell dhembshurie dhe mëshire që përkëdhel me dritën e tij bujare kokën e të gjithë atyre që u është errësuar bota në këtë tokë dhe i mbështjell me ngrohtësinë e tij të butë shpirtrat e ftohur të të vetmuarve. Pasqyra më e kthjellët ku do të shihet lumturia e bajramit të vërtetë, është zemra e thyer së cilës i falet gëzimi i bajramit.



Ushtar i zemrës

Një besimtar vërtet i pjekur dhe i përkushtuar ndaj shërbimit, është një ushtar i zemrës që, i zhveshur nga ekzistenca e përkohshmërisë së vet, ka pranuar të qëndrojë në fund të karvanit të shërbimit. Ai është gjithmonë pranë hallexhinjve, njerëzve të dobët, të varfër, jetimëve, të pashpresëve etj. Ai është një dritë që ndriçon në errësirë, një udhëzues i pashoq për atë që ka humbur rrugën.



Ringjallja e vëllazërisë

Zoti ynë, urdhëron që besimtarët të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Kuptimi i dy duarve që lajnë njëra-tjetrën, është plotësimi i mangësive materiale dhe shpirtërore të njëri-tjetrit, ndarja e gëzimeve dhe hidhërimeve, falja e gabimeve, qarja e halleve, këshillimi dhe konsiderimi i vëllait si më të mirë dhe më të pastër se vetja.



Të drejtat vëllazërore

Enes bin Malik رضي الله عنه, tregon::

“Nëse i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e shihte ndonjë prej vëllazërve të tij besimtar për tre ditë radhazi, pyeste për të. Nëse ndodhej larg lutej për të, nëse ishte në shtëpi i bënte vizitë, e nëse ishte sëmurë shkonte për t’i uruar shërim të shpejtë.” (Hejthemi, II, 295)

Kushti i parë i të kaluarit mirë me vëllain tënd të fesë, është të kujdesesh që të mos biesh në ato pozita, sa të bëhesh barrë për tjetrin, përkundrazi, duhet t’ia lehtësosh barrën atij. Miqësia e atij, që nuk i bëhet barrë kujt dhe dashuria e atij që nuk i fut të tjerët në vështirësi, është e vazhdueshme.



Dashuria

Dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave. Të dashuruarit nuk mund të rrinë pa përmendur vazhdimisht atë që dashurojnë. Ato tregohen bujarë me të gjitha mundësitë e tyre ndaj të dashurve dhe përpiqen ta gjejnë lumturinë, duke sakrifikuar çdo gjë për njëri-tjetrin.

Për të peshuar se sa të mbushur e kemi zemrën tonë me dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), duhet të mendojmë se sa i përdorim mirësitë e përkohshme për të arritur dashurinë hyjnore.

Duhet të bëjmë kujdes që dashuria të mos mbetet thjesht një pretendim i thatë, i cili nuk zbret kurrë prej gjuhëve drejt zemrave tona!..



Peshorja e dashurisë: Sakrifica

Treguesi i dashurisë është sakrifica. Ai që do, sakrifikon për atë që do, në atë masë që e do, dhe këtë, e konsideron kënaqësi. Kjo shkon gjer te flijimi i jetës. Bujaria ndaj krijesave të Allahut, është shfaqja më e bukur e dashurisë së atij që do, për atë që do.

Aq sa na detyron dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), të sakrifikojmë në rrugën e Allahut Teala jetën, pasurinë dhe çdo lloj mundësie tjetër që mund të kemi, po aq është edhe fuqia dhe ekzistenca e saj në zemrat tona.




Duhet të paguajmë

Njerëzit, çmimet më të larta dhe sakrificat më të mëdha i bëjnë për hir të dashurisë, sepse të gjithë, durojnë sakrificat për hir të dashurisë sipas dashurisë që kanë.

Edhe dashuria hyjnore kërkon sakrificë. Por kjo arrihet vetëm me braktisjen e dashurive të përkohshme. Kur dashuria arrin kulmin e përsosmërisë, edhe sakrificat që tregohet për hir të atij që dashurohet, arrin kulmin. Në këtë pikë, edhe vuajtjet bëhen kënaqësi.

Të mos harrojmë se në këtë botë kemi ardhur pa paguar asnjë çmim. Por, për të shkuar të lumtur dhe të shpëtuar në botën tjetër, duhet të paguajmë diçka që sot.



Dobia e shërbimit

Shërbyesit në rrugën e Allahut u ngjajnë hënës dhe diellit në qiell, që u japin jetë edhe qosheve më të largëta. Ndërkohë që ndriçojnë përreth vetes, shkëlqimi i tyre shtohet edhe më tepër. Pra, nga një anë, shërbimi u sjell dobi të tjerëve, ndërsa nga ana tjetër, në varësi të përpjekjeve dhe sinqeritetit, ai bëhet shkak për lartësimin e atyre që shërbejnë. Madje, dobia që përfitojnë shërbyesit në rrugën e Allahut është më e madhe se ajo që përfitojnë ata të cilëve u shërbehet.



Shërbimi duhet konsideruar si mirësi!..

Shejh Sadi, shprehet:

“Falënderoje Allahun, që të dha mundësi të bësh mirësi, sepse Ai nuk të privoi nga mirësia e Tij. Ai që i shërben padishahut, nuk mund të pretendojë mirënjohje prej tij. Përkundrazi, ti duhet t’i jesh mirënjohës atij që të mori në punë.”



Edukata dhe rregullat e shërbimit

Zemra e njeriut që shërben në rrugën e Allahut, duhet të jetë si një tokë e begatë. Gjallesat që lëvizin mbi tokë ushqehen nga ajo dhe nxjerrin jashtë tepricën. Por toka e pastron të gjithë këtë papastërti dhe duke mbirë bimë të shumëllojshme, njëra më e bukur se tjetra, i ushqen të gjitha krijesat që lëvizin mbi të.

Ashtu siç është e pamundur që dielli të mos lëshojë rreze të ngrohta, edhe njerëzit me shpirt të devotshëm e kanë të pamundur të mos ndjejnë dhembshuri për të tjerët, t'i shmangen punës në rrugën e Allahut, të jenë të pandjeshëm karshi dhimbjes dhe vështirësive dhe të mos shpërndajnë bukuri e mirësi rreth tyre.



Dashuria ndaj shërbimit

Aq sa e rëndësishme është përpjekja që tregohet në kryerjen e shërbimeve morale dhe materiale, aq e rëndësishme është edhe cilësia dhe niveli i zemrës me të cilat kryhen ato. Sepse nga kjo varet edhe begatia dhe pranimi i këtij shërbimi tek Allahu. Prandaj, të parët tanë kanë thënë:

“Shërbimi për hir të Allahut është i rëndësishëm, por edukata që tregohet është më e rëndësishme”. Në këtë mënyrë, ata kanë theksuar domosdoshmërinë e kryerjes së shërbimit për hir të Allahut me sinqeritet në zemër dhe duke iu përmbajtur normave e rregullave të edukatës.



Besimtari është gjithmonë në kërkim të shërbimit

Një besimtar i mirë, që di t'i bëjë me dashuri detyrat e tij në çdo fushë, është një burim shprese dhe besimi, sepse shërbimi është një shkallë e lartë dhe e veçantë, e cila i ngre zemrat në majat hyjnore.

Gjithashtu, besimtarët e pajisur me vetëdijen e shërbimit, janë si një lumë i begatë, që teksa rrjedh në rrugën e tij të gjatë, u jep jetë e gjallëri një mijë e një gjallesave, si njeriut, tokës, pemës, trëndafilin, zymbylit, bilbilit etj. Caku përfundimtar i këtij lumi është deti i takimit të përjetshëm me Allahun.



Përpjekje në çdo çast të jetës

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur...?!”

(Hadid, 16)

Ky ajet, është zbritur për të qortuar disa sahabë të cilët filluan të dobësoheshin disi në devotshmëri pas emigrimit në Medinë, pavarësisht nga vuajtjet dhe mundimet që kishin përjetuar në Mekë. Dhe ky është një fakt shumë domethënës, sepse nëse edhe brezit të sahabëve u ka ardhur ky paralajmërim, atëherë, ne duhet të përpiqemi edhe më shumë për të arritur një vigjilencë shpirtërore më të madhe, e cila nuk do të na lejojë të ndikohemi prej ambicieve të kësaj bote dhe interesave të përkohshme të saj.



Mos e vini në rrezik jetën e botës tjetër!

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...mos e hidhni veten në rrezik!..” (Bekare, 195)

Nisur nga kjo, duhet të kuptojmë se; ndërkohë që para nesh kemi mundësinë të fitojmë kënaqësinë e Allahut duke shërbyer dhe u përpjekur për hir të Tij, ne nuk duhet të mashtrohemi nga joshja e kësaj bote të përkohshme, iluzioneve, stolive, komforteve dhe kënaqësive të saj! Përndryshe do të vëmë në rrezik jetën tonë në botën tjetër.



Nëse dëshiron Xhenetin

Ebu Hatim (r.a.), thotë:

“O Vëlla! Nëse do të hysh në xhenet,
shtyji për më vonë katër gjëra:

1. Gjumin për në varr,
2. Rehatinë për në sirat
3. Lavdërimin për në mizan,
4. Dëshirat e nefsit për në xhenet.”



Nuk flihet në stacion!

Kjo botë është vetëm një stacion në rrugën për në botën tjetër. Në stacion nuk flihet. Si paralajmërim ndaj kësaj pakujdesie, Imam Shafiu ka thënë:

“S’ka logjikë që karvanët të ndërtojnë shtëpi gjatë udhës!..”



Të mos na mbetet hambari bosh!..

Ashtu siç mbetet bosh hambari i një fermeri që e kap dembelia në sezonin e mbjelljeve, ashtu edhe ata që nuk mbjellin farën e punëve të mira në arën e kësaj bote, nuk do të mund të korrin prodhimin e lumturisë në botën tjetër. Për këtë arsye, ne duhet të shërbejmë në rrugën e Allahut në këtë jetë të përkohshme, që jeta jonë e përrjetshme të kalojë nën hijen e mëshirës së Tij.



Ndërkohë që Ebu Xhehlët punojnë ditë e natë...

Shumë njerëz arrijnë të sakrifikojnë rehatinë, pasurinë, shëndetin, madje edhe jetën e tyre për hir të ëndrrave boshe dhe dashurive kalimtare, ndërsa Ebu Xhehlët e kohës sonë bëjnë përpjekje dhe sakrifica titanike për të mbajtur gjallë kauzat e tyre të kota. Atëherë, si është e mundur që ne myslimanët, që jemi pjesëtarë të kauzës hyjnore, t'i konsiderojmë të mjaftueshme përpjekjet tona fetare? Si mund të dalim faqebardhë nga vetllogaria në këtë çështje?..



Sipas mundësisë

Zoti ynë nuk na ngarkon me përgjegjësi përtej mundësive tona. Mirëpo, kjo do të thotë se ne jemi përgjegjës për atë që kemi mundësi. Pra, ne do të japim llogari edhe për mirësitë që nuk i kemi vepruar edhe pse kemi pasur mundësi.



Besimtarët me cilësitë e diellit

Aftësi e vërtetë, është ta mbushësh zemrën me bujari dhe altruizëm dhe mirësitë që Allahu t'i ka dhuruar në këtë botë, t'i shndërrosh në pasurinë e botës tjetër. Nisur nga kjo, pasuria më e mirë, është ajo që dërgohet në botën tjetër para të zotit dhe jeta më e mirë, është ajo që bëhet në rrugën e kënaqësisë hyjnore.

Ata që dinë ta përdorin siç duhet jetën dhe pasurinë e tyre, janë si dielli. Me mirësitë e tyre ndriçojnë çdo errësirë dhe përhapin rreze virtytesh në zemrat e nevojtarëve dhe të vuajturve.



Të shohësh krijesat me syrin e butësisë

Besimtari duhet të jetë zemërdhembshur si filladi dhe bujar si shiu i lehtë, në kërkim të kënaqësisë së Zotit duke i dhuruar prehje dhe qetësi çdokujt dhe çdo gjëje që ndodhet përreth tij.

Kjo është arsyeja që miqtë e Zotit i ngjasojnë me bujaritë e tyre përrënje të begatë, duke rrjedhur e shkuar drejt Zotit të tyre pasi kanë kaluar udhë të gjata nëpërmjet të cilave u kanë dhuruar qetësi dhe prehje mijëra krijesave, njerëzve, kafshëve, pemëve, zogjve, trëndafililit dhe zymbylit.



Të jetosh moralin hyjnor

Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik, ka urdhëruar: “... Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..” (Kasas, 77)

Me këtë, Allahu shprehet se bujarinë e Vet, dëshiron ta shohë edhe tek robërit e Tij. Për këtë arsye, një besimtar, i cili dëshiron të jetojë moralin hyjnor, duhet të kërkojë kënaqësinë e Allahut me dorën, gjuhën, veprat, fjalët dhe me të gjitha mundësitë materiale e shpirtërore që posedon.



Çfarë vlere ka!?

Mevlana ka thënë:

“Çfarë është ari, çfarë është jeta, çfarë është perla dhe merxhani, nëse nuk shpenzohen për dashurinë dhe nuk sakrifikohen për Një Bukuri!”



Arti i përdorim pasurisë

Mirësitë e kësaj bote janë si një thikë me dy presa. Për atë që di t'i përdorë janë stoli, e për atë që mashtrohet pas tyre, janë humbje dhe fatkeqësi...

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9)



Falënderimi me vepra

Falënderimi është dy llojesh:

- 1) Falënderimi me gjuhë duke pranuar se të gjitha mirësitë janë prej Allahut.
- 2) Falënderimi me vepra, duke ua dhuruar ato mirësi nevojtarëve.

Sa bukur shprehet Shejh Sadi:

“Ti që nuk ke nevojë të dalësh derë më derë për të lypur, falëndero, duke mos kthyer duarbosh asnjë prej të varfërve që vijnë tek dera jote! Mos ua rrudh fytyrën atyre, por priti ata me buzëqeshje...”



“...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si
të ka bërë mirë ty Allahu....” (Kasas, 77)

Edukata e dhurimi

Besimtari është njeri bujar. Bujaria e vërtetë është të dhuruarit me plot shpirt, pa t’u dridhur qerpiku, pa t’u dridhur dora, me rehatinë e natyrshmërinë e shiut që bie nga qielli. Mirësitë për të pasur vlerë tek Allahu i Lartëmadhëruar, duhet të bëhen në mënyrë aq të natyrshme e pa hasur ndonjë vështirësi të brendshme, siç sillen natyrshëm lulet me aromën e tyre të këndshme në mjedisin ku gjallojnë!.. Vetëm dhurimet e tilla arrijnë tek Allahu i Lartëmadhëruar.



Kush dhe kujt ia ka nevojën?

Në këtë botë, i dobëti ka nevojë për të fortin, i varfri për të pasurin dhe i sëmurë për të shëndetshmin. Ndërsa në botën tjetër, i forti ka nevojë për lutjen e të dobët, i pasuri për lutjen e të varfrit dhe i shëndetshmi për lutjen e të sëmurit.



Dhurimi me mirësjellje

Mevlana e shpreh kështu mirësinë e të dhuruarit për hatër të Zotit:

"Dhuro nga pasuria jote ashtu siç duhet, fito më mirë një zemër! E kështu, dua ja e asaj zemre do të japë ty dritë në jetën e varrit, në atë natë aq të frikshme e të zezë!.."

Ashtu siç nuk duhet ta kursejmë pasurinë tonë dhe mundësitë tona ndaj nevojtarëve, ashtu nuk duhet ta kursejmë as buzëqeshjen dhe mirësjelljen ndaj tyre.

"...Çfarëdo të mirë që të jepni, është në dobinë tuaj, nëse ju këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t'ju rikthehet e plotë dhe nuk do t'ju bëhet pa drejtësi." (Bekare, 272)



Kujdes, mos e lëndo të dobëtin!

Shejh Sadi, ka thënë:

Nëse të troket ndonjë hallexhi në derë, mos e nis atë duarbosh! Larg qoftë, ndoshta një ditë bëhesh ti vetë i tillë, e detyrohesh të trokasësh derë më derë."

"Kur t'i bësh mirë ndonjë njeriu, mos u mburr, duke thënë: «Unë jam zotëri, ndërsa ai ma ka nevojën mua!» Mos thuaj që koha e ka goditur atë! Shpata që godet akoma nuk ka hyrë në këllëf. Mundet që një ditë, shpata në fjalë të të godasë edhe ty."



Ligji i tërheqjes

Tek paraja ekziston ligji i tërheqjes së ngjashmërive, pra paraja hallall tërheq njeriun hallall, ndërsa ajo haram tërheq njeriun që është po ashtu haram. Paraja është si gjarpri: del nga po ajo vrimë që hyn. Fitimi hallall bëhet shkak për punë të mira dhe të hajrit, ndërsa fitimi haram humbet në rrugë të mëkatit. Parë nga ky aspekt, qenia e një malli hallall apo haram mund të vërtetohet duke parë se nga shkon kjo pasuri, pra ku dhe si harxhohet.



Kaderi i parashë

Pasuria është faktor përcaktues në rrjedhën e kaderit të njeriut. Të gjithë mendojnë se mund ta zotërojnë dhe përdorin si të duan parane, mirë po pasuria shpenzohet siç fitohet dhe në të shumtën e rasteve është ajo që e tërheq njeriun sipas drejtimit të vet. Pra në pjesën më të madhe sundimi është i pasurisë dhe jo i zotëruesit të saj.

Kujt i hyjnë para haram në xhep, i prishen edhe veprat, edhe sinqeriteti. Prandaj duhet të bëjmë shumë kujdes se në çfarë mënyre i fitojmë të ardhurat tona.



Mos e shkel kufirin e haramit dhe hallallit

Fitimi haram, është si një tullumbace që fryhet përnjëherë në dorën e njeriut. Disa nga këto tullumbace plasin në këtë botë, e disa të tjera në botën tjetër. Aspekti i jashtëm i këtyre fitimeve, duket si një melodi e ëmbël dhe e këndshme për njeriun. Por aspekti i tyre shpirtëror, është kryekëput një dështim dhe falimentim i përjetshëm.



Themeli i problemeve

Dihet se në themel të problemeve shpirtërore që përjetohen shpesh në kohën tonë, qëndrojnë fitimi i padrejtë, shkelja e të drejtave të robit, pakënaqësia dhe lakmia. Prandaj, për të eliminuar këto probleme, është e domosdoshme të respektohen rregullat Islame, të cilat i ndalojnë njerëzit nga shkelja e të drejtave të tjerëve dhe i nxit ata drejt fitimit hallall.

Ashtu siç është e domosdoshme të kalosh në sitë tonelata me dhe për të përfituar një gram ar, ashtu është e domosdoshme edhe të bësh një kujdes të madh për të fituar prej hallallit në kushtet ekonomike të në ditëve tona.



Çmenduria e shpërdorimit

Në lidhje me ngrënien dhe pirjen në jetën e përditshme dhe veçanërisht nëpër dasma e gosti, bëhen shumë shpenzime e shpërdorime. Teprimet, si përgatitjet e gostive pompoze për mburrje, mendjemadhësi dhe shfaqje force, nxitja e grykësisë me ushqime të tipit “bufe e hapur” dhe veshja e rrobave të markave të shtrenjta për t’u krekosur, nuk ka dyshim se në botën tjetër do të kthehen në pendesë. Kjo, sepse e gjithë llogaria e këtyre do të na sillet përpara mbi peshoren hyjnore.



Ajo që mbetet pas prej pasurisë

Besimtarët e vërtetë nuk e harrojnë kurrë të vërtetën se:

“Për hallallin ka llogari, e për haramin ka dënim!..”

Abdurrahman el-Evzai رحمته ka thënë:

“Edhe pasuria hallall mbaron, edhe ajo haram... Por pas mbetet shpërblimi dhe gjynahu që fitohet prej tyre.”



Kanceri i pasurisë: Shpërdorimi dhe koprracia

Sundimi çdo gjëje i takon Allahut. Shpenzimi vetëm për veten i pasurisë që të është lënë amanet për një kohë të shkurtër, quhet shpërdorim. Ndërsa mbledhja dhe ruajtja e saj vetëm për veten, quhet koprraci. Dhe, që të dyja këto e shndërrojnë në fatkeqësi botën tjetër.



Jini të përmbajtur!

Musa Efendiu ﷺ ka thënë:

“Biri im! Ji gjithmonë i përmbajtur në shpenzime dhe jep për hir të Allahut! Mos jini të përmbajtur vetëm gjatë Ramazanit, por bëheni zakon të jetës suaj! Ndërsa atë që është përtej nevojës dhurojeni për hir të Allahut!”

Ta dini se, edhe nëse jetoni në sarajet e Dollmahatës apo të Topkapësë, prapë jeni të detyruar të jetoni të përmbajtur dhe të ruheni prej shpërdorimit dhe koprracisë. Prandaj, pasurinë barteni vetëm jashtë zemrës suaj!”



Kriteri i pasurisë së vërtetë

Kriteri i pasurisë së vërtetë, nuk është malli i shumtë dhe kuletat e fryrë, por vetëmjaftueshmëria dhe dhurimi prej zemrës.

Njeriut me zemër të pasur, nuk i bën dëm varfëria e kuletës. E atij me zemër të varfër, nuk i bën dobi pasuria e kuletës.



Vlera e njeriut, është aq sa devotshmëria e tij


Sa e hidhur është të dëgjosh që sot, kur virusi i materializmit është përhapur kudo dhe ku çdo gjë vlerësohet me një mentalitet materialist, vlera dhe nderi i njeriut të matet me para dhe me pozitë! Dasmat, synetet dhe ceremonitë e vdekjes, janë tregues të mirë të kësaj gjendjeje të keqe. Parimet e vlerësimit të nderit dhe fisnikërisë njerëzore, duhet të jenë gjithmonë besimi, devotshmëria dhe morali i bukur.



Mos e bëj zemrën kasafortë!

Nëse njeriut i jep tërë botën, a thotë; “vallë, po në hënë a s’kam ndonjë copë?”. Lakmitë e egos nuk kanë fund. Qetësia e zemrës është tek vetëmjaftueshmëria dhe falënderimi.

Pasuria është amanet që na ka lënë Allahu dhe zemra jonë nuk duhet të jetë kasafortë e kësaj bote. Ne duhet të përpiqemi që aty të mos fusim këtë botë, por botën tjetër.



Që haxhi të jetë i pranuar...

“Kush e viziton këtë Shtëpi me paratë që i ka fituar në mënyrë të ndaluar, ka devijuar nga bindja ndaj Allahut...”

E, kur të thotë: “Lebbejk Allahume lebbejk”, nga qielli i vjen një zë që i thotë:

Për ty s’ka as lebbejk, e as sa’dejk! Sepse ti e ke fitimin haram, furnizimin haram dhe kafshën haram. Kthehu mbrapsht pa marrë asnjë sevap!...” (Hejthemi, III, 209-210)



Arra pa bukë

Mirësitë e kësaj bote, për hir të së cilave përjetohen grindje të shumta, në të vërtetë janë si arra pa bukë. Kur njeriu zgjohet nga vdekja prej gjumit të kësaj jete kalimtare, do ta kuptojë se sa e shkurtër dhe e pavlerë ka qenë ajo. Ai do të pendohet për vuajtjet që ka hequr për hir të gjërave të kota në këtë botë të përkohshme. Sa mashtrim i hidhur është fakti që njerëzit hanë njerit-tjetrin në këtë botë për gjëra që do të bëhen pishman kur të shkojnë në varr!..



Uji i rrjedhshëm...

Shejh Sadi ka thënë:

“Mos pandeh se do të ngrihesh duke bërë para! Uji që nuk rrjedh mban erë të keqe dhe thahet. Prandaj përpiqu të japësh e të rrjedhësh vazhdimisht! Ujin që rrjedh e ndihmon qielli. Lëshon shi, dërgon përrenj dhe e bën det!”



Fitim i dyfishtë, humbje e dyfishtë

Lukmani i Urtë ka thënë:

“Flijoje këtë botë për botën tjetër, që t’i fitosh të dyja dhe mos e flijo botën tjetër për këtë botë, sepse i humbet të dyja.”



Vetëmashtrimi më i tmerrshëm

Të mashtrohesh nga stolitë e pavërteta të kësaj dynjaje e, të shkatërrosh gradat dhe vlerat që ke tek Krijuesi yt, është si të shesësh një vazo ari me gurë të çmuar, në vleftën e një cope teneqeje, krejt të pavlerë.

“Nuk është çudi që qengji të ikë prej ujkut, sepse ujku është armiku dhe gjahtari i qengjit. E çuditshme do të ishte që qengji t’ia jepte zemrën ujkut!”



"Tek Ai do të ktheheni!" (JaSin, 83)

Kjo botë është kalimtare. Mos harro botën tjetër!

Kush jep të përkohshmen dhe fiton të përjetshmen, është i zgjuar. Ai që shet botën tjetër dhe mashtrohet me këtë botë, është mendjelehtë. Kurse ai që shet botën tjetër për interesat e dikujt tjetër në këtë botë, është i marrë!..

Allahu nuk i jep vlerë atij që e harron botën tjetër dhe zhytet në kënaqësitë e kësaj bote, e cila nuk vlen as sa krahu i një mize tek Allahu.

Sa bukur shprehet një i urtë:

"Mos kërkto përjetësi nga kjo botë! Ajo s'mund të të japë atë që nuk e zotëron as vete!"



Mos u mashtro pas kësaj bote!

O ti i shkujdesur që mburresh me pasurinë e përkohshme dhe mashtroresh pas kësaj bote duke harruar urtësinë e sprovës!

Kujdes! Mos u beso shumë pallateve dhe ndërtesave të forta që ke bërë! Vendi yt poshtë tokës së zezë po të pret. Pallatet e tua të larta, të gjera e luksoze do të mbeten këtu, kurse ti do të shtrihesh në shtëpinë tënde nën tokën e zezë, i vetëm dhe i pashpresë. Aty do të hysh vetëm me punët e tua dhe llogarinë e atyre që ke fituar!..



Merr mësim, mos u bëj mësim!

Historia është një monument i madh
mësimdhënës dhe udhëzues për njerëzimin,
si me faqet e saj të ndritura, ashtu edhe me
skenat e saj të errëta të mizorisë. Dielli sipër
nesh, është i njëjti diell që për një kohë ka
ndriçuar sarajet e Faraonëve, të Hamanëve,
të Nemrudëve, të Adëve dhe Themudëve, e
që më pas lindi përsëri me madhështi mbi
rrënojat e tyre. Po sot, kë po gëzojnë ato
saraje të bukura e luksoze?



Investimi më fitimprurës

Shejh Sadi ka thënë:

“Njerëzit e mençur e marrin pasurinë e tyre edhe kur shkojnë në botën tjetër. Ndërsa dorështrënguarit shkojnë duke lënë gjithçka në këtë botë.”



Të gjesh thesar në ëndërr

Mevlana ka thënë:

“Kjo botë nuk është tjetër, veçse një ëndërr. Të jesh i pasur në këtë botë, është si të gjesh një thesar në ëndërr. Pasuria e kësaj bote qëndron po në këtë botë duke u trashëguar nga brezi në brez.”

“Kur meleku i vdekjes i merr shpirtin të pasurit të pakujdesshëm, e zgjon atë nga gjumi i kësaj bote. Ndërsa ai, i habitur bën “o bobo” kur kupton se në këtë botë qenka rropatur për një pasuri që në të vërtetë nuk është e tij. Mirëpo, tashmë çdo gjë ka mbaruar.”



Pasuria e botës tjetër

Atje është vendi ku ndahet shapi nga sheqeri. Ku vihet nën këmbë tirani që shëtiste mbi kokat e njerëzve. Ku shumë skllëvër do të jenë mbretër dhe shumë mbretër do të jenë skllëvër. Ku do të fshihen të gjitha postet dhe gradat të cilat nuk janë përdorur për hir të Allahut. Ku shumë të varfër do të bëhen të pasur dhe shumë të pasur të pakujdesshëm do të bëhen të varfër të përjetshëm dhe lypësit e mahshe-rit. Atje do të bëjnë dobi vetëm besnikëria e robit ndaj Allahut dhe zemrat e sinqerta dhe të drejta.



Paraja e vlefshme

*Argjendari i mirë, një tjetër qese qep për vetë!
Çfarëdo paraje që vlen në varr, atë ndan më vetë!*

Nexhip Fazëll Kësakyrek



Mirësia së cilës nuk i dihet vlera

Një jetë indiferente që bëhet vetëm duke rendur pas këtyre nevojave, është e mbushur me mall dhe pishman për lojërat në fëmijëri, për shkujdesjen në adoleshencë, për epshin në rini dhe për ato që tashmë kanë humbur, në pleqëri.

Për fat të keq janë të paktë ata që ia dinë vlerën dhuntive, pa i humbur ato. Për këtë arsye, fakti që të rinjtë e çojnë dëm kot dhe pa asnjë qëllim pasurinë e rinisë, më tepër hidhëron të moshuarit, që ia kanë kuptuar rëndësinë asaj mirësie, sepse e kanë humbur njëherë atë. Ndaj është thënë:

“Ah, sikur të dinin të rinjtë dhe të mund të vepronin të moshuarit!”



Shfrytëzoje mirë kohën!..

Jeta është një mirësi tepër e vlefshme, të cilën Krijuesi i gjithësisë ia jep qenies për ta jetuar një herë dhe në një kohë të caktuar. Është kusht i domosdoshëm ta shfrytëzojmë kohën me veprimet më pozitive, në përputhje me vlerat e saj. Sepse koha as nuk merret borxh dhe as nuk jepet... Çdo gjë mund të blihet, përveç kohës së kaluar...

Vlerësoje aq mirë kohën që, edhe nëse të thuhet: "Nesër do të vdesësh!", të mos ndiesh nevojë të ndryshosh asgjë nga programi yt!..



Një ditë e kësaj bote

Khunejd Bagdadi ka thënë::

“Një ditë e kësaj bote, është më e vyer sesa njëmijë vite të botës tjetër, sepse veçoria e fitimit dhe humbjes i përkasin kësaj bote. Ndërsa në botën tjetër, nuk ekziston mundësia të bëhet diçka për të shpëtuar.”



Nxitimi në punë të mira

Allahu i Madhëruar urdhëron; **وَالْفَجْرُ** “**Betohem në agimin**” Çdo agim hap për ne një faqe të re nga kalendari i jetës. Si do ta mbushim këtë faqe? Sa do të punojmë për veten dhe sa do të jemi altruistë dhe të gjendemi pranë të mjerëve dhe të të vetmuarve? Çfarë do të shkruajnë melekët Kiramen Katibin në dosjen tonë?

Ja pra, besimtari duhet ta shpenzojë kohën e tij në punë të mira, duke analizuar këto të vërteta me një zemër të pastër.



Pa kaluar koha, pa perënduar dielli...

Kush është i vetëdijshëm për realitetin e vdekjes, nuk mashtrohet nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote.

Sikur të gjitha mirësitë e përkohshme të mbli-dhen tek një njeri, dhe sikur ky njeri të jetojë edhe një mijë vjet, ç'dobi ka! Në fund të fundit, vendi ku do të futet a nuk do të jetë kjo tokë të cilën e shkelim me këmbë?

Një jetë e bërë në mënyrë të pavetëdijshme ndaj jetës së botës tjetër, edhe sikur të ketë kaluar me lumturi dhe kënaqësi, në të vërtetë nuk është gjë tjetër veçse një falimentim në atë botë!



Retorika e vdekjes

Nëse pyetjes; “Çfarë është jeta?, do t’i përgjigjeshim; “vetëm lagështira e tokës dhe ngurtësia e gurëve të varrit”, atëherë, çfarë do të ishte më e hidhur se humbja e një jete të shkurtër në një shkujdesje të tillë?..

Meditimi më i qartë i vdekjes, fshihet në enigmën e heshtjes së pathyeshme të buzëve të kyçura e të mavijosura të të vdekurve. Përgjigjet që vijnë prej kësaj bote ndaj ligjëratisë së vdekjes ndërkohë që ajo është duke këshilluar, janë vetëm lotët dhe lemza e thatë...



Mos t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote!

A nuk është qefini rroba më originale e tregut të jetës, e cila anulon të gjitha shitblerjet e përkohshme të kësaj bote?

Trupi ynë, së bashku me qefinin tonë do të bëhet dhe. Por punët tona do të mbeten të përhershme.

Nëse ne e jetojmë jetën e kësaj bote, e cila vjen e ikën si reja e verës, pa shqetësimin më të vogël për jetën tjetër, kjo nuk është asgjë tjetër veçse një konceptim i ditës pa mbrëmje.

“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun!” (Fatir, 5)



Mësime urtësie prej tokës

Sa tablo madhështore e mësimdhënëse është për të mençurit, kjo tokë mbi të cilën ecim:

Ajo është e mbushur me trupa të kthyer në dhe, që prej Ademit (a.s.), e deri tek ne. Duken si miliarda hije të vëna sipër njëra-tjetrës...

Nesër, edhe trupat tanë do të zënë vend në gjirin e kësaj toke!..


Me pak fjalë, çfarë tjetër është kjo botë, përveçse një vend ku mbruhën dhe përzihen brezat e shkuar dhe të ardhshëm? Ajo që na takon neve, është të përpiqemi të bëhemi nxënës të sinqertë të kësaj shkolle mësimdhënëse.



Meditimi rreth vdekjes

Në sytë e njerëzve indiferentë, varrezat janë vetëm ara të mbushura me kufoma. Kurse për njerëzit e mençur, janë adresa të së ardhmes të mbushura me mësim dhe urtësi.

Të parët tanë, të cilët i kanë pasur parime të jetës së tyre këto të vërteta absolute, varrezat i kanë ndërtuar brenda qyteteve dhe para xhamive, me qëllim që kjo të nxisë vazhdimisht meditim mbi përkohshmërinë dhe të jetojnë në këtë botë duke marrë parasysh realitetin e botës tjetër.



Mësime pafjalë

Vdekja nuk ka ndonjë gjuhë të veçantë. Por kushedi se sa kuptime madhështore ka groposur ajo brenda heshtjes të thellë! Vdekja është një mësim pafjalë për njerëzit e ndjeshëm dhe të zgjuar nga indiferenca. Ajo u jep atyre leksione dhe u tregon të vërtetat me gjuhën e saj të natyrshme në mënyrë më të përsosur se gjuhët më elokvente.



Gënjeshtra në pasqyrë

Mevlana ka thënë:

“O udhëtar, shiko imazhin e fundit në pasqyrë! Mendo për shëmtinë e pleqërisë së një të bukuri dhe kthimin në rrënojë të një ndërtese, e mos u mashtro prej gënjeshtrës në pasqyrë!..”

“O ti, që kafshon buzët dhe mahnitësh përballë bukurisë së pranverës! Shiko njëherë edhe gjendjen e zverdhur dhe ftohtësinë e vjeshtës!”



Shqetësimi për frymën e fundit

Përveç profetëve dhe atyre, për të cilët na kanë njoftuar ata, askush nuk e ka të garantuar se në frymën e fundit do të shkojë me besim. Për këtë arsye, besimtari duhet të përpiqet në çdo çast të jetojë sipas Kuranit dhe Sunetit dhe të lutet vazhdimisht siç është lutur edhe profeti **Jusuf** عليه السلام: “...(O Zoti im) **Bëj që të vdes si mysliman dhe më bashko me punëmirët (në botën tjetër)!”** (Jusuf, 101)



Perdja e hollë mes jetës dhe vdekjes

Njeriu ballafaqohet shpeshherë me vdekjen gjatë jetës së tij. Sëmundjet, ngjarjet e papritura, fatkeqësitë dhe sa e sa rreziqe që ndodhin për shkak të pakujdesisë dhe paaftësisë, a nuk tregojnë se sa e hollë është perdja mes njeriut dhe vdekjes?



Vetllogaria

Kur shohim një xhenaze, duhet të mendojmë; “Sot, në atë arkivol mund të isha unë”. Më pas duhet të fillojmë të bëjmë llogarinë e jetës sonë në mënyrë të detajuar, duke menduar se trajtimi që po i bëhet xhenazes që sapo pamë, një ditë do të na bëhet edhe neve...



Perdja e fundit

Fryma e fundit është si një pasqyrë pa avull, pa gërvishtje dhe pa njolla. Në këtë pasqyrë, çdo njeri sheh shumë qartë gjithë jetën e tij me bukuritë dhe gjërat e shëmtuara. Në atë moment, asnjë perde kundërshtimi dhe indiference nuk të sytë dhe veshët. Përkundrazi, ato largohen të gjitha dhe çdo lloj rrëfimi e përfshin mendjen dhe shpirtin në pendim. Prandaj, duhet të bëjmë kujdes, që pasqyra e parë ku e shohim jetën duke medituuar, të mos jetë fryma jonë e fundit!..



Aftësia

*Atë çast, kur perdet ngrihen dhe ulen,
Aftësi është t'i thuash, "Mirëserdhe!" Azrailit...*

Nexhip Fazëll Kësakyrek



Si do të jetë skena e vdekjes sonë?

Vallë, si do të jetë skena e takimit tonë të sigurt me melekun e vdekjes? A do të takohemi me të kur të jemi në sexhde apo kur të jemi duke bërë ndonjë gjynah? Vallë, cila do të jetë fjalia e fundit që do të dalë nga buzët tona?..



Të vdesësh para se të vijë vdekja

Nëse njeriu e kapërcen egon dhe përparon në rrugën e cilësive engjëllore që janë të fshehura në shpirtin e tij në jetën e kësaj bote, pra, nëse zbulon të fshehtën; “të vdesësh para se të vijë vdekja”, vdekja bëhet hapi i parë i detyrueshëm për takimin me Zotin e Madhëruar.



Nata e dasmës

Të arrish ta shndërrosh vdekjen nga humbje në fitore, duke e bërë jo ditë zie, por ditë dasme, është veçori vetëm e atyre që përgatiten për vdekjen dhe dinë të vdesin...

Omer bin Abdulazizi رضي الله عنه ka thënë:

“Përgatituni sipas vendit ku dëshironi të shkoni në botën tjetër!”



Si të jetoni, ashtu do të vdisni

Ubejdullah Ahrar tregon:

Një njeri i mirë pa në ëndërr Bahauddin Nakshibendin pas vdekjes së tij dhe e pyeti:

“Çfarë duhet të bëjmë për të arritur shpëtimin në botën e përjetshme?”

Ai iu përgjigj:

«**Bëni atë që duhet bërë në frymën e fundit!**»
Pra, ashtu siç është e nevojshme që në frymën e fundit të mendojmë plotësisht vetëm Allahun e Madhëruar, ashtu duhet të veprojmë edhe gjatë gjithë jetës!”

(*Reshatat*, fq. 130)



Për ku udhëtojmë?

Allahu i Madhëruar, thotë:

“(O i Dërguar!) A ke dëgjuar për kiametin, tmerri i së cilit kaplon çdo gjë?” (Gashije, 1)

Allahu Teala dëshiron që t’i japim shumë rëndësi lajmit të kiametit dhe tmerrit të tij. Me një thënie tjetër, na qorton kështu:

“Si mundet që të silleni sikur nuk u ka ardhur ai lajm i madh?! Si mundet që të kaploheni nga pasionet e gjërave boshe dhe të ulëta në këtë botë?! Si mund ta kaloni jetën, e cila është kapitali juaj më i vlefshëm, në neglizhencë ndaj Allahut (xh.xh.)?!.”



Jeta e vërtetë

Një ditë, Ibën Mes'udi رضي الله عنه, u tha shokëve të tij:

“-Ju agjëroni, falni namaz dhe bëni punë të mira më shumë se sahabët e Resulullahut (a.s.), por ata ishin më të mirë se ju.”

Ata të habitur pyetën:

“-E si është e mundur kjo?”

“-Ata ishin më larg kësaj bote dhe e dëshironin më shumë se sa ju botën tjetër.” - tha ai. (Hakim, *Mustedrek*, 4/135)



Fatkeqësia e vërtetë

Imam Rabbani ka thënë:

“Vdekja nuk është fatkeqësi. Fatkeqësi e vërtetë, është të mos dish se çfarë do të bëhet me ty pas vdekjes.”

Ikja prej vdekjes me frikë dhe drithërim, është lodhje e padobishme. Ndërsa të përpiqesh ta harrosh atë duke e anashkaluar, është budallallëku më i madh.



Fleta e fundit e kalendarit të jetës

Çdo njeri vjen në këtë botë me një kalendar të padukshëm dhe çdo ditë, një dorë e padukshme shkëput një fletë prej atij kalendari.

Allahu i Madhëruar, na lajmëron hapur për atë që do të na thuhet kur të ketë rënë edhe fleta e fundit e kalendarit të jetës sonë:

“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): ja; kjo është ajo së cilës përpiqesh t’i ikje.” (Kaf, 19)



Ngjyra e vdekjes

Lumturia e dy botëve fillon me deshifrimin e të panjohurës së vdekjes në mendjen njerëzore, e cila gjendet mes djepit dhe varrit. E në fakt, për ata që nuk mund ta kapërcejnë pengesën e egos, vdekja është një natë e errët fatkeqësie, ndërsa për besimtarët që i kanë vënë zemrën gjirit të shpalljes, ajo është caku ku fillon lumturia e pafundme.

Mevlana ka thënë:

“Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e (shpirtit të) tij.”

“O shpirt që frikësohesh dhe ikën nga vdekja! Në të vërtetë, ti nuk ke frikë nga vdekja, ti ke frikë nga gjendja dhe punët e tua. Ajo që sheh në pasqyrën e vdekjes dhe frikësohesh, nuk është çehrja e vdekjes, por fytyra e shëmtuar e botës tënde të brendshme...”



Koha e vdekjes është e panjohur

Nesër do të bëhemi pjesë e tokës mbi të cilën sot shkelim e kalojmë. Por, për të mos u dënuar nesër nën tokë, duhet të mos mashtrohemi sot mbi tokë prej madhështive të përkohshme që e joshin egon tonë. Në këtë botë, nuk duhet të shëtitim si vendas dhe nuk duhet të harrojmë se jemi udhëtarë drejt vdekjes, që mund t'u vijë ftesa në çdo moment. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë edhe se kemi një takim të pashmangshëm me Azrailin, në një vend dhe një kohë të panjohur për ne.

Të mos harrojmë se as në këtë botë nuk ka kohë dhe vend ku mund t'i shpëtosh vdekjes, as në varr nuk ka ndonjë mundësi për t'u kthyer pas dhe as në ditën e kiametit nuk do të ketë vendstrehim prej tmerrit të asaj dite.



Mos harro përkohshmerinë!

Harrimi i vdekjes është harrim i vetvetes, është rrënim i së ardhmes. Ditët e bukura të jetës, fshihen pas fytyrën e zbehtë të vdekjes. Por të mos harrojmë që zemra është si kuti postare, që pret lajmin e vdekjes nga posta hyjnore.



Dita që nuk ka të nesërme

Jeta është si një masur së cilës nuk i njihet metrazhi. Për rrjedhojë, nuk dihet as se kur do të mbarojë, e as ku do të këputet... Çdo gjallesë që lind është kandidat për të vdekur dhe çdo njeri është në moshë për të vdekur!..

Pasi të kesh dhënë frymën e fundit, nuk do të jetë e mundur as të pendohesh e të falesh dhe as të hallalohesh me njerëzit dhe të shpëtosh prej hakut të robit. Për realizimin e këtyre, duhet të shfrytëzosh kohën sa je gjallë!..

Për këtë arsye, është thënë se; u shkatërruan ata që thanë “e bëjmë nesër”, sepse dita që nuk ka të nesërme mund të vijë në çdo çast.



Haku që është lënë jashtë faljes hyjnore:

Haku i robit

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një grimcë, do ta shohë atë.” (Zelzele, 7-8)

Ndërsa në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë dita e kijametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërtën, nëse ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi. (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por, nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij.”

(Buhari, Medhalim 10, Rikak, 48)



Kaseta e jetës sonë

Ndërkohë që mbi këtë tokë të përkohshme konsumojmë frymët tona që janë copëza të çmuara të kohës, nuk duhet të harrojmë se kamerat hyjnore janë gjithmonë duke regjistruar. Një ditë, kasetta e jetës sonë do të vihet para dhe do të na urdhërohet “Lexo librin tënd!”. Atë ditë, do ta njohim shumë mirë veten tonë.



Përgatitja për ardhmërinë e përjetshme

A nuk e sheh se çdo stinë dimri bie borë dhe mbi tokë nuk mbete asnjë shenjë prej luleve dhe bimëve!? Farat varrosen nën borë dhe nën tokë në një vetmi të dhimbshme përgjatë gjithë dimrit. Më pas vjen pranvera dhe zoti i atyre farave u jep përsëri jetë të gjithave, duke e kthyer vendin në një Xhenet.

Mos harro! Siç thotë edhe **Aliu** ﷺ: “Jeta e kësaj bote, i ngjan gjumit. Njerëzit zgjohen atëherë kur vdesin. Prandaj përgatitu mirë për kohën kur do të zgjohesh!

Kujdes! Mos u mashtro pas luleve të egra e të pavlera, që mbijnë në kalldrëmet e sokakëve dhe të cilat janë të dënuara të shtypen nën këmbë! Mos harro se të ardhmen e siguron Allahut...”



Besnikëria e vërtetë

Pasuria e kësaj bote, që do të na qëndrojë besnike, është ajo që e kemi dërguar në botën tjetër duke e dhuruar për hir të Allahut.

Fëmija që do të na qëndrojë besnik, është ai që kemi edukuar në rrugën e Allahut dhe mbetet pas nesh si sadaka e pandërprerë.

Ndërsa miqtë që do të na mbeten besnikë, janë ata që i kemi dashur për hir të Allahut dhe me të cilët kemi qenë vëllezër në kohë të vështira.

هَمَّ
يَسْمَعُ



Kujtimi që mbetet në zemër...

Cilësia më e bukur që i ka hije një robi i cili po i konsumon shumë shpejt ditët e tij në këtë botë të përkohshme, si një pemë që i bien një nga një të gjitha gjethet në stinën e vjeshtës, është të shpëtojë nga prangat e joshjeve kalimtare dhe të jepet pas bukurive të përhershme.



Ata që nuk bëhen e shkuar

Miqtë e Allahut nuk bëhen kurrë e shkuar, edhe pasi trupat e tyre të përkohshëm hyjnë nën tokë, sepse zemrat e besimtarëve të përsosur, nuk asgjësohen duke u kalbur nën tokë. Për këtë arsye, edhe veprat që burojnë nga shpirti i tyre bëhen të përjetshme. Për rrjedhojë, shumë miq të Allahut, të cilët e kanë vazhduar shërbimin e tyre të kësaj bote edhe në botën e berzahut, jetojnë ende sot midis nesh dhe na rrëfejnë udhën e drejtë. Por edhe pasi të vdesim ne, ata do të vazhdojnë të jetojnë në zemra me udhëzimet e tyre.



Të dashuruarit nuk vdesin

Mevlana ka thënë:

“Pas vdekjes sonë, mos e kërkoni varrin tonë në tokë. Varri ynë është në zemrën e të diturve.”

Dhe me të vërtetë që, Mevlana Xhelaledin Rumi, me veprat e tij, si Mesnevia, vazhdon të jetojë në zemrën e besimtarëve prej shtatëqind vitesh.



Burimi i miqësisë

Shah Nakshibendi, Gejlani, Mevlana, Junus Emre, Hydaji e të tjerë miq të Zotit, të cilët kanë shijuar miqësinë e buruar nga Allahu, u bënë përjetësisht miq të njerëzimit. Dëshën dhe u deshën. Pas jetës së kësaj bote, ata u përjetësuan në miqësi dhe dashuri, duke lënë pas një jehonë të këndshme në kubënë e kësaj jete të përkohshme.

Historia na tregon se njerëz të tillë, si Faraoni, Nemrudi, Ebreheja dhe Hulagu, me veprimet që kanë kryer, kanë fituar armiqësinë dhe urrejtjen e njerëzimit. Ata nuk i deshi askush dhe mbeten si simbol i tiranisë në kujtimet e njerëzve. Po ashtu, edhe sundimi i tyre përfundoi me dështim të hidhur.



Bëhu njeri për të cilin ndihet mall!

Aliu ﷺ ka thënë:

*“Shoqërohuni me njerëz të mirë dhe besnikë!
Jetoni në atë mënyrë që njerëzit t’jua ndjejnë
mungesën kur jeni gjallë dhe të digjen nga malli
për ju kur të vdisni.”*

Lum si ata që shkojnë në botën tjetër pasi
kanë lënë zë të mirë në këtë nënqiell!..



Përfundimi i mirë...

Ebu Bekri ﷺ është lutur kështu:

“O Allah! Bëj që periudha më e mirë e jetës sime të jetë fundi, pjesa më e mirë e punëve të mia të jetë rezultati dhe dita më e mirë e ditëve të mia të jetë dita, kur do të takohem me Ty.”

PËRMBAJTJA

Prej folesë së zemrës.....	3
Perlat e të vërtetave ekzistenciale.....	3
Parafjalë.....	5
Njohja e Profetit ﷺ me zemër.....	9
Pa njohur Atë është e pamundur.....	10
Sa i ngjasojmë Atij?.....	11
Me kë jemi?.....	12
Ta njohim, ta shohim dhe ta dëgjojmë atë.....	13
Parimi.....	14
Borxhi i besnikërisë.....	15
Çfarë veprash kemi?.....	16
Fijet e litarit... ..	17
Entuziazmi i besimit	
të sahabëve në gjurmët e Profetit ﷺ.....	18
Mrekullia e vërtetë.....	19
Nevoja e njerëzimit;	20
Fryma e tij mëshironjëse.....	20
Dashuria për Allahun dhe Profetin ﷺ.....	21
Ehli Bejti.....	22
Ebu Bekri ؓ.....	23
Omeri ؓ.....	24
Osmani ؓ.....	25

Aliu	26
Frekuentimi i njerëzve të dijes	27
Profeti i faljes	28
Lavdia e Muhamedit	29
Me ndarjen tënde digjen nga malli	30
Atë e njuh toka dhe qielli	31
Përgjegjësia jonë në luftën mes së vërtetës dhe të kotës	32
Islamofobia	34
Prova e dashurisë	36
Si bleta	37
Letër udhëzimi prej Allahut	38
Respekti ndaj Kuranit Fisnik	39
Si duhet lexuar Kurani?	40
Lexo për të jetuar!	41
Aq sa na mban zemra	42
Ëmbëlsi e pafund	43
Shpjegimi i njeriut	44
Çelësi i meditimit	45
Dy ulluqe	46
Identiteti shpirtëror	47
Çfarë po kërkojmë?	48
Nëse nuk do të ishte urtësia	49
Prej artit tek Artisti,	50
Prej veprës tek Autori	50
Arritja e kënaqësisë së artit hyjnor	51
Shikim urtësie mbi librin e gjithësisë	52
Dhikri më emocional	53
Kur thellohesh në meditim	54
Shikim i veçantë	55

Mos u bëj i shkujdesur!.....	56
Të mos verbohen zemrat!.....	57
Një indiferencë e tmerrshme!.....	58
Shih artin e vërtetë!.....	59
Ç'është mistika Islame?	60
Xhihadi i madh.....	61
Udhëtim prej besimit në mirësi.....	62
Harmoni shpirt-trup.....	63
Thellësia shpirtërore.....	64
Jehona shpirtërore e Mevlanës.....	65
Ç'është devotshmëria?.....	66
Të ruhesh prej gjembave të gjynahut.....	67
Devotshmëria: Dera e takimit me Zotin.....	68
Ndjeshmëria ndaj devotshmërisë.....	69
Kush është shembulli ynë?.....	70
Ushqimi i Shpirtit.....	71
Lufta e brendshme.....	72
Nevoja për edukimin e egos.....	73
Dy anët e peshores.....	74
Devotshmëri me vetëdijen e mirësisë.....	75
Për të shpëtuar prej indiferencës.....	76
Të gurëzosh shejtanin.....	77
Me kë jemi?.....	78
Të jesh bashkë me Allahun.....	79
Ëmbëlsia e dhikrit.....	80
Ka Allah nuk ka qeder!.....	81
Qetësia.....	82
Drita e dhikrit.....	83
Pastrimi me anë të lotëve.....	84
Lutje që meriton praninë.....	85

Nga se varet pranimi i duasë?	86
A më do Allahu?	87
T'i kemi qëllimet e pastra	88
Uniteti i të jashtmes dhe të brendshmes	89
Ajo që të çon në zjarr!.....	90
Kibla e zemrës.....	91
Namazi, kriter personaliteti.....	92
Namazi i pranuar	93
Që të mos pësojmë firo në veprat tona	94
Vlera e adhurimit	95
Edukata në vepra	96
Të jetosh me entuziazmin e adhurimit.....	97
Gjendja e besimtarit	98
Të mbruhesh në kthetrat e vuajtjes.....	99
Urtësia e vuajtjeve.....	100
Kush do trëndafilin, nuk pyet për gjemba.....	101
Mirësia e fshehtë brenda fatkeqësisë	102
Në çdo gjë ka një mirësi	103
Sprovë edhe në pasuri, edhe në varfëri.....	104
Bëhu ilaç mirësie!.....	105
Edhe kjo do të kalojë.....	106
Receta e paqes	107
Me qëllim që të arrijmë qetësinë shpirtërore, i Dërguari i Allahut ﷺ na ka këshilluar kështu:	107
Besimi duhet vërtetuar	108
Ruajtja e ekuilibrit mes baticave dhe zbaticave.....	109
Besnikëria ndaj Zotit.....	110
Ç'është gjithë kjo lakmi?!.....	111
Falënderimi	112
Sado që të falënderojmë është pak!.....	113

Mos u jep pas furnizimit, e të harrosh Furnizuesin!.....	114
Tradhtia më e madhe.....	115
Martesa dhe familja në Islam.....	116
Zgjedhja e bashkëshortit/es.....	117
Çerdhja e ngrohtë familjare.....	118
Gruaja e devotshme: Krijesa më e mirë në botë.....	119
Stolia e llojit njerëzor: Gruaja e devotshme.....	120
Thesari i ndershmërisë.....	121
Virtyti i mëmësisë.....	122
Respekti ndaj nënës është detyra jonë.....	123
Një brez fisnik.....	124
Zogjtë e Xhenetit.....	125
Natyra e farave.....	126
Të jesh një çoban i mirë.....	127
Trashëgimia e vërtetë.....	128
Shqetësimi për të ardhmen.....	129
Shqetësimi për brezat.....	130
Të shohësh të ardhmen.....	131
Nevoja për njerëz të kualifikuar.....	132
Të diturit e vërtetë.....	133
Shpirti që do të ringjallë shoqëritë.....	134
Gomarë të mbushur me libra.....	135
E keqja më e madhe ndaj fëmijës.....	136
Edukim dykrahësh.....	137
Dija e padobishme.....	138
Përdorimi i mangët i materialit.....	139
Profesion profetik.....	140
Cilësitë e edukatorit ideal.....	141
Kushti i meritës.....	142

S'ka justifikime	143
Metoda në kumtimin e Islamit	144
Urrejtje ndaj gjynahut, mëshirë ndaj gjynahqarit.	145
Metoda e tasavufit	146
Si kopsht me lule	147
Fjalë të buta edhe ndaj Faraonit	148
Të flasësh me mirësjellje	149
Zemra mëshiruese	150
Këshillimi në mirësi dhe ndalimi nga e keqja	151
Përgjegjësia e paralajmërimit dhe udhëzimit	152
Çelës i mirësisë, kyç i së keqes	153
Çlirimi i vërtetë	154
Nuk ka justifikim	155
Dhurimi më i bukur	156
Mos lëndo zemra!	157
E keqja dëmton të zotin	158
Të mos lëndosh, e të mos lëndohesh	159
Dy cilësitë e zemrës së pastër	160
Njeriu i mirë	161
Edukata dhe mirësjellja	162
Aromë trëndafili	163
Respektimi i edukatës	164
Feja është edukatë	165
Besimtari me zemrën sa një det	166
Bëhu me natyrë trëndafili	167
Gjendja e zemrave mike	168
Më i mirë... Më i bukur... Më i përsosur	169
Të kuptosh shpirtin Islam	170
Kulm qytetërimi	171
Qytetërimi në arkitekturë	172

Qytetërimi në humanizëm.....	173
Cila shoqëri është më e qytetëruar?	174
Shoqëria e qetë.....	176
Të parët tanë dhe ne.....	177
Kush jemi ne?.....	178
Ti je një popull i madh!	179
Njohja e të metave personale	180
Njeriu i pjekur, i njeh kufijtë vet.....	181
Mbretërimi i modestisë.....	182
Ji modest si toka!.....	183
Hutia e mendjemadhësisë.....	184
Çibani në zemër;.....	185
Mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi	185
Të gjitha mirësitë janë prej Allahut.....	186
Gjithmonë nevojtarë ndaj Allahut	187
Mos u kreno o biri njeriut!.....	188
Për të zhvilluar shpirtëroren, duhet të mposhtësh egon!.....	189
Të mund të thyesh idhujt në zemër	190
Aftësia e vërtetë.....	191
Të keqen largoje me të mirë!.....	192
Durim dhe tolerancë ndaj të paditurve dhe mendjelehtëve.....	193
Metoda e mëshirës.....	194
Fal që të falesh.....	195
Mbulimi i gabimeve.....	196
Bëhu i dobiprurës, jo dëmtues!.....	197
Mos u ushqe urrejtje në zemër!.....	198
Dashuri dhe urrejtje për hir të Allahut.....	199
Kë duhet të duam, e kë jo?.....	200

Miku i vërtetë	201
Kur humbasin interesat.....	202
Sinqeriteti në miqësi.....	203
Dy faktorë.....	204
Kujdes me kë shoqërohesh!.....	205
Zgjidhe mirë shokun!.....	206
Ruajtja e zemrave.....	207
Ai që është në Jemen, është afër meje.....	208
Uniteti i zemrave.....	209
Edhe privimi që të ruan nga e keqja është mirësi	210
Biseda; Kuvendi i marrëdhënieve shpirtërore.....	211
Biseda dhe etika e saj.....	212
Eliksir për zemrat.....	213
Të devotshmit: Burim frymëzimi.....	214
Fryti i parë i besimit	215
Agjërimi; Trajnimi i mëshirës.....	216
Vetëdija e përgjegjësise	217
Ramazani i bekuar:	
Edukim i një jete shpirtërore.....	218
Zemra të thyera.....	219
Besimtari, është nën kujdesin e besimtarit	220
Gërmadha që sundojnë thesare.....	222
Sprova e ndërgjegjes	223
Të mund të thuash: “Më parë vëllai im!”	224
Në çfarë niveli është altruizmi ynë?	225
Zemra që dridhen për umetin	226
Horizonti i mëshirës së besimtari të përsosur.....	227
Sprovat e vëllazërisë.....	228
Mëshirë ndaj krijesave për hir të Krijuesit.....	229

Solidarizimi me hallet e umetit	230
Myslimani nuk mund të jetë egoist	231
Mëshira vjen me përpjekjen, e vështirësia me indiferencën!	232
Mëshira: Çelësi i lumturisë së përjetshme	233
T'i njohësh njerëzit nga pamja e jashtme	234
Në ç'gjendje është butësia e zemrës sonë?	235
Mëshirë që përfshin të gjitha krijesat	236
Ushtar i zemrës	237
Ringjallja e vëllazërisë	238
Të drejtat vëllazërore	239
Dashuria	240
Peshorja e dashurisë: Sakrifica	241
Duhet të paguajmë	242
Dobia e shërbimit	243
Shërbimi duhet konsideruar si mirësi!	244
Edukata dhe rregullat e shërbimit	245
Dashuria ndaj shërbimit	246
Besimtari është gjithmonë në kërkim të shërbimit	247
Përpjekje në çdo çast të jetës	248
Mos e vini në rrezik jetën e botës tjetër!	249
Nëse dëshiron Xhenetin	250
Nuk flihet në stacion!	251
Të mos na mbetet hambari bosh!	252
Ndërkohë që Ebu Xhehlët punojnë ditë e natë	253
Sipas mundësisë	254
Besimtarët me cilësitë e diellit	255
Të shohësh krijesat me syrin e butësisë	256

Të jetosh moralin hyjnor	257
Çfarë vlere ka!?	258
Arti i përdorim pasurisë.....	259
Falënderimi me vepra.....	260
Edukata e dhurimi.....	261
Kush dhe kujt ia ka nevojën?	262
Dhurimi me mirësjellje	263
Kujdes, mos e lëndo të dobëtin!	264
Ligji i tërheqjes	265
Kaderi i parasë.....	266
Mos e shkel kufirin e haramit dhe hallallit.....	267
Themeli i problemeve	268
Çmenduria e shpërdorimit.....	269
Ajo që mbetet pas prej pasurisë.....	270
Kanceri i pasurisë: Shpërdorimi dhe koprracia.....	271
Jini të përmbajtur!.....	272
Kriteri i pasurisë së vërtetë.....	273
Vlera e njeriut, është aq sa devotshmëria e tij.....	274
Mos e bëj zemrën kasafortë!.....	275
Që haxhi të jetë i pranuar... ..	276
Arra pa bukë.....	277
Uji i rrjedhshëm... ..	278
Fitim i dyfishtë, humbje e dyfishtë.....	279
Vetëmashtrimi më i tmerrshëm.....	280
Kjo botë është kalimtare	
Mos harro botën tjetër!.....	281
Mos u mashtro pas kësaj bote!	282
Merr mësim, mos u bëj mësim!.....	283
Investimi më fitimprurës.....	284
Të gjesh thesar në ëndërr.....	285

Pasuria e botës tjetër.....	286
Paraja e vlefshme	287
Mirësia së cilës nuk i dihet vlera.....	288
Shfrytëzoje mirë kohën!.....	289
Një ditë e kësaj bote	290
Nxitimi në punë të mira.....	291
Pa kaluar koha, pa perënduar dielli.....	292
Retorika e vdekjes.....	293
Mos t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote!.....	294
Mësime urtësie prej tokës.....	295
Meditimi rreth vdekjes.....	296
Mësime pafjalë.....	297
Gënjeshtra në pasqyrë.....	298
Shqetësimi për frymën e fundit.....	299
Perdja e hollë mes jetës dhe vdekjes.....	300
Vetllogaria.....	301
Perdja e fundit.....	302
Aftësia.....	303
Si do të jetë skena e vdekjes sonë?.....	304
Të vdesësh para se të vijë vdekja.....	305
Nata e dasmës.....	306
Si të jetoni, ashtu do të vdisni.....	307
Për ku udhëtojmë?.....	308
Jeta e vërtetë.....	309
Fatkeqësia e vërtetë.....	310
Fleta e fundit e kalendarit të jetës.....	311
Ngjyra e vdekjes.....	312
Koha e vdekjes është e panjohur.....	313
Mos harro përkohshmërinë!.....	314
Dita që nuk ka të nesërme.....	315

Haku që është lënë jashtë faljes hyjnore:

Haku i robit.....	316
Kaseta e jetës sonë.....	317
Përgatitja për ardhmërinë e përjetshme.....	318
Besnikëria e vërtetë.....	319
Kujtimi që mbetet në zemër.....	320
Ata që nuk bëhen e shkuar.....	321
Të dashuruarit nuk vdesin.....	322
Burimi i miqësisë.....	323
Bëhu njeri për të cilin ndihet mall!.....	324
Përfundimi i mirë.....	325

